




Dr. Musli Vërbani

**(PA)MUNDËSIA E
PËRKTHIMIT TË
KUR'ANIT**

Kaçanik, 2006



Dr. Musli VËRBANI

**(PA)MUNDËSIA E PËRKTHIMIT
TË KUR'ANIT**

Recenzent:
Prof. Dr. Beqir Ismaili

*Radhitja kompjuterike,
kopertina dhe dizajni grafik*
Mumin Shehu

**Prishtinë
2006**

Të drejtën e ribotimit e rezervon botuesi

PËRKTHIMI I KUR'ANIT

S'ka dyshim se përkthimi i Kur'anit nuk mund të quhet Kur'an, sepse çfarëdo përkthimi, në secilën gjuhë të botës dhe prej cilitdo autor, nuk mund të bartë (përkthimi) të gjitha qëllimet, të gjitha synimet, të gjitha shtresimet stilistikore(si alegoritë etj.), dhe esencën e Kur'anit. Kur'an mbetet vetëm ai në gjuhën pasur dhe të pastër arabe, në gjuhën, të cilën e ka zgjedhur Zoti i Lartmadhëruar:

إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ قُرْآنًا عَرَبِيًّا لَعَلَّكُمْ تَعْقِلُونَ

“Ne e kemi zbritur Kur'anin në gjuhën arabe me qëllim që ju të logjikoni (të mendoni, ta përdorni intelektin tuaj, dhe të bindeni vetë se pse ka zbritur në gjuhën arabe)”.

(Suretu Jusuf, 2)

Mirëpo, kjo nuk do të thotë se nuk lejohet përkthimi i Kur'anit në gjuhë të tjera (me qëllim për ta kuptuar Kur'anin), por ky përkthim të jetë për ta kuptuar Kur'anin e jo për ta studiuar, apo për të nxjerrë ligje (dispozita) prej atij përkthimi, apo për të analizuar analogjitë e fjalëve të atij përkthimi, por vetëm të jetë si një komentim i fjalëve të Kur'anit, si një shpjegim, e të quhet *“Përkthim i domethënieve dhe synimeve të Kur'anit”*, e jo *“Përkthim i Kur'anit”*, sepse përkthimi mund të jetë i gabuar ose edhe jo i qëlluar, ndërsa Kur'ani në gjuhën arabe:

... وَلَمْ يَجْعَلْ لَهُ عِوَجًا

“... nuk ka në të, të meta as gabime ...”

(Suretu El-Kehf, 2)

Për këtë arsye edhe Prorektori i Universitetit të Ez-herit dhe dijetarët më eminentë të Egjiptit, në gjysmëshekullin e njëzetë, e kanë ndaluar përkthimin e Kur'anit.

Prorektori i Universitetit të Ez-herit

Prorektori i Universitetit të Ez-herit jo vetëm që e ka ndaluar përkthimin e Kur'anit, por edhe ka apeluar tek çdo mysliman dhe myslimane që nëse hasin në ndonjë Kur'an të përkthyer në ndojë gjuhë të huaj, ta djegin atë përkthim ose ta zhdukin atë në çfarëdo forme, me qëllim që t'i afrohen Zotit të Lartmadhëruar.¹ Mirëpo, prorektori ka pasur për qëllim që përkthimi, i cili e zë vendin e Kur'anit në gjuhën arabe dhe përdoret si origjinali në namaz, adhurim, dhe në çështjet e tjera të domosdoshme në islam. Ndërsa, sa i përket përkthimit të tefsirit (komentimit), prej komentimeve të Kur'anit, e ka lejuar dhe nuk e ka kundërshtuar, por ka thënë si vijon:

“Janë pajtuar të gjithë ekspertët e jurisprudencës islame se komentimi, interpretimi i Kur'anit në gjuhën arabe dhe në gjuhë tjetër është i lejuar”.

Dihet mirëfilli se islami për një kohë të shkurtër është përhapur në shumë vende. Popujt e këtyre vendeve nuk e kanë njohur gjuhën arabe, kështu që namazi është shtyllë e besimit, ndërsa namazi nuk pranohet pa këndimin e Kur'anit.

Transmetohet se Ebu Hanifja e ka lejuar që të këndohet përkthimi i Kur'anit në namaz, për personin, i cili nuk e di gjuhën arabe. Përkundër kësaj edhe pse është lejuar këndimi i Kur'anit me përkthim në namaz, nuk është përkthyer Kur'ani tek myslimanët, të cilët nuk e flitnin gjuhën arabe në shekujt e parë, përpos çka tregohet se Sahabiju – Selman Faresiju e ka përkthyer suretu “El-Fatihati” në gjuhën persiane për t’u kënduar në namaz.

Ndërsa tek jomyslimanët Kur'ani është përkthyer në gjuhën latine që nga Lufta e kryqzatave.

Sipas të dhënave të deritashme, përkthimi i parë Kur'anit në Evropë është bërë në gjuhën latine në shekullin XII në vitin 1143 përgatitur nga monaku, Robert Ketenezis me iniciativën e *Petreus Venerabilis*- abat i Klunit, me urdhërin e të cilit ishte formuar një komision i posaçëm për përkthimin e veprave nga gjuha arabe në gjuhën latine. Më 1547 Kur'anin e përktheu humanisti italian ANDREA ARRIVABENIT, ndërsa më pastaj edhe në gjermanisht (1623) dhe në holandisht (1641). Studiuesi francez *Sieur Du Ryer*, e përktheu Kur'anin në gjuhën frënge më 1647 në Paris; Ndërsa më 1691 në Romë kemi edhe një përkthim në gjuhën latine, përcjellë me shumë shënime, të titulluar *"Prodomus ad refutationem Alcorani"*, që e përgatiti *Ludovico Marracci*. Ky përkthim ishte bërë drejtpërdrejt me kërkesën e Papës Inoçenti XI.

¹ Faqe 18 - دراسة حول ترجمة القرآن الكريم

Më 1734 *Georg Sale* përktheu Kur'anin në gjuhën angleze. Këtij përkthimi i paraprin një studim mjaft objektiv si për popullin, ashtu edhe për kulturën arabe, por mbi të gjitha ai kishte një qasje konstruktive ndaj Islamit si fe. Si përkthimi, ashtu edhe studimi hasën në mirëkuptim të plotë në opinionin evropian; këtë e dëshmon e dhëna se ky përkthim shërbeu si bazë për përkthimet e mëvonshme në gjuhët e tjera, si në gjermanisht (1746), frëngjisht (1770). Vetëm në Amerikë në periudhën 1833-1880 pati pesë botime. Këtë përkthim e kishte marrë për bazë edhe Ilo Mitko Qafëzezi, i cili është i pari ndër shqiptarët që iu rrek punës për përkthimin e Kur'anit.

Më 1840 *Ulmani* përktheu Kur'anin në gjermanisht. Më 1949-50 në Paris, Kur'anin e përktheu në gjuhën frënge orientalisti i njohur frëng, *Bllachéret*, i cili konsiderohet një ndër përkthimet më serioze të realizuara në Evropë nga orientalistët evropianë.

Myslimani i parë, i cili ka tentuar të përkthejë Kur'anin, ka qenë dr. Muhamed Abdul Hakim Hanë, në vitin 1905.

Kur'ani deri më tani është përkthyer në më shumë se njëqind gjuhë të ndryshme; në disa gjuhë është përkthyer shumë herë; Kur'ani vazhdon të përkthehet edhe sot e kësaj dite dhe do të vazhdojë të përkthehet edhe në të ardhmen, ashtu siç komentohet dhe do të komentohet edhe në të ardhmen.

Rreth historikut janë përpiluar bibliografi të posaçme, ndër të cilat duhet të veçohet bibliografia e punuar nga shkencëtari turk, prof. dr. Ekmeleddin Ihsanoglu “*Bibliografia Botërore mbi përkthimet kuptimore të Kur'anit Kerim - Përkthimet e botuara 1515-1980*”, botuar nga “Qendra për Hulumtimin e Historisë, të Artit dhe të Kulturës Islame”, Stamboll, 1986, e cila konsiderohet si më e kompletuara ndër bibliografite kushtuar përkthimeve të Kur'anit në gjuhët e popujve të ndryshëm nga e gjithë bota.

T a b e l a

e përkthimeve të para complete të shtypura të Kur'anit në mënyrë kronologjike sipas gjuhëve:

Nr.	Data e shtypjes	Vendi i shtypjes	Gjuha	Përkthyesi	Titulli
1	1543	Basilex	Latinishte	Robertus Ketenensis	“Machvmentis sarace-Hermennus Dalmata <i>“norwm principis, eisu 'qve successorum vitae, ac doctrina, ipse 'qve Alcoran ...”</i>
2	1547	Venedik	Italishte	Andrea Arrivabene	“L'Alcorano di Maometto, nel qual sicontiene la dottrina, la vita i costumi et le leggegi sue tradotto nouvamente dal' Arabo in lingua italiana.
3	1547	Nurnberg	Gjermanishte	Salomon Schweigger	“Alcoranus Mahumeticus, Das ist: der Turcken Alcoran, Religion und Aber Glauben.”
4	1641	Hamburg	Holandishte	Salomon Schweigger	“De Arabische Alkoran”
5	1647	Paris	Frengjishte	Anre du Ryer	“L'Alcoran de Mahomet”
6	1648	Londër	Anglishte	Alexander Ross	“The Alcoran of Mahomet”
7	1716	Petrograd	Rusishte	Piotr Vasi'yevich Postnikov	“Al-Koran Magomet”
8	1734	Helmstadt	Greqishte	Anonimus	“Qur'an Mubin”
9	1828	Lucknow	Urdishte	'Abdu's-selam Muhammed dhe Abbasi Badayuni	“Zad-i akhirat”, Manzum
10	1831	?	Hungarishte	Imre (Emory) Buziday Szdmayer – George (Gyorgy) Gedeon	“Alkoran”
11	1837	Kalkuta	Persishte	Kamal al-Din Husayn b. Ali Wa'iz Kashifi	“Mawahib-i aliya (Tafsir-i Husayni)
12	1842	Kairo	Turqishte	Muhammed el-Tefsiri (Ayintabi Debbaghzade)	“Terxheme-i Tefsiri i Tibyan”
13	1843	Stokholm	Suedishte	Fredrick Crustentolpe	“Koran”

14	1844	Madrid	Spanjollishte	De Jose garber De Robles	“Alcoran”
15	1857	Laipcig	Hebraishte	Hermann Hackendorf	“Al-Kuran o hammikra ...”
16	1858	Varshavë	Polonishte	Jana Murzu Tarak Buczackiego	“Koran (Al-Koran)”
17	1861	Bahupal	Pashtu	?	“Qur’an Maxhid mutarxham batarxhama zaban-i pashto”
18	1867	Lahore	Sindishte	Muhammed Siddiq	“Qur’an Sharif Sindhi arxhami san”
19	1870	?	Penxhabishte	Muhammad Mubarak Allah (Hafidh)	“Tefsir-i Muhammadi”
20	1879	Bombaj	Guxharatishte	Abdu al-Qadir bin Luqman	“Holy Qur’an”
21	1882	Paris	Portugalishte	Anonimus	“O Alcorao”
22	1884	Bombaj	Tamile	Habib Muhammad al- Qahiri	“Qur’an”
23	1886	Charuyantra	Bengalishte	Girish Chandra Sen	“Qur’an Sharif”
24	1895	Beograd	Serbishte	Ljubibratiq Miqu Hercegovac	“Koran”
25	1897	Cawnepore	Sanskrite	?	“Qur’an Sharif. The Holy Koran”
26	1906	Lagos	Jorube	M. S. Cole	“Al-Kur’ani”
27	1910	Varna	Armenishte	Abraham Amirchanjanz	“Qur’an”
28	1911	Lahore	Baluqi	Hudur Bakhsh Mawlana	“Tarxhama Qur’an Maxhid Bazaban baluchi”
29	1912	Cernauti Bukovija	Rumunishte	Silvestru Octavian Isopescul	“Coranul”
30	1915	Rajpur	Hindishte	Ahmad Shah Masihi	“Al-Qur’an”
31	1916	Lahore	Brahu	Muhammad Umar Dinpuri	“Qur’an Maxhid mutarxham Bazaban brahu’i”
32	1919	Copenhagen	Danishte	Pedersen	“Koranen”
33	1920	?	Japonishte	Ken-ichi Sakamoto	“Qur’an”
34	1923	Londër	Chwahili	Gotfrey Dale	“Tafsiri y Kurany ya Kiarabu kwa Lugha ya Kisawahili”
35	1923	Kairo	Malaje	Abd al-Rauf bin al-Shayk Ali al- Fansuri al-Jawi	“Anwar al-Tanzil wa asrar al-ta’wil”

36	1925	Pragë	Çekishte	Ignac Vesely	“Koran”
37	1927	Peking	Kinezishte	Tiezheng Li	“Kelanjing *The Qur’an”
38	1928	Bandung	Indonezishte	Ahmad Hassan	“al-Furqan (Tafsir Qur’an)”
39	1930	Rushçuk	Bullgarishte	Stefan-Stefan Ya Skulef Tomov	“Koraniti”
40	1937	Sarajevë	Boshnjakishte	Çausheviq-Panxha	“Kur’an çasni”
41	1938	Madras	Telugu	Chilkoori Narayana Rao	“Koran sharif”
42	1942	Tampere	Finlandishte	Z.I. Ahsen Boere	“Koraani”
43	1960	?	Afrikane	Ismail Abdurrazzak Shaikh Salih Din	“Die heilige Koeraan”
44	1967	Xhakarta	Javanishte	Kiyai Bishri	“Al-Ibriz; Qur’an, tarxhamah Djawi”
45	1969	Copenhagen	Esperante	Italo Muhammad Abd al-Hadi Chiussi	“La Nobla Korano”
46	1969	Bangkok	Thaite	Ismail bin Yahya	“Al-Quran al-Karim”
47	1970	Gauhati	Asamishte	Muhammad Sadir Ali	“Pawitra Koraana”
48	1970	Kayam Kulam	Malalishte	Muttanisseril M. Kayakkutti	“Al-Qur’an; Parusudha Qur’an”
49	1971	Bagdad	Kurdishte	Muhammadi Koyie Gali Zadeh	“Tafsir-i Kurdi”
50	1971	Seul	Koreishte	Young-Sun Kim	“Qur’an”
51	1971	Bandung	Sindanishte	H. Qamaruddin Shale A. A. Dahlan-Jus Rusamsi	“Al-Amin Al-Qur’an”
52	1972	Adis Abeba	Amharishte	Anonimus	“Holy Qur’an”
53	1973	Bambay	Marathe	Muhammad Ya’qub Khan (H. Sufi Mir)	“The Holy Qur’an”
54	1978	Banglore	Kanadishte	Anonimus	“(Divya Qura) Qur’an Majeed”
55	1979	Bejrut Hausa	Abubakare	Mahmud Gummi	“Tarjama ma’anonin al-Qur’ani maigirma Zuwa Harshen Hausa”
56	1980	Oslo	Nervegisht	Einarberg	“Koranen”
57	Pa datë	Burmë	Burmanisht	?	“Qur’an”
58	1985	Prishtinë	Shqip	Feti Mehdiu	“Kur’an-i” (vërejtja e N. Ibrahim)

EMRAT E KUR'ANIT

Zoti i Madhëruar, me diturinë e Tij absolute dhe të pakufishme, librin e Tij e ka emëruar me emra të ndryshëm. Prej këtyre emrave po përmendim si vijon:

1. KUR'AN - قرآن

إِنَّ هَذَا الْقُرْآنَ يَفُصُّ عَلَىٰ بَنِي إِسْرَائِيلَ أَكْثَرَ الَّذِي هُمْ فِيهِ يَخْتَلِفُونَ

“Vërtet, ky Kur'an tregon mbi beni israilët për të gjitha (çështjet) për të cilat janë konfrontuar (dhe janë përçarë)”.

(En-Neml, 76)

2. FURKAN - فرقان

Furkan është infinitiv i foljes فرق (Fereka), që do të thotë **me nda**, e që ka kuptimin - Libri që ndan dhe dallon të vërtetën nga e pavërteta; të keqen nga e mira etj.:

تَبَارَكَ الَّذِي نَزَّلَ الْفُرْقَانَ عَلَىٰ عَبْدِهِ لِيَكُونَ لِلْعَالَمِينَ نَذِيرًا

“I Lartëmadhëruar është Ai (Allahu) që ia zbrit **Furkanin** robit të tij (Muhamedit) që të bëhet për tërë botën pejgamber (këshillues)”

(El-Furkanë, 1)

3. KITAB - كتاب

Kitab d.m.th. **libër** që ka kuptim Libri i Allahut.

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَنْزَلَ عَلَىٰ عَبْدِهِ الْكِتَابَ وَلَمْ يَجْعَلْ لَهُ عِوَجًا

“Falënderimi i takon vetëm Allahut që ia zbriti robit të vet **Librin** dhe në të nuk (lejoi) të bëhet kurrfarë shtrembërimi”.

(El-Kehf, 1)

4. DHIKR - ذكر

Dhikr do të thotë **përkujtues, vërejtje, përkujtim, përmend**.

وَهَذَا ذِكْرٌ مُّبَارَكٌ أَنْزَلْنَاهُ أَفَأَنْتُمْ لَهُ مُنْكَرُونَ

“Dhe ky është **Përkujtimi** (Kur'ani) i bekuar (të cilin) e kemi zbritur (atë), e ju jeni që atë po e kundërshtoni?”

(El-Enbija, 50)

5. TENZIJJL - تنزيل

Tenzil do të thotë **zbritje**.

وَإِنَّهُ لَنَزِيلُ رَبِّ الْعَالَمِينَ . نَزَلَ بِهِ الرُّوحُ الْأَمِينُ .

“E, vërtet ai (Kur’ani) është **Zbritje** e Zotit të botëve. E ka zbritur (nëpërmjet) të Shpirtit Besnik”.

(Esh-Shuara, 192-193)

6. VAHJ - وَحْي

Vahj do të thotë frymëzim, shpallje, informim i sekretit, lajmërim i të panjohurës, tregim i të fshehtës.

قُلْ إِنَّمَا أُنذِرُكُم بِالْوَحْيِ وَلَا يَسْمَعُ الصُّمُّ الدُّعَاءَ إِذَا مَا يُنذَرُونَ

“Thuaj padyshim unë ju këshilloj (ju tërheq vërejtjen) vetëm me VAHJIN (shpallje) ...”.

(El-Enbija, 45)

7. KASAS - قِصَص

Kasas do të thotë rrëfim, tregim.

إِنَّ هَذَا لَهُوَ الْقَصَصُ الْحَقُّ

“Vërtet ky (Kur’an) është **Tregim (Kasas)** i vërtetë”.

(Ali Imran, 62)

9. RUHË - رُوح

وَكَذَلِكَ أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ رُوحاً مِنْ أَمْرِنَا ...

“Ja kështu ne ta shpallim ty Kur’anin (**RUHIN**) me urdhrin Tonë”.

(Shura, 52)

CILËSITË E KUR’ANIT

Përpos emrave të Kur'anit, Kur'ani është specifikë e karakterizuar me cilësi mrekulluese ku tregohet mrekullia e Kur'anit edhe në bazë të cilësive. Po i përmendim cilësitë e Kur'anit:

10. MUBINË - مبین

Mubinë do të thotë **i qartë, i hapët**.

تِلْكَ آيَاتُ الْكِتَابِ وَقُرْآنٍ مُبِينٍ ...

“Këta janë ajetet e Kur'anit dhe librit të hapët (të qartë)”.

(Hixhr, 1)

11. NURË - نور

Nurë do të thotë **dritë**.

يَا أَيُّهَا النَّاسُ قَدْ جَاءَكُمْ بُرْهَانٌ مِنْ رَبِّكُمْ وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكُمْ نُورًا مُبِينًا

“O ju njerëz sigurisht ju ka ardhur argumenti prej Zotit Tuaj dhe ju kemi zbritur **dritën** (Kur'anin) e qartë”.

(En-Nisa, 174)

12. HAK - حق

Hak do të thotë **e sigurt, e vërtetë, e pamohueshme**.

وَالَّذِي أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ مِنَ الْكِتَابِ هُوَ الْحَقُّ مُصَدِّقًا لِمَا بَيْنَ يَدَيْهِ إِنَّ اللَّهَ بِعِبَادِهِ لَخَبِيرٌ بَصِيرٌ

“Dhe atë të cilën ta kemi shpallur Ne, ty prej Librit është **e vërtetë (HAK – e sigurt dhe e pamohueshme)**”.

(Fatir, 31)

13. ARABIJUN - عربي

قُرْآنًا عَرَبِيًّا غَيْرَ ذِي عِوَجٍ لَعَلَّهُمْ يَتَّقُونَ

“Kur'ani në gjuhën (e pastër) **arabe** pa pasur kurrfarë shtrembërimi në të me qëllim që ata (të jenë të devotshëm) të frikohen”.

(Ez-Zumer, 28)

14. AZIZË - عزيز

Azizë do të thotë **i fortë, i fuqishëm**.

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا بِالدُّكْرِ لَمَّا جَاءَهُمْ وَإِنَّهُ لَكِتَابٌ عَزِيزٌ

“Vërtet ata që mohuan (Kur'anin) për këshillat pasi u erdhën atyre, ndërsa vërtet ai (Kur'ani) është **Libër i fortë dhe i fuqishëm**”

(Fusilet, 41)

15. MEXHIDË - مجيد

Mexhidë do të thotë **i lartësuar dhe i falënderuar, famëlartë**.

بَلْ هُوَ قُرْآنٌ مَجِيدٌ

“Por gjithsesi është Kur'an **famëlartë**”.

(El-Buruxhë, 21)

SURET E KUR'ANIT

Në kuptimin etimologjik sure do të thotë **ngritje, lartësi e çmimit, lartësi e vlerës**.

Në kuptimin terminologjik sure do të thotë *përmbledhje e cila përfshin ajetet në një koleksion duke pasur fillimin dhe mbarimin*.

Sureja më e shkurtër përbëhet prej 3 ajeteve. Disa dijetarët suren e kanë krahasuar me pjesët e ndërtesës, të cilat e formojnë atë.

Sido që të jetë, SURE është quajtur për shkak të ngritjes së vlerës, për arsye se është fjalë e Allahut prej së cilës kuptohet e lejuara dhe e ndaluara.

Për këtë arsye nuk është mirë të emërohet Sureja me fjalën kaptinë, kapitull etj.

Kur'ani përbëhet prej 114 sureve.

AJETET E KUR'ANIT

Fjala آية - AJET ka tri domethënie:

- domethënia e parë: **ajet është bashkësi e shkronjave**,
- domethënia e dytë: **çuditëse, mahnitëse**,
- domethënia e tretë: **shenjë, sinjal**.

Pra nëse i kombinojmë këto domethënie fitojmë se ajeti është bashkësi e shkronjave, e cila të habit, të çudit, të mahnit: në radhitje, në kuptim, në sistematizimin e tyre, sepse ai rregullim dhe ai sistematizim e jep kuptimin të cilën ia ka dhënë vetëm Zoti i Madhëruar me diturinë e Tij të pakufishme dhe njëherazi ai organizim dhe rregullim i shkronjave është shenjë dhe vërtetim për pejgamberinë e Muhamedit a.s..

PËRKTHIMI I FJALËS AJET

Fjala آية - ajet në Kur'anin fënisht është përsëritur 382 herë. Kjo fjalë ka domethënie të shumëfishtë si: “ajet i Kur'anit” (tekst, pjesë, fjali e Kur'anit); mrekulli (muëxhize); shenjë në gjithësi; argument; këshillë; shëmbëlltyrë; përkujtim etj.

Feti Mehdiu në shumë raste fjalën ajet e ka përkthyer *ajet*, pra ku kjo fjalë posaçërisht ka pasur të bëjë me ajetet e Kur'anit, mirëpo në disa raste nuk e ka përkthyer kështu, por e ka përkthyer “*fakte*” dhe “*argumente*”.

Në suretu El-Xhathije”, ajetin e 6-të e përkthen:

“Ato janë **argumentet** e Allahut ...”. Po në të njëjtën sure, ajetin e 8-të e përkthen:

“I dëgjon **ajetet** e Allahut ...”.

Në suretu Err-Rraëd e përkthen:

“Këto janë **fakte** të librit”.

Pasi që fjala ajet është përkthyer *ajet* në suretu Junus, ajeti i 1-rë; suretu Jusuf, ajeti i 1-rë; suretu Ali Imran, ajeti i 113-të; suretu Ali Imran, ajeti i 58-të; suretu Nahl, ajeti i 101-të. Pra, në të shumtën e rasteve fjalën ajet e ka përkthyer *ajet*, apo me fjalë të tjera e ka lënë ashtu siç është në Kur'an – *ajet*, ndërsa në disa raste e ka përkthyer *argument*, ndërsa në disa raste “*fakte*” të librit.

Njësoj ka vepruar edhe *Sherif Ahmeti* ku në suretu Ali Imran ajetit 4; suretu En-Nahl, ajeti i 101-të; suretu Ali Imran ajeti i 58-të, i 113-të; suretu Junus, ajeti i 1-rë; suretu Jusuf, ajeti i 1-rë; suretu Err-Rraëd, ajeti i 1-rë.

Nëse shikojmë në suretu El-Xhathije, ajetin e 6-të e përkthen “**fakte** të Allahut”, ndërsa ajetin e 8-të e bart origjinal “dëgjon **ajetet** e Allahut”.

Hasan Nahi në shumë ajete e përkthen apo me fjalë të tjera e bart origjinalitetin e fjalës *ajet* si në suretu En-Nahl, ajeti 101; suretu Jusuf, ajeti 1, suretu Merjem, ajeti 1, ndërsa në raste të tjera e përkthen *verset*, *dokument* dhe *argument*.

Në *gjuhën angleze* ajeti është përkthyer **signs - shenja**:

“To recite our **signs** to you”

“Për t’i lexuar **shenjat-faktet** tona te ju”.

Ndërsa në suretu En-Nahl, ajeti 101-të është përkthyer kështu:

وَإِذَا بَدَّلْنَا آيَةً مَّكَانَ آيَةٍ

“**And when we exchange a verse in the place**

“Dhe kur Ne ndërrojmë vendet e **verseteve**

of anather verse”

me **versete** të tjera”.²

Ndërsa, sa i përket përkthimit të ajetit të 128-të në suretu Esh-Shuaraë:

أَتَبْنُونَ بِكُلِّ رِيْعٍ آيَةً تَعْبَثُونَ

Mund të përkthehet ajeti: çudira, ndonjë shtëpi, godinë (përmendore, simbol, përkujtimore, statujë etj.) ashtu edhe disa prej këtyre formave janë përkthyer.

Qëllimi kryesor i zbritjes së Kur’anit është:

E para:

Që të jetë mrekulli mbinjerëzore, e cila vërteton peygamberinë e Muhamedit a.s. dhe transmetimin e misionit të Zotit të Madhëruar, se Zoti i Madhëruar e ka zbritur me një metodë të posaçme, me domethënie specifike në jurisprudencë dhe në njohuritë e përgjithshme, të cilat janë elemente të mrekullisë së Kur’anit.

Zoti i Madhëruar i ka thënë Muhamedit a.s. që t’i thërrasë njerëzit dhe xhinët që të gjithë të tubohen, dhe së bashku të përpilojnë një Kur’an të tillë nëse munden, por prapë ata do të jenë të paaftë:

وَإِنْ كُنْتُمْ فِي رَيْبٍ مِّمَّا نَزَّلْنَا عَلَىٰ عَبْدِنَا فَأْتُوا بِسُورَةٍ مِّثْلِهِ
وَادْعُوا شُهَدَاءَكُمْ مِنْ دُونِ اللَّهِ إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ

“Po nëse (ju njerëzit) dyshoni pak në atë çka i kemi zbritur robit tonë (Muhamedit a.s.) bjereni (përpiloni) një sure (sikurse Kur’ani) të ngjashëm me të dhe thirrni dëshmitarët nga ju nëse flitni të vërtetën”.

(El-Bekare, 23)

قُلْ لِّئِنْ اجْتَمَعَتِ الْإِنْسُ وَالْجِنُّ عَلَىٰ أَنْ يَأْتُوا بِمِثْلِ هَذَا الْقُرْآنِ
لَا يَأْتُونَ بِمِثْلِهِ وَلَوْ كَانَ بَعْضُهُمْ لِبَعْضٍ ظَهِيراً

² THE KORAN INTERPRETED By: Arthur J. Arbery

“Thuaj (o Muhamed) po nëse tubohen njerëzit dhe xhinët për të përpiluar diçka të ngjashme me këtë Kur'an nuk do të (jenë në gjendje) përpilojnë diçka të tillë si ai (Kur'ani) edhe nëse i ndihmojnë njëri-tjetrit”.

(El-Israë, 88)

E dyta:

Që të jetë burim i udhëzimit dhe drejtimit në rrugë të drejtë, dhe të jetë burim kryesor i sheriatit islam që për çdo çështje të kthehemi tek Ai.

اتَّبِعُوا مَا أُنزِلَ إِلَيْكُم مِّن رَّبِّكُمْ وَلَا تَتَّبِعُوا مِنْ دُونِهِ أَوْلِيَاءَ ...

“Pasoni (bazohuni) atë çka ju është zbritur prej Zotit Tuaj dhe mos pasoni tjetër dashamir përpos Tij”.

(A'rafë, 3)

... تِلْكَ حُدُودُ اللَّهِ فَلَا تَعْتَدُوهَا وَمَن يَتَعَدَّ حُدُودَ اللَّهِ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الظَّالِمُونَ

“Këto janë dispozitat (ligjet) e Allahu. Kush i tejkalon dispozitat (ligjet) e Allahut, mu ata janë të cilët bëjnë padrejtësi”.

(El-Bekare, 229)

E treta:

Qëllimi i Kur'anit ka qenë zhdukja e fanatizmit, racizmit dhe injorancës.

يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنَّا خَلَقْنَاكُمْ مِنْ ذَكَرٍ وَأُنْثَىٰ وَجَعَلْنَاكُمْ شُعُوبًا وَقَبَائِلَ لِتَعَارَفُوا
إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِنْدَ اللَّهِ أَتْقَاكُمْ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ خَبِيرٌ

“O ju njerëz Ne ju kemi krijuar prej një mashkulli dhe prej një femre dhe ju kemi bërë në popuj e fise që të njiheni (të keni mirëkuptim), ndërsa padyshim më fisniku prej juve tek Allahu është më i Devotshmi. Allahu është i Ditur dhe i Informuar (për çdo gjë)”.

(El-Huxhuratë, 13)

TEMATIKAT E KUR'ANIT

Sa i përket Kur'anit, lirisht mund të themi se përfshin sistemin dhe organizimin e Islamit dhe rregullat e posaçme që kanë lidhje me fenë dhe këtë botë.

... مَا فَرَّطْنَا فِي الْكِتَابِ مِنْ شَيْءٍ ...

“Nuk kemi lënë mangu (pa e përceptuar) asgjë në këtë Libër (Kur'an)”.

(El-En'amë, 38)

Pra, nuk ka asnjë çështje, e cila ekziston e të cilën Kur'ani për së afërmi apo për së largu nuk e ka zbuluar, mirëpo mund t'i përmendim tërthorazi tematikat si vijon:

1. IMANI

a) Besimi në Allahun Krijues të gjithësisë

Kur'ani i zhduk besimet e kota, besëtytnitë, idhujtarinë, njëherit pandërprerë përsërit besimin vetëm në Allahun dhe largimin nga besimi në idhuj, të cilët nuk mund të sjellin as dëm as dobi.

سَبَّحَ لِلَّهِ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ .
لَهُ مُلْكُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ يُحْيِي وَيُمِيتُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

“E lartëson dhe e madhëron Allahun gjithçka ka në qiej dhe në tokë. Ai është i Fuqishëm i Mençur. I Tij është sundimi në qiej dhe në tokë, (Ai) ngjall dhe i bën krijesat prapë të vdesin, dhe Ai ka mundësi për çdo send”.

(El-Hadid, 1-2)

b) Besimi në ringjallje dhe përgjegjësi për vepra, pra, besimi në Ditën e Gjykimit

أَفَحَسِبْتُمْ أَنَّمَا خَلَقْنَاكُمْ عَبَثًا وَأَنَّكُمْ إِلَيْنَا لَا تُرْجَعُونَ

“A keni menduar se vërtet juve ju kemi krijuar kot (pa kurrfarë qëllimi) dhe ju nuk do të ktheheni tek Ne”.

(El-Muëminun, 115)

كُلُّ نَفْسٍ ذَائِقَةُ الْمَوْتِ وَإِنَّمَا تُوَفَّقُونَ أُجُورَكُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ فَمَنْ زُحْزِحَ عَنِ النَّارِ وَأُدْخِلَ الْجَنَّةَ فَقَدْ فَازَ وَمَا الْحَيَاةُ الدُّنْيَا إِلَّا مَتَاعُ الْغُرُورِ

“Çdo gjë (krijesë) do ta shijojë vdekjen, ...”.

(Ali Imran, 185)

2. Nxiti në hulumtim, studim dhe vështrim në krijimin e qiejve dhe të tokës.

وَتَرَى الْجِبَالَ تَحْسَبُهَا جَامِدَةً وَهِيَ تَمُرُّ مَرَّ السَّحَابِ صُنْعَ اللَّهِ الَّذِي أَتَقَنَ كُلُّ

شَيْءٍ

إِنَّهُ خَبِيرٌ بِمَا تَفْعَلُونَ

“Dhe i sheh kodrat e mendon se janë të palëvizshme, ndërsa ato ecin si ecja e mjegullave”. Krijimtaria e Allahut, i cili ka përsosur çdo gjë. Vërtet Ai është i informuar për çdogjë çka veproni”.

(Neml, 88)

إِنَّا كُلَّ شَيْءٍ خَلَقْنَاهُ بِقَدَرٍ

“Vërtet Ne, çdo gjë kemi krijuar në përsosshmëri, harmoni dhe në masë të caktuar”.

(El-Kamer, 49)

3. Tregimin e të lashtëve, goftë individ apo popuj

Kur’ani tregon për shumë popuj duke vërtetuar se të mirët ngadhnjejnë, ndërsa të këqijtë shkatërrohen. Ky ka qenë qëllimi i Kur’anit për të rrëfyer për ata popuj, për këtë arsye nuk ka përcaktuar kohën, vendin, vitin, personin dhe nuk ka shpjeguar me metodë kronologjike.

4. Qortimin, premtimin, këshillimin dhe tërheqjen e vërejtjes

Kur’ani ka zgjedhur dy rrugë:

a) Premtimin dhe kërcënimin e atyre, të cilët e trashëgojnë token gjatë historisë:

وَعَدَ اللَّهُ الَّذِينَ آمَنُوا مِنْكُمْ وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَيَسْتَخْلِفَنَّهُمْ فِي الْأَرْضِ

“U premton Allahu atyre të cilët nga mesi i juaj besojnë dhe bëjnë vepra të mira do t’i bëjë mëkëmbës në tokë”.

وَضَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا قَرْيَةً كَانَتْ آمِنَةً مُطْمَئِنَّةً يَأْتِيهَا رِزْقُهَا رَغَدًا مِنْ كُلِّ مَكَانٍ فَكَفَرَتْ بِأَنْعَمِ اللَّهِ فَأَذَاقَهَا اللَّهُ لِبَاسَ الْجُوعِ وَالْخَوْفِ بِمَا كَانُوا يَصْنَعُونَ

“Allahu sjell shembullin e një fshati kur ishte i sigurt, i qetë të cilit i vinte furnizimi nga të gjitha anët sa kishin nevojë dhe sa dëshironin, mirëpo që nga momenti kur ata i përbuzën dhe nuk ishin mirënjohës për të mirat e Allahut, atëherë Allahu ua veshi petkun e urisë dhe frikës, (pra ky ishte ndëshkim) për shkak të veprimeve të tyre”.

(Nahl-112)

b) Jep shpresë dhe fut frikë për në ahiret (botën tjetër).

... وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ يُدْخِلْهُ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا وَذَلِكَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ

“Kush e dëgjon Allahun dhe të dërguarin e Tij e i nënshtrohet urdhërave të tyre, (Allahu) e shpie në Xhenet ku do të rrjedhin lumenj, aty do të jenë përgjithmonë. Ky është (shpëtimi) shpërblim i madh”.

(En-Nisa, 13)

وَمَنْ يَعْصِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَيَتَعَدَّ حُدُودَهُ يُدْخِلْهُ نَارًا خَالِدًا فِيهَا وَلَهُ عَذَابٌ مُهِينٌ

“Kush i kundërshton urdhërat e Allahut dhe të dërguarit të Tij dhe i tejkalon (nuk u përmbahet) dispozitat e Allahut, do të hidhet në Xhehenem, aty do të jetë përgjithmonë, për të ka dënim të dhimbshëm”.

(En-Nisa, 14)

5. Ligjet juridike dhe kushtetutën njerëzore

Kur’ani ka vendosur bazat e jurisprundencës dhe na ka urdhëruar organizimin e jetës në ndërlidhje me Allahun, në marrëdhënie në mes veti.

6. Kur’ani ka pasur për qëllim ruajtjen e ambientit shoqëror, me qëllim që Islami të jetë Umet Mesatar në besim, moral, adhurim dhe në fushëveprim të jetesës.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَحْرُمُوا طَيِّبَاتِ مَا أَحَلَّ اللَّهُ لَكُمْ وَلَا تَعْتَدُوا إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ الْمُعْتَدِينَ

“O ju që keni besuar, mos i ndaloni të mirat që ju ka lejuar Allahu dhe mos e teproni, pse vërtet Zoti nuk i do ata që e teprojnë”.

(El-Maide, 77,78)

FILLIMI I SUREVE

Dijetari i njohur Kastelani përmend se Zoti i Madhëruar i ka filluar suret e Kur'anit në dhjetë mënyra:

Mënyra e parë: Me falënderim dhe madhërim Allahun.

Katërmbëdhjetë sure fillojnë në këtë mënyrë dhe pikërisht shtatë sure fillojnë me الحمد لله “ELHAMDU LIL-LAH”, dy sure fillojnë me تبارك “TEBAREKE”, ndërsa shtatë të tjera me سبحان “SUBHANE – سَبَّح SEBEHA – جُـسَبِيـه JUSEBIH – سَبَّح SEBIH”.

Mënyra e dytë: Me thirrje-proklamatë.

Në këtë mënyrë fillojnë 10 sure, e ato janë:

En-Nisa, El-Maide, Haxh, El-Ahzab, Huxhuratë, Mumtehine, Et-Talak, Et-Tahrijm, Muzemil, Mudethir.

Mënyra e tretë: Me fjali lajmëruese.

Në këtë mënyrë fillojnë 13 sure.

Mënyra e katërt: Me Përbetim.

Në këtë mënyrë fillojnë 15 sure, e ato janë:

Edh-Dharijatë, Et-Tur, En-Nexhm, El-Kijame, Murselatë, Buruxhë, Tarik, El-Fexhr, Kaf, El-Beled, Esh-Shems, El-lejl, Ed-Duha, Et-Tinë, El-Adijatë, El-Asr.

Mënyra e pestë: Me “kushtore” (Idha).

Në këtë mënyrë fillojnë 7 suret vijuese:

El-Vakia, El-Munafikun, Et-Tekvir, El-Infitar, El-Inshikak, Ez-Zelzele, En-Nasr.

Mënyra e gjashtë: Me “urdhërore”, “thuaj” dhe “lexo”.

Në këtë mënyrë kanë filluar 6 suret vijuese:

El-Xhin, El-Kafirun, El-Ihlas, El-Felek, En-Nas.

Mënyra e shtatë: Me mënyrën pyetëse.

Format pyetëse me të cilat fillojnë suret e Kur’anit janë: **عَمَّ** “Për çka?”,

أ- هل “A?” dhe atë në suret që vijojnë:

El-Filë, El-Maunë, El-Insan, En-Nebeë, El-Gashijeh, El-Inshirah.

Mënyra e nëntë: Me shkas - arsye.

Kjo mënyrë vjen vetëm në një sure, e ajo është sureja Kurejsh.

Mënyra e dhjetë: Me shkronjat e alfabetit.

Kjo mënyrë e Kur’anit realizohet në 29 sure.

- Me një shkronjë fillojnë 3 suret vijuese:

ص Sad, **ق** Kaf dhe **ن** Nun.

- Dhjetë sure fillojnë me dy shkronja;

- Tri sure fillojnë me tri shkronja: **الم** “Elif Lam Mimë”, **الر** “Elif lam Ra” dhe **طسم** “Ta Sin Mimë”;

- Dy sure fillojnë me katër shkronja: Suretul A’rafë fillon me **المص** “Elif Lam Mimë Sad”, dhe suretu Err-Rread fillon me **المر** “Elif Lam Mim Ra”;

- Një sure fillon me pesë shkronja, e ajo është suretu Merjem, e cila fillon me **كهيعص** “Kaf Ha Ja Ajn Sad”.

A decorative border in a traditional Islamic geometric style, featuring repeating floral and star motifs in gold, green, red, and blue, with a pink and white scalloped inner edge.

SHKRONJAT E ALFABETIT ARAB



FILLIMI I SUREVE ME SHKRONJA TË ALFABETIT ARAB

Njëzet e nëntë sure të Kur'anit Fisnik fillojnë me shkronja të alfabetit. Fillimi i sureve me shkronja të alfabetit është fshehtësi prej fshehtësive të Kur'anit. Ndonjëherë edhe suret emërohen me këto shkronja, sepse këto shkronja janë të vendosura vetëm në fillim të sureve e jo në mes apo në fund, ndryshe quhen edhe *shkronja të fillimit të sureve*.

Ibni Abasi thotë se Allahu i Lartmadhëruar është përbetuar në këto shkronja për shkak të vlerës dhe rëndësisë së tyre që kanë në formulimin dhe shkrimin e librave të zbritura prej Allahut, dhe me këto shkronja shkruhen emrat e bukur të Allahut. Nga kjo kuptohet se këto shkronja janë simbole dhe shenja të gjuhës, të cilën Allahu ia ka mësuar Adem-it a.s., prej së cilës gjuhë pastaj janë degëzuar të gjitha gjuhët e botës. Dhe sikurse tërë popujt e kanë burimin prej Adem-it a.s., ashtu edhe të gjitha gjuhët e kanë burimin te gjuha e Adem-it a.s., të cilën gjuhë ia ka mësuar Zoti Fuqiplotë.

Suret ndonjëherë fillojnë me një shkronjë të alfabetit arab, ndonjëherë me dy, ndonjëherë me tri, ndonjëherë me katër, e ndonjëherë me pesë.

Patjetër duhet të theksojmë se suret nuk fillojnë me zërimin e shkronjës, por vetëm me bërthamën e shkronjës, p.sh. nuk është shkruar “Nun” (نون), por është shkruar vetëm bërthama “N” (ن).

Po ashtu janë ndërprerë dy shkronja prej tri të tjerave në surën حم . عسق, ndërsa nuk janë ndërprerë shkronjat në surën المص dhe كهيعص . Kjo është vetëm fshehtësi prej fshehtësive të Allahut xh.sh.!

Tani shtrohet pyetja: Si të veprohet gjatë përkthimit të Kur’anit? A të shkruhen shkronjat ashtu siç janë në gjuhën arabe, ndërsa pas vizës të shkruhen edhe në përkthim apo nëse i shkruajmë në përkthim, si të gjenden shkronjat, të cilat i përshtaten atyre shkronjave?

Dhe nëse i gjejmë shkronjat, si të veprojmë?

- Të ndahen shkronjat me vizë,
- të ndahen shkronjat me pikë,
- të ndahen shkronjat me presje,
- të ndahen shkronjat me pauzë, apo si të veprojmë?!

Nëse merret një rregull, atëherë me atë rregull duhet vepruar në të njëzet e nëntë rastet e tjera njësoj, p.sh.:

ELIF-LAM-MIM ose
ELIF. LAM. MIM ose
ELIF, LAM, MIM ose
ELIF LAM MIM.

Ndërsa ne do të shohim se si kanë vepruar përkthyesit te njëzet e nëntë rastet:
الم:

Feti Mehdiu:

Alif Lam Mim

Deri te suretu Ja Sinë vepron njësoj, mirëpo kur e shkruan emërtimin e sures, e shkruan “Jasinë”, por edhe kur e përfundon shkronjën “Sinë” i vendos pikëpyetje. Këtë e bën duke u bazuar në atë se “Ja, Sinë” do të thotë: “O Njeri!?” , e që kjo është vetëm një variant, ndërsa dihet mirë se këto dy shkronja janë fshehtësi e Kur’anit.

Sherif Ahmeti

për dallim nga Feti Mehdiu i ndan shkronjat me presje:

Elif, Lamë, Mimë. – dhe e përfundon me pikë, ndërsa në suretu Merjem e përfundon me pikëçuditëse:

Kaf, Ha, Ja, Ajn, Sadë!

Ndërsa, kur e shkruan emërtimin në suretu “Ta Ha” nuk e shkruan ashtu siç është fillimi i surës “Ta Ha”, por e shkruan me ndërprerje, jo me presje. Ndërsa, në suretu “Ja, Sinë” e emëron suren “JASINË” pa kurrëfarë ndërprerjeje.

Bëhet pyetja: Pse ?

Hasan Nahi

shkronjat i ndan me presje në suretu El-Bekare:

Elif, Lam, Mim.

- ndërsa menjëherë suren e dytë e ndryshon rregullin dhe e ndan me ndërprerje, në suretu Ali Imran:

Elif Lam Mim.

Për dallim nga Sherif Ahmeti, suretu Merjem - ajetin e parë nuk e përfundon me pikëçuditëse, por me pikë (.):

1. Kaf, Ha, Ja, Ajn, Sad.

Suretu “Ta Ha” e ndan me presje: “Ta, Ha”, ndërsa kur ta emërton nuk e ndërpret fare, por e shkruan “TaHa”.

Hasan Nahi e ndryshon rregullën te suretu “Ja Sinë” dhe i ndan dy shkronjat e alfabetit me ndërprerje “Ja Sin”, ndërsa kur e paraqet emërtimin e sures nuk e ndan fare, por e shkruan “Jasinë”, pra pa ndërprerje dhe shkronjën “s” (sin) me shkronjë të vogël.

Për dallim nga shkronjat në suret e tjera ai në suretu Sad, kur e përfundon shkronjën Sad i vendosë pikëçuditësen (!), ndërsa të tjerët nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Bëhet pyetja: Pse?

Asnjëri prej tre përkthyesve nuk i ka ndarë shkronjat me pikë (.).

Në gjuhën angleze

Përkthyesi në gjuhën angleze Abdullah Jusuf Ali “The Holy Quran”, Text Translation and Commentary by Abdullah Jusuf Ali, fillimin e sures Bekare e shënon kështu:

A. L. M.

Mirëpo, ai në rastet e tjera nuk vepron ashtu.

Ja si i ka shënuar:

ALIF, LAM, MIM, SAD.

Në suretu Merjem:

KAF, HA , YA, AIN, SAD.

Duhet pasur parasysh se shkronjat latine nuk përputhen me shkronjat arabe, por këtu është bërë ndryshimi i rregullit, njëherë është shkruar Elifi me “A”, ndërsa herën tjetër me “ALIF”, sepse shkronja “A” latine nuk përputhet me Elifin në gjuhën arabe.

Përkthyesi tjetër në gjuhën angleze N. Y. Dawood “*The Koran a New Translation*”, i cili është botuar në Britaninë e Madhe në vitin 1956, kur vjen te fillimi i sureve me një shkronjë të alfabetit arab e shohim se nuk i ka shënuar, siç është rasti me suretu NUN (ن), suretu KAF (ك) dhe suretu SAD (ص). Pasi që edhe suret e kanë të njëjtin emër, ai nuk i ka konsideruar ajete në vete ose pjesë të ajeteve, por i ka eliminuar në tërësi në përkthim. Ndoshta ka menduar se vendosja e shkronjës në fillim të sures është emërtimi i sures.

**GABIME NË PËRKTHIMIN
E PJESËZAVE**



PJESËZA “ما” - “MA”

Pjesëza “ما” (MA) në gjuhën arabe ka këto domethënie:

(ما) – Nuk (mohuese), shembull:

وَمَا عَلَّمْنَاهُ الشُّعْرَ وَمَا يَنْبَغِي لَهُ إِنْ هُوَ إِلَّا ذِكْرٌ وَقُرْآنٌ مُبِينٌ

“Nuk i kemi mësuar poezi”. (Ja sin 69,)

(ما) – Çka? (pyetëse), shembull: مَا لَهَا – “Çka kjo?” (Ez-Zelzele, 3)

(ما) – Çka? (pjesëz shtesë), shembull: حَتَّى إِذَا مَا جَاءُوهَا – “Dhe derisa u erdhi atyre ... (Fusilet, 20)

(ما) – Çka? (kushtore), sh. : وَمَا تَفْعَلُوا – “... dhe çka do që veproni” (El-Bekare, 197)

(ما) – Çka? (ndajfolje), shembull: مَا دُمْتُ حَيًّا – “... deri sa të jem gjallë” (Merjem, 31)

(ما) – Që? sh.: كَمَا عَلَّمَكُم مَّا لَمْ – “... atë që ju nuk ...” (El-Bekare, 239)

(ما) – Çka? (sifetull ibham), shembull: “Xhiëtu li emrin ma ...” - “... për diçka..”

(ما) – Çka? (habitore), shembull: قَتَلَ الْإِنْسَانُ مَا أَكْفَرَهُ – “Për çka ka mohuar?!”.
(Abese, 17)

Përkthyesi i Kur’anit ose mund të jetë joarab, i cili e ka mësuar gjuhën arabe dhe e ka përkthyer Kur’anin në gjuhën e tij, ose të jetë arab, i cili e ka

mësuar një gjuhë dhe e përkthen Kur'anin në atë gjuhë. Ky i fundit, por edhe i pari nuk janë asgjë tjetër pos komentues ose interpretues të Kur'anit, me fjalë të tjera interpretues të kuptimeve të pjesëzave, lidhëzave, përemrave etj. etj. Mirëpo, te interpretimet kemi interpretim (Teëvil) të ndaluar dhe interpretim (Teëvil) të lejuar.

Sa i përket interpretimit të ndaluar të pjesëzës “ما” (Ma) e kemi shembullin:

... مَا خَلَقَ اللَّهُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ ...

“... dhe **çka** ka krijuar Allahu qiejt dhe tokën ...”.

(Err-Rrum, 8)

Në këtë rast pjesëza ما (Ma) ka domethënien “çka”, ndërsa është e ndaluar të interpretohet në këtë rast pjesëza ما (Ma) me domethënien E pjesëzës mohuese “nuk”: “... dhe **nuk** i ka krijuar”, sepse ky lloj interpretimi në këtë ajet shpie në pabesim. Ndërsa, ka raste kur pjesëza ما (Ma) mund të përkthehet edhe si pjesëz mohuese “nuk”, por edhe si “çka”. Shembull kemi në suretu Ja sin:

لَتُنذِرَ قَوْمًا مَّا أُنذِرَ آبَاؤُهُمْ

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Të thërrasësh një popull, të parët e të cilit **nuk kanë qenë të thirrur** ...”

(Jasin, 6)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Për t’ia tërhequr vërejtjen një populli që të parëve të tyre **nuk u është tërhequr**”.

(Jasin, 6)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Që ta paralajmërosh popullin-paraardhësit e të cilit **nuk ishin të paralajmëruar**”.

(Jasin, 6)

Pjesëza “ما-Ma” në gjuhën arabe ka shumë domethënie, por po i përmendim vetëm këto dy domethënie të kundërta:

مَا لَهُمْ – Ma lehum – “Çka kanë ata”.

مَا كَانَ لَهُمْ – Ma kane lehum – “Nuk ka qenë për ta”.

Pra ما – **çka** dhe ما - **nuk**.

Përkthyesi në ajetin e lartëpërmendur mund t’i përdorë të dy variantet.

مَا أُنْذِرَ آبَاؤُهُمْ – **Ma** undhire abauhum – “**Çka** iu është tërhjekur vërejtja prindërve (stërgjygjëve) të tyre”.

مَا أُنْذِرَ آبَاؤُهُمْ – **Ma** undhire abauhu – “**nuk** u është tërhequr vërejtja prindërve të tyre”.

Sepse arabëve para shpalljes së Kur’anit nuk u është tërhequr vërejtja për atë arsye kanë qenë indiferentë.

Ndërsa arabëve të hershëm prej Ismailit a.s. u është tërhequr vërejtja, por prapë ata janë indiferentë.

Ngase në Meke ka pasur arabë, të cilët kanë besuar në fenë e pastër të Ibrahimit a.s. (Milete ebijkum Ibrahim hanifa).

Pra, nëse e përkthejmë pjesëzën مَا – “Ma”-“**Nuk**”, atëherë fjalën “Abauhum” e përkthejmë “prindërit e tyre”:

“Çka **nuk** u është tërhequr vërejtja **prindërve të tyre**”.

Por, nëse e përkthejmë pjesëzën مَا – “Ma”-“**Çka**”, atëherë fjalën “Abauhum” e përkthejmë “stërgjyshët e tyre”:

“**Çka u është** tërhequr vërejtja **stërgjyshërve të tyre**”.

(Jasin, 6)

Shembulli tjetër në suretu El-Kamer, ajeti i 5-të:

حِكْمَةٌ بَالِغَةٌ فَمَا تُغْنِ النُّذُرُ

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Urtësi e përsosur – por, **vërejtje e padobishme**”.

(El-Kamer, 5)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Urtësi e përsosur (është Kur’ani) **Po sa bëjnë dobi qortimet**”.

(El-Kamer, 5)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“(Kur’ani është) Dijeni e përsosur – **por paralajmërimi nuk u bëri dobi**”.

(El-Kamer, 5)

“A wisdom for reaching – bat (The Preaching of) Warners profits them not”.

“... **Vërejtjet nuk u bënë dobi atyre**”.

(El-Kamer, 5)

Në këtë ajet pjesëza مَا – “Ma” është përkthyer me pjesëzën mohuese “nuk” dhe me përemrin pyetës “sa?”. Që të dy variantet janë të lejuara për

komentatorët e Kur'anit, por nëse shikohet përkthimi i parë mund të kuptojmë se Kur'ani është urtësi e përsosur, por edhe vërejtje e padobishme. Sa i përket urtësisë së përsosur, kjo është në rregull, por Kur'ani nuk është vërejtje e padobishme, por për kundrazi është vërejtje e dobishme, por ata të cilët nuk i pranojnë këshillat nuk kanë përfituar prej vërejtjeve të Kur'anit, ndërsa në vetvete Kur'ani është vërejtje e dobishme.

Shembulli tjetër në suretu En-Nisa, ajeti i 88-të:

فَمَا لَكُمْ فِي الْمُنَافِقِينَ فِتْنَةٍ ...

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Te hipokritët **nuk** keni dy grupe ...”.

(En-Nisa, 88)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“E **çka** është me ju që në çështjen e munafikëve **jeni** dy grupe”.

(En-Nisa, 88)

Këtu pjesëza ما – “Ma” në rastin e parë është përkthyer si pjesëz mohuese “nuk” çka nuk është e vërtetë, por pjesëza ما – “Ma” në këtë rast përkthehet me “çka”, dhe nuk di se ndonjë komentator e ka shpjeguar pjesëzën ما – “Ma” në këtë ajet me pjesëzën mohuese “nuk”!

قَدْ عَلِمْنَا مَا تَنْقُصُ الْأَرْضُ مِنْهُمْ ...

(Kaf, 4)

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Ne e dimë se tokës **nuk** i mbet gjë mangut për ata ...”.

(Kaf, 4)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Ne e dimë se **çka** pakëson (ç’tretë) toka prej tyre ...”.

(Kaf, 4)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Ne e dimë se **çka** do t’ua mungojë toka atyre (pasi të vdesin) ...”.

(Kaf, 4)

“We already know **Haw** mach of them The earth ...”.

“Ne dimë **sa** prej tyre toka do t’i marrë ...”

(Kaf, 4)

Mrekullia e Kur’anit është se në shumë raste me një pjesëz tregon dy domethënie, e ato dy domethënie në këtë ajet janë:

- se Allahu e di çka tret toka prej trupit të njeriut pasi të vdesë, pra prej kufomës së njeriut, dhe
- Allahu di se sa prej njerëzve toka do t'i marrë në gjirin e saj pasi që ata vdesin.

Ndërsa përkthyesi këtë duhet ta ketë parasysh, ose së paku në fusnotë të tregojë se cilën variant e ka marrë dhe e ka përdorur në përkthim, dhe cilën jo, ose t'i përmendë që të dy variantet.

Në këtë ajet përkthyesit në gjuhën shqipe pjesëzën ما – “Ma” e kanë përkthyer me “çka”, ndërsa përkthyesi në gjuhën angleze me “haw mach” (sa?).

Shembull të përkthimit të pjesëzës فى “fi” dhe على “ala”:

... وَإِنَّا أَوْ إِيَّاكُمْ لَعَلَىٰ هُدًى أَوْ فِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Por, me të vërtetë, ose ne ose ju jeni **në** rrugë të drejtë ose **në** humbje të qartë!”.

(Sebe’ë, 24)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“E atëherë, ose ne, ose ju jemi **në** rrugë të drejtë, apo **në një** humbje të dukshme!”.

(Sebe’ë, 24)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Në të vërtetë, na – ose ju, jemi **në** rrugën e drejtë ose **në** humbje të qartë”.

(Sebe’ë, 24)


Në përkthimin e këtij ajeti shohim se ndajfolja **على** “ala” e cila në gjuhën arabe ka kuptimin e ngritjes **استعلى** (istiëla) është përkthyer me “në” ashtu siç është përkthyer edhe **فى** “fi”, e cila ka kuptimin “në thellësi” në brendi, është përkthyer me “në”.

Zoti i Lartmadhëruar ka bërë komperacion në mes të udhëzimit i cili është i lartë, i ngritur, me vlerë, i çmueshëm dhe humbjes e cila është poshtë në thellësi i ngulitur me pjesëzat **على** “ala” dhe **فى** “fi”, mirëpo kjo nuk është arritur nëpërmjet përkthimeve.


أُولَئِكَ عَلَىٰ هُدًى مِّن رَّبِّهِمْ ...

“... ata janë (udhëtojnë) mbi rrugën e drejtë ...”.

(El-Bekare, 5)



PËRKTHIMI I LIDHËZAVE
“ ف ” DHE “ و ”



Shkronja (و)³ e cila është lidhëz në esencë është lidhëz e përgjithshme dhe absolute, që do të thotë gjatë përkthimit nëse kjo shkronjë (lidhëz) përkthehet si **dhe**, **e** dhe **edhe**, është në rregull, sepse kuptimi i kësaj lidhëze është *lidhja e dy gjymtyrëve të një fjalie ose lidhja e dy fjalive, dhe shpreh marrëdhënie të pjesëve pa marrë parasysh renditjen apo lidhjen*.

Ndërsa, te shkronja - lidhëza (ف) ndryshon çështja, nuk mund të përkthehet me **dhe**, **e** dhe **edhe** në shumë raste, por patjetër duhet të shikohet se ajo shkronjë (lidhëz - ف) çfarë roli kryen në atë rast.

Shkronja (F- ف) – Fau është shkronjë (lidhëza) e dytë. Kjo shkronjë bën lidhjen e gjymtyrëve në fjali ose lidhjen e fjalive.

³ Shkronja “و – v” ka këto role: fillestare, shtese, ndajfolje dhe lidhëz.

Lidhjen e gjymtyrëve në fjali e bën si në aspektin abstrakt ashtu edhe konkret. Kur të përkthehet kjo shkronjë (lidhëz) nuk mjafton të përkthehet me **dhe**, **e** dhe **edhe**, por duhet t'i bashkëngjitet edhe fjala “**menjëherë**”.

Esenciale e domethënies së shkronjës (lidhëzës) “Fa - ف” është ndërlidhja e menjëhershme, përpos nëse vjen si metaforë me domethënien e “و – Vavit” të shkakut ose të kushtit.⁴

Pra të përdoret kështu: **dhe menjëherë**.

Në përkthimin e ajetit të 18-të të suretu El-Bekare, shohim:

صُمُّكُمْ عُنِيَ فِهِمْ لَا يَرْجِعُونَ

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Janë të shurdhër, memecë dhe të verbër, **prandaj** nuk kthehen pas”.

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“(Mbesin në errësirë) Të shurdhër, memecë dhe të verbër, **andaj** nuk kthehen (nga ajo rrugë e tyre e keqe)”.

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Ata janë të shurdhër, memecë, e të verbër; **prandaj** nuk kthehen (nga e keqja në të mirë)”.

Në këtë ajet përkthyesit në gjuhën shqipe e kanë kuptuar qëllimin e “Faut sebebije” – e lidhëzës së shkakut. Mirëpo, përkthyesi në gjuhën angleze e ka përkthyer me “**dhe**”:

“Deaf, dumb und blind, **and** they return not”

“Të shurdhër, memec dhe të verbër, **dhe** ata nuk kthehen”.

Pra, përkthimi i “فأ - Faut” me **dhe (and)** nuk e tregon qëllimin e ajetit, sepse ajeti tregon se ata nuk kanë mundësi të kthehen në rrugë të vërtetë vetëm **për shkak se** “ف” janë të shurdhër, memecë dhe të verbër.

Mirëpo, në këtë rast nuk jemi duke treguar gabimin në gjuhën angleze, por atë se përkthyesit në gjuhën shqipe në këtë ajet e kanë kuptuar qëllimin e fjalës ndihmëse “فأ” (Faut), por në dy ajete më herët nuk e kanë kuptuar.

Pra, nëse shohim ajetin e 16-të të suretu El-Bekare:

أُولَئِكَ الَّذِينَ اشْتَرَوُا الضَّلَالَةَ بِالْهُدَىٰ فَمَا رَبَحَتِ تِجَارَتُهُمْ وَمَا كَانُوا مُهْتَدِينَ

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

⁴ Ndonjëherë shkronja “ف - Fa” vjen si filluese e fjalisë.

16. “Ata janë, të cilët japin fitimin për humbje; tregtia e tyre nuk u sjell kurrfarë dobie ...”.

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

16. “Ata janë prej atyre që kanë blerë (zgjedhur) rrugën e gabuar në vend të së vërtetës. Tregtia atyre nuk u solli kurrfarë dobie ...”.

Njëri përkthyes e ka ndërprerë fjalinë me “ ; ” (pikëpresje), ndërsa tjetri me “ . ” (pikë). Ndërsa asnjëri nuk e ka përdorur lidhëzën përmbyllëse “prandaj” si domethënie e “فَاء - Faut” si në ajetin e 18-të, pra dy ajetet më pas.

Në suretu El-Kamer, ajeti i 11-të:

فَفُتِحْنَا أَبْوَابَ السَّمَاءِ بِمَاءٍ مُنْهَمِرٍ


Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Dhe i hapëm dyert e qiellit krah me krah për ujin që rrodhi pa u ndalur”.

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:


“Dhe, Ne ia kemi hapur dyert e qiellit me ujë (shi) të rrëmbyeshëm”.

Në këtë rast ka qenë dashtur të përkthehet “**dhe menjëherë**”, sepse kështu është “Fau Tertibë” – Lidhëza e menjëhershme, e jo “vavi” – Lidhëza e përgjithshme. Për këtë arsye shohim se Sherif Ahmeti e ka përkthyer “**atëherë**”.



GABIMET PËR SHKAK TË DOMETHËNIES SË DYFISHTË TË FJALËS

Nuk ka dyshim se Kur'ani është i mbushur me plotë fjalë që kanë domethënie të dyfishta. Përkthyesi duhet që të ndalet, të analizojë dhe në fund të merr qëndrimin e përdorjes së asaj fjale në njërën prej kuptimeve që është përdorur, posaçërisht në ajetin që e përkthen.



... سَيَجْعَلُ لَهُمُ الرَّحْمَنُ وُدًّا

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“... i Gjithmëshirshmi do t’u shprehë, me siguri, simpati”.

(Merjem, 96)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“... i Gjithmëshirshmi do t’u krijojë (në zemrat e tyre) dashuri”.

(Merjem, 96)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“... Bamirësi i Gjithmbarshëm do t’i pajisë me dashuri (që t’i dojë perëndia dhe t’i duan njerëzit)”

(Merjem, 96)

Pra, fjala **وَدَّ** në ajetin e lartpërmendur ka kuptim të dyfishtë, por edhe të trefishtë. Që do të thotë **“... i Gjithmëshirshmi në zemrat e besimtarëve do të përgatitë ambient që ata t’i donë të tjerët, të tjerët t’i donë ata, ata ta donë Allahun dhe Allahu t’i dojë ata”**.

فِيهِنَّ خَيْرَاتٌ حِسَانٌ

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Aty ka të mira fantastike”.

(Err-Rrahman, 70)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Aty janë ato (gra) të ndershme e të bukura”.

(Err-Rrahman, 70)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Në to ka **bukuroshe** vyrtytesh të mrekullueshme”.

(Err-Rrahman, 70)

Pra përkthimi i fjalës خَيْرَاتٌ حَسَنٌ “hajratun hisan” me “të mira fantastike”, “(gra) të ndershme e të bukura”, dhe “bukuroshe virtytesh të mrekullueshme” nuk janë asgjë tjetër përpos komentim prej komentimeve të Kur’anit. Prandaj, ne themi se përkthimi i Kur’anit nuk është asgjë tjetër përpos përkthim i komentimit të Kur’anit, sepse përkthyesi e përdor ndonjë variant të ndonjë komentatori të Kur’anit dhe në atë moment ai ka përkthyer komentimin e Kur’anit, e jo vetë Kur’anin.

وَأَحْصَى كُلَّ شَيْءٍ عَدَدًا

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“... Ai e di **numrin** e çdo sendi që ekziston”.

(El-Xhin, 28)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“... Ai e di **sasinë** e çdo gjëje që ekziston”.

(El-Xhin, 28)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“... Ai di **numrin** e çdo gjëje që ekziston”.

(El-Xhin, 28)

“... and takes **accout** of every single thing”.

“... dhe e di **numrin** e çdo gjëje të thjeshtë”.

(El-Xhin, 28)

Nuk kemi çka të themi, përpos asaj se Zoti e di numrin e të gjitha sendeve, por në të njëjtën kohë e di edhe sasinë e çdo sendi veç e veç, prandaj njëri përkthyes e ka përkthyer “**numrin**”, ndërsa tjetri “**sasinë**”.

خُذِ الْعَفْوَ وَأْمُرْ بِالْعُرْفِ ...

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“T’i **merri me të mirë!** Urdhëro për vepra të mira ...”.

(El- ‘Araf, 199)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Ti (Muhamed) **merre të lehtë,** urdhëro për të mirë ...”.

(El- ‘Araf, 199)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“**Bëhu i matur** (në sjellje ndaj tyre), urdhëro për vepra të mira ...”.

(El- 'Araf, 199)

“Hol to forgivenes, ...”.

“... **fal gabimet**,”.

(El- 'Araf, 199)

Fjala عفو “Afv” nuk ka domethënien “me të mirë”, as “të lehtë”, as “i matur”, e as “ fal gabimet”, por kjo fjalë është vendosur në ajetin kur'anor për zekatin apo tepricën e pasurisë. Këtë e dokumenton vetë Kur'ani në ajetin tjetër:

... وَيَسْأَلُونَكَ مَاذَا يُنْفِقُونَ قُلِ الْعَفْوَ ...

“Të pyesin ty çka me dhënë prej pasurisë. **Thuaj tepricën – e pasurisë apo zekatin ...**”.

(El-Bekare, 219)

“Ti merre **zekatin (tepricën e pasurisë)** prej tyre dhe urdhëro për të mira ...”.

(El- 'Araf, 199)

وَأَمْرَأَتُهُ قَائِمَةٌ فَضَحَكْتُ ...

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Kurse gruaja e tij rrinte aty ... **Ajo qeshi** ”.

(Hudë, 71)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“E gruaja (Sare) e tij (Ibrahimit) rrinte në këmbë **dhe qeshi**”.

(Hudë, 71)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“E, gruaja e tij (e Ibrahimit) rrinte aty **dhe qeshi** ”.

(Hudë, 71)

“And his wife was standing (There) **and she laughed**”

“Dhe gruaja e tij ishte në këmbë (aty) **dhe ajo qeshi**”.

(Hudë, 71)

Është e vërtetë se fjala ضحكت “Dahk” ka domethënie më të lehtë – me buzëqeshë ose me qeshë me zë të ulët, por në Kur’an kjo fjalë vjen edhe në forma të tjera:

“**Ju jeni tallur (mahitur) me ta**”. و كنتم منهم تضحكون

“**Ai (Allahu) gëzon dhe shqetëson**”. هو اضحك و ابكى

“**Ai (Allahu) bën të lumtur dhe pikëllon**”. هو اضحك و ابكى

Ndërsa në këtë ajet fjala ضحكت (Dahk) nuk ka ardhur në asnjërën prej këtyre domethëniesve, por mund të ketë një të njëjtë prej këtyre domethëniesve që vijojnë:

- u habit, u befasua, u çudit. - فضحكت

- asaj i erdhi menstruacioni. - فضحكت

Arabët thonë “Dahiketil-meretu” (i erdhi menstruacioni gruas), e pasi që Sara ishte plakë, kishte kohë që nuk i kishte ardhur menstruacioni për shkak të pleqërisë, në atë moment i erdhi menstruacioni që ishte shenjë se me të vërtetë do të lindte fëmijë.

“**E ajo tha: ‘e mjera unë’ a unë të lindi fëmijë kur unë jam plakë e po ashtu edhe ky burri im është plak**”.

(Hudë, 72)

Për të vërtetuar se ajo nuk qeshi kemi argument në vet Kur’anin në suretudh-Dharijatë, në ajetin e 29-të:

فَأَقْبَلَتِ امْرَأَتُهُ فِي صَرَّةٍ فَصَكَتْ وَجْهَهَا ...

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“E gruaja e tij (Sara) nisi të bërtasë e i ra shuplakë fytyrës”.

(Edh-Dharijatë, 29)

Ndërsa përkthyesi i parë këtë e përkthen kështu:

“... gruaja e tij u paraqit duke klithur e gërvishur fytyrën ...”.

(Edh-Dharijatë, 29)

Të bëjmë një shikim më të afërt te përkthyesi i parë:

71. “Ajo qeshi ...”. فَضَحَكَتْ ... (Hudë, 71)

72. “Qyqja unë ...”. قَالَتْ يَا وَيْلَتَى ... (Hudë, 72)

... duke klithur e gërvishur fytyrën ...”. (Edh-Dharijatë, 29)

Pra, i njëjti moment, e njëjta ngjarje, në të njëjtën kohë, a është e mundur Sara: të qeshë, të klithë, të gërvishë fytyrën e saj dhe të thotë - “qyqja unë”?!

Nëse lexuesi në përkthim e lexon kështu, ai do të thotë se këtu paska gjëra kontradiktore, kontraste, kundërthënie dhe jopërputhshmëri. Ndërsa Kur’ani ka ardhur me shprehje, të cilat përputhen me gjuhën arabe, i përshtaten njëra-tjetrës, ka harmoni të plotë në mes domethënieve:

“Dhe derisa gruaja e tij qëndronte aty (menjëherë) **i erdhi menstruacioni** dhe u habit ajo”.

إِنَّ اللَّهَ وَمَلَائِكَتَهُ يُصَلُّونَ عَلَى النَّبِيِّ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا صَلُّوا عَلَيْهِ وَسَلِّمُوا تَسْلِيمًا

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Allahu dhe engjujt e tij e **bekojnë** Profetin.

O besimtarë! bekojeni edhe **dorëzohuni plotësisht!**”.

(El-Ahzabë, 56)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Është e vërtetë se Allahu dhe engjujt e Tij **me madhërim e mëshirojnë** pejgamberin.

O ju që keni besuar, **madhëronie** pra atë (duke rënë salavat) dhe **përsëndeteni me selam**”.

(El-Ahzabë, 56)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Perëndia e **mëshiron** Pejgamberin, e Engjujt e Tij **luten për të**.

O besimtarë lutuni për të dhe **përsëndetni atë me >>Salavat<< dhe >>Selam<<”.**

(El-Ahzabë, 56)

“Allah and His Angels **send blessings** on the Prophet.

“Allahu dhe Engjujt e Tij **dërgojnë bekime** për Pejgamberin.

O ye that believe! **Send ye blessing** on him

“O ju të cilët keni besuar **dërgoni bekime** për të

and **salute him with all respect”.**

dhe **dërgoni salavat për të me gjithë respekt”.**

(El-Ahzabë, 56)

Fjala **يُصَلُّونَ** “Jusalunë” është përkthyer:

1. bekojnë,
2. me madhërim e mëshirojnë,
3. Perëndia mëshiron – Engjujt lutën,
4. dërgojnë bekime.

Fjala “Salat” do të thotë lutje, namaz, por është “levdh mushterik” (fjalë me kuptim të dyanshëm), që do të thotë ka kuptim: mëshiron ai i cili i jep lutësit, dhe lutje për të mëshiruar. E këtu në këtë ajet ka kuptim të dyanshëm:

- Allahu – mëshiron, i jep lutësit,
- Melaqet – lutën për mëshirë.

Vetëm përkthimi i tretë e ka sqaruar domethënien e vërtetë të kësaj fjale:

“Në të vërtetë **Zoti e mëshiron**, por edhe **melaqet lutën për të mëshiruar të dërguarin e Tij ...”**

(El-Ahzabë, 56)

“**Salu alejhi**” **صَلُّوا عَلَيْهِ :**

- bekojeni,
- madhëronie,
- lutuni për të,
- dërgoni bekime.

“**Ve selimu teslima**” **وَسَلِّمُوا تَسْلِيمًا :**

- dorëzohuni plotësisht,
- përsëndeteni me selam,
- përsëndetni me salavat dhe selam,
- dërgoni salavat me gjithë respekt.

Në pjesën e dytë përkthimet i janë përshtatur domethënies së fjalës përpos përkthyesit të parë – “dorëzohuni plotësisht”, nuk mund ta ketë këtë domethënie.

وَجَاءَهُ قَوْمُهُ يُهْرَعُونَ ...

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Dhe populli i tij u **vërsul tek ai**”.

(Hudë, 78)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Dhe populli i tij ... **erdhi me nguti te ai** (te Luti)”.

(Hudë, 78)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Dhe erdhi populli i tij **duke nxituar kah ai**”.

(Hudë, 78)

“And his people came **Rushing to wards him**”.

“Dhe populli i tij erdh **duke nxituar drejt tij**”.

(Hudë, 78)

Fjala هرع “huria” mund ta ketë domethënien: u vërsul, me nguti, nxitim. Por, nuk mund të kompletohet kjo fjalë deri sa mos ta ketë të bashkangjitur edhe hidhërimin, duke e shtyer njëri-tjetrin:

“Populli i tij **u vërsul me hidhërim (duke e shtyer njëri-tjetrin) tek ai**”.

(Hudë, 78)

أَنْ رَأَاهُ اسْتَعْنَى

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Sapo e ndien veten **të pasur**”.

(Alak, 7)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Për shkak se e ndien veten **të pavarur**”.

(Alak, 7)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Posa e ka ndier veten **të pasur** (se nuk i nevojitet askush)”.

(Alak, 7)

Fjala استغنى “istagna” është përkthyer “të pasur” dhe “të pavarur”. Ajeti në fjalë ka të bëjë edhe me të pasurit, por edhe jo të pasurit, pra ka të bëjë me ata të cilët nuk besojnë, por në të njëjtën kohë edhe nuk e ndiejnë veten se kanë nevojë të besojnë, sepse ata veten e konsiderojnë të pavarur, pra si Zot. Ndërsa në Islam dihet se vetëm Zoti është Krijues dhe është i pavarur në krijimtarinë e Tij, në veprimtarinë e Tij dhe çdo gjë tjetër varet prej Tij.

فَإِذَا فَرَغْتَ فَانصَبْ

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“E kur të jesh i lirë **angazhohu me namaz**”.

(El-Inshirah, 7)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“E kur ta kryesh (obligimin) atëbotë **mundohu me adhurim**”.

(El-Inshirah, 7)


Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“E, kur ta kryesh njëren punë, **filloja tjetrës (menjëherë)**”.


(El-Inshirah, 7)

T’i shikojmë që të tri përkthimet se si e kanë përkthyer fjalën فانصب “fensab”, e pastaj t’i analizojmë:

“Adhurimi” është pjesë e veprimit të njeriut, i cili përfshin namazin, por edhe agjërimin, zekatin, haxhin etj. Ndërsa fjala “filloja (punës) tjetrës” është më gjithëpërfshirës, pra përfshin adhurimin dhe punët e tjera të rëndomta. Ndërsa fjala “namaz” nuk i përfshin të gjitha këto. Edhe pse dihet mirëfilli se **فانصب** - “fensab” mundet të jetë që *‘nëse e kryen një obligim, filloje obligimin tjetër’*, ose *‘nëse e kryen ndonjë obligim, fillo të kryesh vullnetarisht ndonjë vepër, qoftë namaz, agjërim, zekat’* etj. Pra, pa marrë parasysh, për të kryer vepër tjetër: qoftë e cila është obligative pas kryerjes së obligimit të parë, qoftë joobligative pas kryerjes së obligimit të parë. Pra, angazhim i njeriut pandërprerë.



**GABIME GJATË PËRKTHIMIT
TË NJËJËSIT DHE SHUMËSIT**



إِنْ هَذَا إِلَّا قَوْلُ الْبَشَرِ

Feti Mehdiu e përkthen kështu:

“**Këto** janë vetëm fjalë **njeriu**”.

(El-Mudethir, 25)

Sherif Ahmeti e përkthen kështu:

“**Ky** nuk është tjetër, përveç fjalë **njerëzish**”.

(El-Mudethir, 25)

Hasan Nahi e përkthen kështu:

“**Këto** janë vetëm fjalë **njeriu**”.

(El-Mudethir, 25)

“Vërtet **ky** (Kur'an) është vetëm fjalë **njeriu**”.

Përemri dëftor هذا “ky” ka ardhur në njëjës, ndërsa përkthyesi i parë dhe i tretë e kanë përkthyer në shumës. Po ashtu fjalën بشر “besher” përkthyesi i parë dhe i tretë e kanë përkthyer në njëjës, ndërsa përkthyesi i dytë në shumës. Të kësaj natyre, njëjësi në shumës dhe anasjelltas, ka edhe raste të tjera, të cilat nuk e shohim të arsyeshme të gjitha t’i sjellim në këtë punim, por duhet pasur parasysh se nëse është fjala për fjalën e Zotit, respektivisht Kur’anin - a mundemi të përkthejmë një gjë të tillë kështu, apo jo?!

... لِيُخْرِجَ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ مِنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ ...

Feti Mehdiu e përkthen kështu:

“... për t’i nxjerrë, ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, nga **terri në dritë**”.

(Et-Talak, 11)

Sherif Ahmeti e përkthen kështu:

“për t’i nxjerrë ata që besuan dhe bënë vepra të mira prej **errësirave në dritë**”.

(Et-Talak, 11)

Hasan Nahi e përkthen kështu:

“për t’i nxjerrë ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira nga **errësira në dritë**”.

(Et-Talak, 11)

Fjala e Zotit gjithmonë është mrekulli, secila nuancë, secila shprehje ka qëllim të caktuar. Në këtë ajet Zoti i Madhëruar ka përmendur errësitat ظلمات (pra në shumës), ndërsa dritën نور në njëjës. Pse? Sepse drita e besimit

është një - një e vetme dhe e vërtetë, ndërsa errësirat e pabesimit janë të shumta dhe të shumëllojshme, dhe ato errësira vijnë nga çdo anë. Për këtë arsye vetëm përkthyesi i dytë e ka përkthyer mirë “**prej errësirave në dritë**”, ndërsa përkthyesi i parë “**prej territ në dritë**” dhe përkthyesi i tretë “**nga errësira në dritë**” e kanë përkthyer gabim.

Sa i përket këtij rasti në bazë të komentimeve të Kur’anit përkthimi **ظلمات** - “dhulumat” (errësirat) duhet të mbetet vetëm në shumës, e mos të përkthehet në njëjës, sepse nuk mund të kuptohet esenca e ajetit, mirëpo edhe në raste të tjera njëjësi përkthehet në njëjës, ndërsa shumësi në shumës, përpos nëse ndonjë komentim i Kur’anit, i cili është komentuar se njëjësi ka pasur për qëllim shumësin, mirëpo ka ardhur në njëjës, ndërsa pikësypnimin e ka në shumës.

Kështu gjatë përkthimeve shohim në ajeti i 8-të në suretul Mulk përkthehet kështu:

“..... roja”.

“..... rojtarët”.

Në ajetin e 5-të të suretul Xhin përkthehet:

“..... njeriu as xhini ...”.

“..... njerëzit e as xhinët ...”.

Në ajetin e 40-të të suretul Kijame përkthehet:

“..... të ngjallë të vdekurin ...”.

“..... të ngjallë të vdekurit ...”.



PËRKUFIZIMI I FJALËS



إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ

Feti Mehdiu e përkthen kështu:

“**Vetëm Ty** të adhurojmë, dhe vetëm nga Ti ndihmë kërkojmë”.

(El-Fatiha, 4)

Sherif Ahmeti e përkthen kështu:

“**Vetëm Ty** të adhurojmë dhe vetëm te Ti kërkojmë ndihmë”.

(El-Fatiha, 4)

Hasan Nahi e përkthen kështu:

“**Vetëm Ty** të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”.

(El-Fatiha, 4)

Që të tre përkthyesit e kanë kuptuar plotësisht këtë ajet, dhe fjala “**Vetëm Ty**” është përkthyer edhe pse në tekst të Kur’anit nuk ekziston. Por, në gjuhën arabe kur përemri vjen para foljes, ajo folje (veprim) është e përkufizuar tërësisht vetëm në atë folje. Do të kishte qenë mirë që kështu të

veprojnë edhe në të gjitha rastet e tjera, por në shumë raste të tjera nuk kanë vepruar kështu. Si shembull marrim te ajeti i fundit në suretut Tevbe:

"... عليه توكلت ..."

është përkthyer "توكلت عليه" "i mbështetem Atij", që bën të kuptosh "i mbështetem Atij, por është e mundur për t'iu mbështetur edhe të tjerëve", sepse në këtë rast vjen folja para përemrit, e kur të vijë folja para përemrit nuk ka përkufizim të foljes vetëm në atë përemër, por është e zgjeruar edhe në diçka tjetër, çka Kur'ani nuk e lejon.

Ka shumë ajete të kësaj natyre, ku gjatë përkthimit nuk është përdorur fjala "vetëm" apo nuk e kanë përdorur pjesëzën përjashtuese.

Të kësaj natyre e kemi rastin në suretu Jusuf, ajeti i 67-të, kur Jakubi a.s. thotë:

"... **Vetëm** Atij i mbështetem ..." - "... عليه توكلت ..."

Ndërsa Feti Mehdiu e përkthen:

"... Unë jam mbështetur te Ai ...".

Po ashtu edhe Hasan Nahi e përkthen:

"... Tek Ai mbështetem unë ...".

Këtë ajet ka qenë dashur përkthyer sikur në suretul Fatiha, ajetin i 4-të: "... **Vetëm** Ty ...", sepse natyra është e njëjtë.

Në suretu Hudë ajeti i 88-të *Feti Mehdiu* dhe *Hasan Nahi* nuk e kanë përkthyer "... عليه توكلت ..." mirë, ndërsa Sherif Ahmeti po:

"**Vetëm** Atij i mbështetem".



EMRAT, PËREM RAT ME SHKRONJË TË MADHE



EMRAT E ALLAHUT DHE PËREMRA T DHE ATRIBUTET E TIJ ME SHKRONJË TË MADHE

Emri Allah është i përveçëm dhe gjithmonë shkruhet me shkronjë të madhe. Mirëpo edhe përemri si dhe atributet e tij, të cilët tregojnë apo kanë për qëllim Allahun – Gjithëkrijuesin duhet të shkruhet me shkronjë të madhe, pa marrë parasysh se si përemrat e tjerë shkruhen me shkronjë të vogël apo me shkronjë të madhe në gjuhën shqipe. Ndërsa, te përkthimet në gjuhën shqipe në disa raste i janë përmbajtur përemrit me shkronjë të madhe, në disa raste jo.

أَمَّنْ هَذَا الَّذِي يَرْزُقُكُمْ إِنْ أَمْسَكَ رِزْقَهُ ...

Shembull:

Feti Mehdiu ajetin 21 në suretul Mulk e përkthen kështu:

“Ose: kush është ai që t’ju ushqejë, nëse ai e ndal furnizimin e vet? ...”.

Hasan Nahi e përkthen kështu:

“..... në qoftë se Ai (Perëndia) e ndalon furnizimin ...”.

Sherif Ahmeti e përkthen:

“..... po që se Ai ua ndërpret furnizimin e vet ...”.

Përemri “Ai” Sherif Ahmeti e përkthen me të madhe, ndërsa “e vet” me të vogël, edhe pse “e vet” ka për qëllim Allahun. Pra në të njëjtin ajet, njërës i përmbahet e tjetrës jo.

... ابْنِ لِي عِنْدَكَ بَيْتًا ...

Në suretu Tahrime, ajeti i 11-të:

Feti Mehdiu e përkthen kështu:

“... ndërtoma një shtëpi, te ti ...” – me shkronjë të vogël.

Sherif Ahmeti e përkthen kështu:

“... më bën një vend pranë mëshirës sate ...” – me shkronjë të vogël, e që ka qenë dashur “... pranë mëshirës Sate ...”.

Ndërsa Hasan Nahi e ka përkthyer:

“... ndërtoma mua një banesë te Ti”.

Përpos emrit Allah dhe përemrit për Allahun që duhen patjetër të shkruhen me shkronjë të madhe, ashtu edhe emrat e bukur të Allahut (epitetet e tij) patjetër duhet të shkruhen me shkronjë të madhe, e sidomos 99 emrat e bukur të Allahut.

Kështu, nëse shikojmë ajetin 42 të suretul Fusilet, shohim si vijon:

... تَنْزِيلٍ مِنْ حَكِيمٍ حَمِيدٍ

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“... është shpallje nga një i urtë i lavdishëm”.

Që të dy emrat e bukur të Allahut i ka përkthyer me shkronjë të vogël.

Sherif Ahmedit të njëjtin ajet, njërin emër të bukur të Allahut e përkthen me shkronjë të madhe, ndërsa menjëherë emrin tjetër të bukur të Allahut e përkthen me shkronjë të vogël:

“... i zbritur prej të Urtit, të lavdishmit”.

Emri حَكِيم “Hakimë” është shkruar me të madhe “të Urtit” si emër i përveçëm, prandaj ka qenë dashur edhe حَمِيد “Hamidë” të shkruhet me të madhe “të Lavdishmit”.

Ndërsa *Hasan Nahi* që të dy emrat e bukur të Allahut në këtë ajet i përkthen me shkronjë të madhe:

“... kjo është shpallje prej të Gjithëdijshtit, të Falënderuarit”.

Dita e kiametit është pjesë e imanit. Në Kur'an, Zoti i Lartmadhëruar për të treguar veçoritë apo ndodhitë e kësaj dite, e ka emëruar apo e ka cilësuar me emra të ndryshëm.

Nëse e vështrojmë fjalën يوم الدين - JEVMUDDINË është përkthyer kështu:

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“ditën e kiametit”, pra me shkronjë të vogël.

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“ditën e gjykimit”, me shkronjë të vogël.

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Ditën e Kijametit”, me shkronjë të madhe.

Kur ishte fjala te përkthimi يوم العزف “JEVMUL AZIFE”

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“ditën e afërme”, me shkronjë të vogël.

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“ditën e Kijametit”, pra “ditën” me shkronjë të vogël, ndërsa fjalën “Kijameti” me shkronjë të madhe.

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:


“ditën e afërt të gjykimit”, që të dyja me shkronjë të vogël.

Ndërsa, *Hasan Nahi* kur është fjala për përkthimi i fjalës يوم البعث “JEVMUL BEATH”, fjalën يوم “Ditë” e përkthen me shkronjë të madhe, ndërsa البعث “beath” me shkronjë të vogël.

Pra te përkthimet shohim:

- Që të dy pjesët e fjalisë me shkronjë të vogël;
- që të dy pjesët e fjalisë me shkronjë të madhe;

- pjesa e parë e fjalisë me shkronjë të vogël;
- pjesa e dytë e fjalisë me shkronjë të madhe;
- pjesa e parë e fjalisë me shkronjë të madhe;
- pjesa e dytë e fjalisë me shkronjë të vogël.



GABIM I PËRKTHIMIT TË DREJTPËRDREJTË



يُنَبِّئُ الْإِنْسَانَ يَوْمَئِذٍ بِمَا قَدَّمَ وَأَخَّرَ

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Atë ditë njeriu do të informohet **për atë që e ka shpejtuar ose e ka vonuar**”.

(El-Kijame,13)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Atë ditë njeriu do të njihet **me atë që çoi para dhe me atë që la prapa**”.

(El-Kijame,13)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Atë ditë, njeriu informohet **për veprat që i ka punuar, si dhe për ato që i ka lëshuar**”.

(El-Kijame,13)

Të gjithë përkthyesit duhet ta dinë se përkthim fjalë për fjalë në Kur'an nuk mund të ketë, dhe ajo çka është më me rëndësi është se, përkthimi i tillë në Kur'an nuk lejohet, pse atëherë ajeti merr kuptim të kundërt me atë çka e ka.

Këtu ajeti tregon se njeriu do të lajmërohet për atë çka ka punuar dhe për atë çka e ka pasur për detyrë për ta punuar dhe nuk e ka punuar, e jo për atë që e ka punuar me vonesë, sikur që është me rastin e përkthimit të parë. Po ashtu edhe përkthyesi i dytë ka bërë gabim, ndërsa përkthyesi i tretë e ka kuptuar esencën e ajetit dhe e ka përkthyer drejt komentimin dhe domethënien e ajetit.

وَمَنْ يَعِشْ عَنْ ذِكْرِ الرَّحْمَنِ ...

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Kush **bëhet sylesh** ndaj qortimit të mëshirshmit ...”

(Ez-Zuhruf, 36)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Kush i **mbyll sytë** para këshillave të Zotit ...”

(Ez-Zuhruf, 36)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Kush **shmanget** nga këshilla (Kur'ani) e Mëshiruesit të Gjithmbarshëm”.

(Ez-Zuhruf, 36)

“If anyone **withdraws himself** from remembrance ...”

“Nëse ndonjëri e **largon veten e tij** nga përkujtimi ...”

(Ez-Zuhruf, 36)

Fjala **يَعِشُ** “jeashu” është përkthyer:

- sylesh,
- i mbyll sytë,
- shmanget,
- e largon veten e tij.

Fjala **يَعِشُ** “jeashu” ka domethënie “verbërimi i shikimit për shkak të errësirës së madhe”, pastaj vjen në formën alegorike “kush shmanget dhe largohet”.

Ndërsa fjala “sylesh” është term jo i përshtatshëm . Nëse e bëjmë një kombinim të këtyre katër përkthimeve fitojmë domethënien:

“Kush **i mbyllë sytë (verbohet)** dhe largohet prej Këshillës (Kur’anit përkujtues) së Gjithëmëshirshmit ...”.

Përkthimi i fjalës **ذِكْرٍ** “Dhikr”- “Qortim”, është i papërshtatshëm.

... ضَعَفَ الطَّالِبُ وَالْمَطْلُوبُ

Feti Mehdiu e përkthen kështu:

“... Është i dobët **ai që lyp**, por edhe **ajo që lypet**”.

(El-Haxh, 73)

Sherif Ahmeti e përkthen kështu:

“... i dobët është **lutësi** dhe **i luturi**”.

(El-Haxh, 73)

Hasan Nahi e përkthen kështu:

“I dobët është **adhuruesi** (i tjetërkujt, pos Perëndisë) por edhe **i adhuruari** – (pos Perëndisë)”.

(El-Haxh, 73)

Është e vërtet se fjala **طَلَبَ** “talebe” ka domethënie “për të lypur”, ndoshta “lutës”, po ashtu edhe “adhurues”, ndërsa fillimi i ajetit kërkon prej

njerëzve që të tubohen të gjithë së bashku dhe të shohin se, a do të jenë në gjendje të krijojnë diçka sa do që të jetë e vogël, si p.sh. mushkonja! Pastaj tregon se janë të dobët edhe njerëzit, por janë të dobët edhe idhujt, të cilët adhurohen, andaj duhet të koordinohet ajeti dhe të sqarohet në fund:

“Janë të paaftë **kërkuesit (idhujt)** dhe e **kërkua (mushkonja)**”.

(El-Haxh, 73)

تَبَصُّرَةً وَذِكْرَى لِكُلِّ عَبْدٍ مُنِيبٍ

Feti Mehdiu e përkthen kështu:

“**Për t’i parë me sy** dhe të mendojë secili që i drejtohet Zotit të vetë”.

(Kaf, 8)

Sherif Ahmeti e përkthen kështu:

“**Dëshmi të dukshme** dhe përkujtuese për secilin njeri që ka drejtuar mendjen (te Zoti)”.

(Kaf, 8)

Hasan Nahi e përkthen kështu:

“**Për t’u menduar dhe këshilluar** çdo rob që i drejtohet Zotit të vetë”.

(Kaf, 8)

Edhe pse të tre përkthimet i janë afruar domethënies së shprehjes

تَبَصُّرَةً

“tebsiraten”: “për t’i parë me sy”, “dëshmi të dukshme”, “për t’u menduar” - përkthimi më i drejtë do të ishte:

“**Argument (shembull)** dhe **përkujtim (këshillë)** për secilin rob (njeri), i cili i drejtohet Zotit (me mendjen, intelektin dhe logjikën e tij)”.

إِنَّ الَّذِينَ يَخْشَوْنَ رَبَّهُم بِالْغَيْبِ لَهُمْ مَغْفِرَةٌ وَأَجْرٌ كَبِيرٌ

Feti Mehdiu e përkthen kështu:

“Ata që i frikësohen Zotit të vet **edhe fshehtazi** për ata ka falje dhe shpërblim të madh”.

(El-Mulk, 12)

Sherif Ahmeti e përkthen kështu:

“Ata që **pa e parë i frikësohen** Zotit të vet për ta ka falje dhe shpërblim të madh”.

(El-Mulk, 12)

Hasan Nahi e përkthen kështu:

“Me të vërtetë, ata që **i frikohen** Zotit të tyre **edhe atëherë kur nuk i sheh askush**, për ta ka falje dhe shpërblim të madh”.

(El-Mulk, 12)

“As for those who Fear their Lord unseen”.

“Për ata të cilët besojnë Zotin e tyre **pa e parë**, ...”.

(*El-Mulk*, 12)

Edhe pse nuk e shohim Zotin, ne i besojmë dhe i frikësohemi Atij, por nuk i frikësohemi fshehtazi, as kur nuk na sheh askush. Ne i frikësohemi Zotit haptazi para njerëzve, jo fshehurazi prej njerëzve. Edhe ajeti tregon për ata të cilët i frikësohen Zotit, edhe pse në këtë botë nuk e shohin me sy, por i frikësohen sikur janë duke e parë drejtë për së drejti.

... هَلْ لَكَ إِلَى أَنْ تَزَكَّى

Feti Mediu e përkthen kështu:

“... A do të **pastrohesh**?”.

(*En-Naziatë*, 18)

Sherif Ahmeti e përkthen kështu:

“... e ke ndërmend të **pastrohesh**?”.

(*En-Naziatë*, 18)

Hasan Nahi e përkthen kështu:

“... a don ti të **pastrohesh (nga të këqijat)**?”

(*En-Naziatë*, 18)

Fjala تَزَكَّى - “Tezekka” do të thotë “pastrim shpirtëror”, e jo pastrim trupor, sepse pastrimi trupor e ka fjalën غَسَلَ “gasele”. Do të ishte mirë që përkthyesit ta kenë parasysh dhe t’u tregojnë lexuesve se ajeti ka të bëjë me

pastrimin e njeriut prej mosbesimit dhe prej të këqijave, e kjo nuk arrihet vetëm me fjalën **تَرْكِي** “pastrohesh”:

“... a do të pastrohesh (nga idhujtaria, nga shirku, nga të këqijat, nga mosbesimi etj.)”,

(En-Naziatë, 18)

ndërsa vetëm me këtë përkthim nuk është arritur ajo çka kërkon dhe tregon Kur’ani.

... قَاتَلَهُمُ اللَّهُ أَنَّى يُؤْفَكُونَ

Feti Mehdiu e përkthen kështu:

“All-llahu i **vraftë!** **Sa gënjejnë!**”.

(Et-Tevbe, 30)

Sherif Ahmeti e përkthen kështu:

“Allahu i **vraftë**, **si largohen (nga e vërteta)**”.

(Et-Tevbe, 30)

Hasan Nahi e përkthen kështu:

“I **vraftë** Perëndia! **Si po shmangen (nga e vërteta)**”.

(Et-Tevbe, 30)

“Allah’s curs Be on them, ...”

“Mallkimi i Allahut qoftë mbi ta, ...”.

(Et-Tevbe, 30)

Gjithmonë fjala **قَاتَلَهُمُ اللَّهُ** “Katelehumullah” kur të vijë në Kur’an, nuk do të thotë “Allahu i vraftë”, por “Allahu i mallkoftë”.

Ndërsa, pjesa tjetër e ajetit **أَنِّي يُؤْفَكُونَ** “enna juëfekun” është larg domethënies “sa gënjejnë”, por i përshtatet “si largohen nga e vërteta”.

“Allahu i **mallkoftë**! Si po largohen (nga e vërteta)”.

(Et-Tevbe, 30)

وَكَانَ وَرَاءَهُمْ مَلِكٌ يَأْخُذُ كُلَّ سَفِينَةٍ غَصْبًا...

Feti Mehdiu e përkthen kështu:

“... prapa tyre ishte një mbret i cili grabiste çdo anije **të re**”.

(El-Kehf, 79)

Sherif Ahmeti e përkthen kështu:

“Ngase para tyre ishte një sundues që grabiste çdo anije (**të aftë-pa të meta**)”.

(El-Kehf, 79)

Hasan Nahi e përkthen kështu:

“..., sepse, para tyre, gjendej një sundimtar, i cili çdo anije (**të shëndoshë**) e merrte me dhunë”.

(El-Kehf, 79)

Të tre përkthyesit në gjuhën shqipe e kanë kuptuar anulimin retorik (të re, të aftë - pa të meta, dhe të shëndoshë), mirëpo kjo nuk ka ndodhur në përkthimin në gjuhën angleze:

“Who seired on every boat by force”.

“I cili e grabiste çdo anije me forcë”.

Po ta merrte mbreti çdo anije pa marrë parasysh e shëndoshë, pa të meta, të re, apo edhe jo të shëndoshë, ose me të meta, atëherë Hidri nuk ka pasur nevojë për ta paaftësuar pjesërisht anijen.

Ndërsa, sa i përket pjesës së ajetit **وَرَاءَهُمْ** “veraehum”, Hasan Nahi e përkthen “para tyre”, sikurse edhe Sherif Ahmeti, ndërsa Feti Mehdiu e përkthen “prapa tyre”, po ashtu edhe në gjuhën angleze përkthehet “after them” (pas tyre).

مِنْ وَرَائِهِ جَهَنَّمَ ...

Feti Mehdiu e përkthen kështu:

“Sepse **e pret** Xhehennemi ...”.

(Ibrahim, 16)

Sherif Ahmeti e përkthen kështu:

“E **pas tij** (kryelartit) është Xhehenemi ...”.

(Ibrahim, 16)

Hasan Nahi e përkthen kështu:

“**Para tyre** është Xhehenemi ...”.

(Ibrahim, 16)

Pra fjala “min veraihim” është përkthyer kështu:

“i pret”; “pas tij”; dhe “para tij”. Këtu shohim përkthimin fjalë për fjalë “e pas tij është Xhehnemi” dhe po ashtu interpretimin “para tyre është Xhehenemi”.

... وَلِمَنْ دَخَلَ بَيْتِي مُؤْمِنًا ...

Në këtë ajet fjalën بَيْتِي “bejt” përkthyesit e kanë përkthyer kështu:

Feti Mehdiu e ka përkthyer:

“... kush ka hyrë në **shtëpinë** time ...”.

(En-Nuh, 28)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer:

“... dhe ata që hynë në **shtëpinë** time ...”.

(En-Nuh, 28)

Hasan Nahi e ka përkthyer:

“... dhe ata që hynë në **shtëpinë** time ...”.

(En-Nuh, 28)

Ndërsa në bazë të komentimeve fjala بَيْتِي “bejt”, në këtë ajet, ka pasur për qëllim: “fenë”, ose “xhaminë” e Nuhut a.s., ose “anijen e Nuhut

a.s.”. Andaj, ka qenë dashtur, së paku në kllapa, të përdorej njëra prej këtyre apo këto domethënie, ose të kalohet prej fjalës “shtëpi” - në fjalën “anijen time” apo “fenë time”.

Pra, është përkthyer fjalë për fjalë fjala **بَيْتِي** “bejt”, dhe nuk iu është dhënë kurrfarë interpretimi.

وَأَنَّهُ لَقَسَمٌ لَّوْ تَعْلَمُونَ عَظِيمٌ

Feti Mehdiu e përkthen kështu:

“E **ajo** është, ta dini, betim i madh”.

(El-Vakia, 76)

Sherif Ahmeti e përkthen kështu:

“E **ai** është betim i madh, sikur ta dini!”.

(El-Vakia, 76)

Hasan Nahi e përkthen kështu:

“E **ky** është, betim i madh, nëse e dini”.

(El-Vakia, 76)

Përemri (damiri) **هُ** “hu” është përkthyer: **ajo, ai** dhe **ky**. Pra, e njëjta fjalë është përkthyer me forma të ndryshme prej tre përkthyesve!

Nëse e bëjmë një vështrim para këtij ajeti, shohim se është përkthyer kështu:

“Dhe, betohu në çastin e perëndimit të yjeve”. (Përkthim i Hasan Nahit)

“Dhe përnjëmend po betohem në perëndimin e yjeve”. (Përkthim i Feti Mehdiut)

“Betohem në shuarjen (perëndimin) e yjeve”. (Përkthim i Sherif Ahmetit)

Pra: “betohu”, “po betohem”, dhe “Betohem” të gjitha këto janë komentim i Kur’anit, jo përkthim i Kur’anit.

Të kësaj natyre ka edhe në raste të tjera.

Nëse shikojmë më lart, shohim se ajeti **فَلَا أُفْسِمُ بِمَوَاقِعِ النُّجُومِ** “Fe la uksimu bi mevakii nuxhumë”, komentohet edhe në formën: “**Nuk** po betohem në shuarjen e yjeve” (se s’ka nevojë, sepse është i qartë).

Pra, kështu dalin këto përkthime: “Betohu”, “Po betohem”, dhe “Nuk po betohem (se s’ka nevojë)”.

... إِنِّي أَرَانِي أَعْصِرُ خُمُرًا ...

Feti Mehdiu e përkthen kështu:

“... kam parë një ëndërr sikur po **shtrydhja rrushin ...**”.

(Jusuf, 36)

Sherif Ahmeti e përkthen kështu:

“... Unë ëndërrova veten se po **shtrydhi (rrush për) verë ...**”.

(Jusuf, 36)

Hasan Nahi e përkthen kështu:

“... Unë kam parë (në ëndërr) veten se si **shtrydhja verë ...**”.

(Jusuf, 36)

Përkthyesi i tretë e ka përkthyer “shtrydhjen e verës”, përkthyesi i parë “shtrydhjen e rrushit”, ndërsa i mesmi i ka kombinuar që të dy përkthimet “shtrydhi (rrush për) verë”.


Si do që të jetë në ajet është përdorur anulimi retorik (mahdhufi). Ne e kemi përmendur edhe në rastet e tjera se gjatë përkthimit çdo përkthyes edhe në tekst të drejtpërdrejtë ka përdorur fjalë që nuk janë në tekstin e drejtpërdrejtë të Kur’anit, por ia ka përshtatur tekstit. Edhe këtu duhet pasur parasysh se tentimet për përkthim janë vetëm komentim i Kur’anit, jo përkthim i tekstit të Kur’anit. Ashtu sikurse disa komentatorë e kanë komentuar shtrydhjen e rrushit me domethënien “për të prodhuar verë”. Ndërsa vetëm shtrydhja e rrushit nuk do të thotë prodhim i verës, por edhe vera nuk shtrydhet, por “rrushi shtrydhet për të prodhuar verë”. Ndërsa nuk është e domosdoshme shtrydhja e rrushit, sepse mund të shtrydhet edhe diçka tjetër, ndonjë lëndë tjetër për t’u prodhuar verë.

“Vërtet e pash veten në ëndërr, **prodhoja verë**”.



ANULIMI RETORIKO-STILISTIK DHE PËRDORIMI I KLLAPAVE APO MOSPËRDORIMI I TYRE

Të gjithë përkthyesit e Kur'anit përdorin kllapa.
Vetë përdorimi i kllapave tregon se ata kanë
konsultuar komentime të ndryshme,
që tregon se edhe përkthyesi nuk është asgjë tjetër
përpos një komentues, interpretues i fjalëve të
Kur'anit. Mirëpo, komentimi i Kur'anit është
një fushë e pafund. Është e vërtetë se përkthyesi
përdor metodologjinë e tij në përkthim (komentim),
por ajo metodologji nuk duhet të jetë metodologji,
e cila shpie në cungimin e retorikës dhe stilistikës së
Kur'anit. Kur'ani ndonjëherë përdor formën e
anulimit retorik, të cilin kur ta përkthejmë
nuk e përdorim, me fjalë të tjera nuk shtojmë
anulimin retorik në gjuhën shqipe.
Mirëpo, ndonjëherë duhet, ose patjetër duhet
për ta përkthyer anulimin retorik pa përdorje
të kllapave ose me përdorimin e kllapave.



... إِنْ امْرُؤٌ هَلَكَ لَيْسَ لَهُ وَلَدٌ ... – حذف (الاكتفاء) و لا والد

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“... nëse dikush vdes që **nuk ka fëmijë** ...”.

(En-Nisa, 176)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“... Nëse vdes një njeri që **nuk ka fëmijë** ...”.

(En-Nisa, 176)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“... Nëse vdes njeriu që **nuk ka fëmijë** ...”

(En-Nisa, 176)

Po ta kuptonin përkthyesit anulimin retorik dhe stilistik të Kur'anit, nuk do ta bënë këtë gabim, por edhe sikur ta dinin Fikhun, nuk do ta bënë këtë gabim, sepse ky ajet ka të bëjë me njeriun i cili vdes dhe nuk ka fëmijë dhe nuk ka prindër, e jo për njeriun, i cili nuk ka vetëm fëmijë siç është i përkthyer. Pra, për të përkthyer këtë ajet ka qenë e nevojshme të hulumtohet nëpër libra të fikhut dhe të përkthehet kështu:

“... Nëse një njeri vdes dhe **nuk ka fëmijë ai (dhe në të njëjtën kohë nuk ka edhe prindër)** ...”.

(En-Nisa, 176)

Mosekzistimi i fjalës në tekst “nuk ka edhe prindër”, nuk do të thotë se nuk ekziston në kuptim të anulimit retorik dhe stilistik, siç kanë përkthyer edhe përkthyesit në rastet e tjera.

... فَمَنْ كَانَ مِنْكُمْ مَّرِيضًا أَوْ بِهِ أَذًى مِنْ رَأْسِهِ فَفِدْيَةٌ مِنْ صِيَامٍ أَوْ صَدَقَةٍ أَوْ نُسُكٍ ...

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“... Dhe kush është i sëmurë, nga mesi juaj, ose i dhemb kryet, kompensimi është me agjërim ose lëmoshë ose kurban ...”.

(El-Bekare, 196)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“... Po kush është prej jush i sëmurë ose **ka mundim koke (e rruhet para koke)** kompensimi është agjërim, sadaka ose kurban ...”.

(El-Bekare, 196)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“... E kushdo që prej jush është i sëmurë ose që **ka ndonjë mundim në kokë (e rruhet)** le ta kompensojë me agjërim, lëmoshë ose kurban ...”.

(El-Bekare, 196)

Ai i cili është i sëmurë dhe i dhemb koka në haxh, nuk e kompenzon me agjërim, lëmoshë ose kurban, por vetëm nëse për shkak të sëmundjes apo për shkak të dhembjes në kokë e rruan kokën, ose i shkurton flokët, atëherë e kompenzon me (fidje) agjërim, ose lëmoshë, ose kurban. Në këtë ajet është përdorur anulimi retorik në gjuhën arabe, anulim retorik, i cili futet në kllapa gjatë përkthimit:

“Dhe kush është i sëmurë, nga mesi juaj, **ose i dhemb kryet (dhe i shkurton flokët apo rruhet)**, kompensimi ...”.

(El-Bekare, 196)

Por, anulimi retorik mundet edhe të mos futet në kllapa.

... فَمَنْ كَانَ مِنْكُمْ مَرِيضًا أَوْ عَلَى سَفَرٍ فَعِدَّةٌ مِنْ أَيَّامٍ أُخَرَ ...

Feti Mehdiu e përkthen kështu:

“... por ai nga ju, i cili është **i sëmurë ose në udhëtim** - atëherë tjera ditë me të njëjtin numër ...”.

(El-Bekare, 184)

Sherif Ahmeti e përkthen kështu:

“... e kush është **i sëmurë prej jush ose është në udhëtim** (e nuk agjëroi) atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë ...”.

(El-Bekare, 184)

Hasan Nahi e përkthen kështu:

“...ndonjëri prej jush që gjendet **i sëmurë ose gjendet në udhëtim** e sipër, ai i agjëron aq sa i ka prishur ...”.

(El-Bekare, 184)

Përkthyesi i parë nuk e ka kuptuar dhe nuk e ka cekur anulimin retorik, çka mund të kuptohet se ai i cili është i sëmurë apo në udhëtim, duhet të agjërojë ditë të tjera, pa marrë parasysh a ka agjëruar apo jo. Për këtë arsye ka qenë dashur ta përmendë:

“Ai, i cili është i sëmurë apo në udhëtim dhe nuk ka agjëruar (**pse nuk e ka për obligim për të agjëruar në udhëtim**), le të agjërojë më vonë po aq ditë”.

(El-Bekare, 184)

Përkthyesi i tretë nuk gjen term të përshtatshëm, por thotë: “... ai agjëron **aq sa i ka prishur**”, por duhet ta dimë jo “*aq sa i ka prishur*”, por *aq sa nuk i ka agjëruar*, sepse fjala “e ka prishur” jep të kuptosh se e ka filluar agjërimin para agimit, dhe e ka prishur në drekë apo pas dreke, e nëse në këtë rast priset agjërimi me qëllim, atëherë kompensimi për atë ditë është 60 ditë, plus një ditë.

... وَلَهُ أَخٌ أَوْ أُخْتٌ ... - حذف الصفه (من الأم)

Feti Mehdiu e përkthen kështu:

“... por kanë vëlla ose motër, ...”.

(En-Nisa, 12)

Sherif Ahmeti e përkthen kështu:

“... po ka një vëlla ose një motër (**nga nëna**) ...”.

(En-Nisa, 12)

Hasan Nahi e përkthen kështu:

“... por ka vëlla ose motër (**prej nënës**) ...”.

(En-Nisa, 12)

Në këtë ajet tregohet trashëgimia për të vdekurin, i cili ka motër (prej nëne), por është anuluar në tekstin e gjuhës së Kur'anit, për arsye stilistike.

Ndërsa përkthyesi i parë nuk e ka ditur se, a ka të bëjë me motër nga nëna, apo me motër nga nëna dhe babai, sepse po ta kishte ditur, do ta kishte futur në kllapa, siç ka vepruar në disa raste të tjera. Duhet ta dimë se në këtë rast përdorimi i fjalës “**prej nëne**” në kllapa është i domosdoshëm, pse atëherë ajeti nuk do ta kishte kuptimin e saktë. Pra, përkthyesi duhet ta dijë se - kur përdorimi i kllapave është i domosdoshëm, dhe kur është i nevojshëm.

... مَا شَهِدْنَا مَهْلِكَ أَهْلِهِ ... – (و مهلكه)

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“... Ne nuk dimë asgjë për maltretimin **e familjes së tij**, ...”.

(En-Neml, 49)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“... Ne nuk morëm pjesë në mbytjen **e familjes së tij**, ...”.

(En-Neml, 49)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“... Ne nuk kemi prezantuar në zhdukjen **e familjes tij**, ...”.

(En-Neml, 49)

Që të tre përkthyesit nuk e kanë kuptuar anulimin retorik, sepse në këtë rast ka qenë fjala për mbyetjen e pejgamberit dhe të familjes së tij, e jo vetëm mbytja e familjes së pejgamberit (Lutit) a.s..

Pra, ka qenë dashur së paku në kllapa ose në mënyrë të drejtpërdrejtë pa përdorimin e kllapave të përmendet edhe mbytja e pejgamberit:

“Ne nuk morëm pjesë në mbytjen (**e tij**) dhe të familjes së tij”.

(En-Neml, 49)

هَآ أَنْتُمْ أَوْلَآءِ تُحِبُّونَهُمْ وَلَا يُحِبُّونَكُمْ وَتُؤْمِنُونَ بِالْكِتَابِ كُلِّهِ ...
— حذف المقابل (و هم لا يؤمنون به كله)

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Qe, ju jeni ata që i doni, por ata nuk u duan juve, dhe ju u besoni të tëra libravet, ...”.

(Ali Imran, 119)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Ja, ju (myslimanë) jeni që i doni ata, e ata nukju duan juve, madje ju i besoni librat në tërësi (të gjitha shpalljet) ...”.

(Ali Imran, 119)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Ju jeni asi njerëzish që i doni ata, por ata nuk ju duan juve! dhe ju i besoni të gjitha librat ...”.

(Ali Imran, 119)

Asnjëri prej përkthyesve nuk e ka shtuar në përkthim anulimin retorik i cili vjen pas vazhdimit të ajetit, ndërsa ata nuk besojnë në të gjitha librat. Pra, ka qenë dashur të jetë si vijon:

“... ju i besoni librat në tërësi, **ndërsa ata nuk u besojnë librave në tërësi ...**”.

(Ali Imran, 119)

وَإِنَّ مِنْكُمْ لَمَنْ لَيُبَطِّئَنَّ ... — حذف القسم (لمن أقسم)

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Ka, ndër ju, edhe të atillë, të cilët me siguri do të **shpifin** ...”.

(En-Nisa, 72)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Ka disa prej jush që **zvariten** (nuk dalin në luftë) ...”.

(En-Nisa, 72)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Me të vërtetë disa **ngurrojnë** për të shkuar në luftë ...”.

(En-Nisa, 72)

Fjalën لَيْبُطْن “Lejubettienne”, njëri përkthyes e ka përkthyer “shpifin”, tjetri “zvarritet”, i tretë “ngurrojnë”.

... فَقُلْنَا اضْرِبْ بِعَصَاكَ الْحَجَرَ فَانْفَجَرَتْ مِنْهُ اثْنَتَا عَشْرَةَ عَيْنًا ... — حذف الجملة

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“... e Ne i thamë: “Bjeri me shkopin tënd gurit!” prej tij shpërthyen dymbëdhjetë burime ...”.

(El-Bekare, 60)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“... e Ne i thamë: “Bjeri gurit me shkopin tënd” atëherë nga ai gufuan dymbëdhjetë kroje ...”.

(El-Bekare, 60)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“... Ne i thamë: Bjeri gurit me shkopin tënd” – (**Ai i ra**) dhe nga ai rrodhën dymbëdhjetë burime ...”.

(El-Bekare, 60)

Shikoni në këtë ajet se si përkthyesi i tretë e ka kuptuar anulimin retorik dhe e ka shtuar në kllapa - “(**Ai i ra**) dhe nga ai rrodhën dymbëdhjetë kroje burime”. Ndërsa, përkthyesi i parë dhe i dytë këtë nuk e kanë bërë. Kështu që në gjuhën shqipe fjalia e parë dhe e dytë janë në një fjali, çka ka qenë dashur ndarë, pra për ta treguar fjalinë e parë urdhërore “Bjeri me shkopin tënd!”, e pastaj fjalinë tjetër “Ai i ra”, e pastaj vazhdimin “prej tij shpërthyen dymbëdhjetë burime”.

وَاسْأَلِ الْقَرْيَةَ ... حَذَفَ الْمُضَافَ (أهل)

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Pyete qytetin ...”.

(Jusuf, 82)

Sherif Ahmeti e përkthen kështu:

“Ti dërgo e pyeti (**banorët** në) qytetin ...”.

(Jusuf, 82)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Pyeti **banorët** e qytetit ...”.

(Jusuf, 82)

Te përkthyesi i parë mungon fjala “**banorët**”, pra për t’i pyetur *banorët e qytetit*, e jo për ta pyetur *qytetin*. Se mirëfilli dihet, se qyteti nuk është send që dëgjon dhe jep përgjigje, por banorët janë ata që dëgjojnë dhe japin përgjigje. Në gramatikë, por edhe në shkencën e Usuli Fikhut, kësaj i thuhet “*iktidau nas*” darurijin aklij”, pra, për t’ia bashkangjitur tekstit, për shkak se domosdo e kërkon logjika.

وَلَمَّا وَرَدَ مَاءَ مَدْيَنَ وَجَدَ عَلَيْهِ أُمَّةٌ مِّنَ النَّاسِ يَسْقُونَ ... — حذف المسند

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Kur arriti te uji i Medjenit aty takoi shumë njerëz, të cilët u jepnin ujë **kafshëve** ...”.

(*El-Kasas*, 23)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“E kur arriti ujin e Medjenit aty gjeti një grumbull njerëzish që po u jepnin ujë **kafshëve** ...”.

(*El-Kasas*, 23)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“E kur arriti tek uji i Medjenit, hasi rreth tij shumë njerëz që u jepnin ujë **kafshëve** ...”.

(El-Kasas, 23)

Që të tre përkthyesit e kanë kuptuar se këtu ekziston anulimi retorik, për këtë arsye edhe kanë shkuar në atë formë, sa që e kanë zëvendësuar me kafshë, respektivisht me bagëti. Në këtë ajet pra, kanë shtuar diçka çka nuk është drejtpërdrejt, por është dhe ekziston tërthorazi. Për këtë nuk jemi duke diskutuar në këtë rast, por që përkthyesi sikur në këtë rast, duhet të veprojë edhe në rastet e tjera. Prandaj, nëse vështrojmë përkthimet e këtyre tre përkthyesve, do të shohim se nuk kanë vepruar në rastet e tjera sikurse në këtë ajet, pra futjen në përkthim, të anulimit retorik apo stilistik.

... وَرَبُّ الْمَشَارِقِ حَذَفَ الْإِكْتِفَاءَ (و المغارب)

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“... dhe Zot i lindjeve”.

(Es-Saffatë, 5)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“... dhe Zot i lindjeve (**të yjeve**)”.

(Es-Saffatë, 5)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“... dhe Zot i lindjeve (**i verës dhe i dimrit**)”.

(Es-Saffatë, 5)

Në këtë ajet anulimi retorik është “... (**dhe i perëndimeve**)”, pra “Zoti i lindjeve **dhe i perëndimeve**. Për këtë arsye përkthyesi i dytë, anulimin retorik e ka zëvendësuar me kllapa “**të yjeve**”, po ashtu edhe përkthyesi i tretë e ka zëvendësuar me kllapa “**i verës dhe i dimrit**”, ndërsa përkthyesi i parë nuk e ka zëvendësuar me asgjë. Prandaj themi se, mosekzistimi në tekst në gjuhën arabe nuk do të thotë që të mos ekzistojë në gjuhën shqipe, sepse përkthimi në gjuhën shqipe nuk është përkthim i Kur’anit, por përkthim i komentimit të Kur’anit.

... سَرَابِيلٌ تَقِيكُمُ الْحَرَّ ... – حذف الإكتفاء (و البرد)

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“... u jep edhe veshje që u mbron nga **të nxehtit** ...”.

(En-Nahl, 81)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“... edhe petka që ju mbrojnë prej **të nxehtit** ...”.

(En-Nahl, 81)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“... dhe ka bërë për ju rroba që ju mbrojnë nga **nxehtësia** ...”.

(En-Nahl, 81)

Të tre përkthyesit nuk e kanë futur në përkthim fjalën “**dhe të ftohtit**” që është anuluar vetëm për shkak të oratorisë dhe retorikës.

Të gjithë e dimë se robat vishen për t’u mbrojtur nga të ftohtit. Nga të ftohtit rrobat janë të domosdoshme, për këtë arsye edhe ka ndodhur anulimi retorik, pse kur të vishen rrobat për t’u mbrojtur nga të nxehtit, atëherë për nga të ftohtit po se po. Mirëpo, përkthyesit nuk e kanë ditur apo nuk e kanë kuptuar këtë anulim retorik, por edhe po ta kishin kuptuar, ka qenë dashur për ta futur në fjali së paku në kllapa, si në ajetin e mëparshëm.

Pra, gjatë përkthimit e shtojmë fjalën në përkthim me kllapa apo pa to, sepse ne përkthejmë komentimin e Kur’anit, e jo Kur’anin:

“... petka që ju mbrojnë (**nga të ftohtit**) dhe nga nxehtësia”.

(En-Nahl, 81)

وَلَهُ مَا سَكَنَ فِي اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ ... — حَذَفَ الْإِكْتِفَاءَ (وَمَا تَحْرُكُ)

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Atij i takon çka do që **pushon (ekziston)** në ditë dhe natë ...”.

(El-En’amë, 13)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Vetëm e Tij është gjithçka **pushon e lëviz** natën e ditën ...”.

(El-En’amë, 13)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“E Tij është çdo gjë që **rri dhe lëvizë** natë e ditë ...”.

(El-En’amë, 13)

Në këtë ajet është bërë anulimi retorik, mirëpo është karakteristikë se që të tre përkthyesit e kanë kuptuar dhe e kanë futur fjalën “lëvizë” respektivisht “ekziston” në fjali, që tekstualisht në gjuhën arabe nuk ekziston, por nuk ka mjaftuar për përkthyesit që ta përkthejnë anulimin retorik vetëm në këtë rast , kështu që, ka qenë dashur të futet anulimin retorik edhe në shumë raste të tjera, por këtë nuk e kanë bërë, a thua nga dija? Po ta kishin ditur, do të vepronin si në këtë rast. A thua nuk kanë dashur të fusin fjalë që në tekst arab të Kur’anit nuk ekziston, atëherë pse në këtë rast fjala “lëvizë” në tekst nuk ekziston, por e kanë përkthyer?!

Të shohim në vazhdim një ajet tjetër se si ka qenë dashur të përkthehej, por nuk është përkthyer:

... وَيُنَزِّلُ لَكُمْ مِّنَ السَّمَاءِ رِزْقًا ...

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“... dhe ju lëshon furnizim nga qielli ...”.

(Gafir, 13)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“... dhe ju sjell furnizim prej qiellit (**shi**) ...”.


(Gafir, 13)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:


“... dhe ju zbret furnizim prej qiellit ...”.

(Gafir, 13)

Komentuesit e Kur’anit këtë ajet e komentojnë kështu: “*dhe ju lëshon (zbret) **shiun** nga qielli, i cili ju sjellë furnizim*”. Për këtë arsye përkthyesi i dytë e ka futur në kllapa fjalën “**shi**”, ndërsa i pari dhe i treti këtë nuk e kanë bërë.



**GABIM I MOSPËRFILLJES
SË VETAVE**



يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ إِذَا طَلَّقْتُمُ النِّسَاءَ

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“O Profet, kur t’i lëshoni gratë, ...”.

(Et-Talakë, 1)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“O ti pejgamber, kur t’i lëshoni gratë, ...”.

(Et-Talakë, 1)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:


“O Profet! Kur t’i lëshoni gratë, ...”.

(Et-Talakë, 1)


Që të tre përkthyesit kanë shkuar në atë drejtim dhe nuk e kanë treguar stilistikën e Kur'anit, nëse në gjuhën shqipe lejohet një formulim i një fjalie të tillë në rregull. Por, nëse gjuha shqipe nuk e lejon, atëherë duhet të formulohet fjali e plotë, duke shpjeguar se Zoti i Lartmadhëruar i ka treguar peygamberit të Tij që t'i tregojë popullit të tij se, nëse i lëshojnë gratë, atëherë të veprojnë në këtë, apo në atë mënyrë. Pra, të mos lihet njëjësi në fjali e pastaj të bëhet përzierja me shumësin:

“O ti peygamber **thua ju popullit tënd (pasardhësve të tu):** Nëse i lëshoni gratë ...”.

(Et-Talakë, 1)



**GABIM NË MOSKUPTIMIN
E FJALËS**



وَاسْتَفْزَزَ مَنْ اسْتَطَاعَتْ مِنْهُمْ بِصَوْتِكَ وَأَجْلَبَ عَلَيْهِمْ بِخَيْلِكَ وَرَجَاكَ ...

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Dhe përvetëso me zërin tënd cilin të mundesh dhe **përzini kalorësit tu edhe këmbësorinë tënde ...**”.

(*El-Israë, 64*)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Dhe me atë alarmin e zërit tënd, mashtroje atë që mundesh prej tyre, **me kalorësit e këmbësorët e tu thirri (bërtitu) ata, ...**”.

(*El-Israë, 64*)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Dhe, bëri për vete – me zërin tënd, - kë të mundesh nga ata, dhe sulmo në ta me britmë **me kalorësinë dhe këmbësorinë tënde, ...**”.

(*El-Israë, 64*)

Pra:

- “përzini kalorësit tu ...”,
- “mashtroje ... me kalorësit ...”,
- “sulmo ... me britmë ... me kalorësinë ...”.

Përkthimi i parë është në kundërshtim me të dytin dhe të tretin. Pse ...?!
Fjalja “përzini kalorësit tu” është e kundërt me “sulmo me kalorësinë”;
“Përzini kalorësit tu” është e kundërt me “mashtroje me kalorësit”.
Ndërsa “përzini”, “mashtroje”, “sulmo me britmë” kanë ardhur si përkthim i fjalës **و الجلب** “vexhlebe”, **و الجلب عليهم** “vexhlib alejhim”:

“... përdore zërin tënd alarmues **për t’i tubuar kalorësit dhe këmbësorinë tënde kundër tyre**”.

(El-Israë, 64)

... فَأُولَىٰ لَهُمْ

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“... Pra, për ata **më mirë do të ishte**”.

(Muhamed, 20)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“... **I gjetë e keqja**”.

(Muhamed, 20)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“... **E më e përshtatshme** do të ishte për ata”.

(Muhamed, 20)

Fjalën **أُولَىٰ** “Evla” përkthyesi i dytë e ka kuptuar “i gjetë e keqja”, çka nuk është e vërtetë, sepse ajeti tjetër është i ndërlidhur me këtë ajet:

“... **Më e mirë (dhe më e dobishme)** për ta është dëgjueshmëria dhe fjala efektive (realiteti)”.

(Muhamed, 20)

... إِنَّ يَكُنْ غَنِيًّا أَوْ فَقِيرًا فَاللَّهُ أُولَىٰ بِهِمَا ...

Sherif Ahmeti e përkthen kështu:

“... pse Allahu di **më mirë** për ta ...”.

(En-Nisa, 135)

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“... se Allahu është **mi i parë** se ata të dy palët ...”.

(En-Nisa, 135)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“... Perëndia është për ata **vlerësuesi më i drejtë** ...”.

(En-Nisa, 135)

Anglisht:

“... for Allah can **best protect** both ...”.

“... Allahu ka mundësi të jetë **mbrojtësi më i mirë** për të dy palët ...”.

(En-Nisa, 135)

Shikoni përkthimet:

“... Allahu di më mirë ...”;
“... Allahu është më i parë ...”;
“... Perëndia ... vlerësuesi më i drejtë ...”;
“... Allahu ... mbrojtësi më i mirë ...”.

Ndërsa esenca e ajetit nuk ka të bëjë me asnjërin prej këtyre përkthimeve, por ajeti sqaron drejtësinë, e kur është fjala për drejtësinë, e cila është obligim i Allahut pa marrë parasysh a janë prindër, të afërm, të pasur apo të varfër, obligimi i Allahut ka prioritet ndaj tyre:

“... nëse është i pasur apo i varfër, **obligimi i Allahut (drejtësia e Allahut)** ka prioritet ndaj tyre ...”.

(En-Nisa, 135)

... عَلَيْهِمْ دَائِرَةُ السَّوْءِ ...

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“... ata i gjetë belaja! ...”.

(Et-Tevbe, 98)

Sherif Ahmeti e përkthen kështu:

“... Kundër tyre e ardhmja qoftë e keqe ...”.

(Et-Tevbe, 98)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“... Le t’i godet ata vallja e fatkeqësisë ...”.

(Et-Tevbe, 98)

Anglisht:

“... on them be the disaster of evil ...”

“... mbi ta do të shkaktohet e keqja ...”.

(Et-Tevbe, 98)

Ibni Abasi këtë pjesë të ajetit kur'anor e interpreton dhe i jep domethënien “**ata i gjetë sprovimi dhe dënimi**”.

Përkthyesi i dytë dhe i tretë këtë pjesë të ajetit e konsiderojnë si “mallkim për ata”, por e vërteta është se “ata i gjetë sprovimi dhe dënimi”, ndërsa zakonisht mallkimi është për të ardhmen. Pra këtu është bërë gabim i ndryshimit të kohës.

وَمِنْهُمْ مَنْ يَلْمِزُكَ فِي الصَّدَقَاتِ ...

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Ka të tillë që për shkak të lëmoshës të **marrin nëpër gojë ...**”.

(Et-Tevbe, 58)

Sherif Ahmeti e përkthen kështu:

“Ka prej tyre që do të bëjnë **vërejtje** në ndarjen e lëmoshës ...”.

(Et-Tevbe, 58)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Ke edhe të tillë që të **qortojnë** për shkak ndarjes së lëmoshës ...”.

(Et-Tevbe, 58)

Anglisht:

“And among them are men who slander thee ...”

“Dhe disa prej tyre janë të cilët të qortojnë ty ...”.

(Et-Tevbe, 58)

Fjala لَمَزَ “lemeze” është përkthyer: “të marrin nëpër gojë”, “të bëjnë vërejtje”, “të qortojnë”. Këto domethënie nuk i kanë ikur aq shumë domethënies së vërtetë në gjuhën arabe, por fjala لَمَزَ “lemeze” më së shumti i përshtatet “për të kritikuar”:

“Disa prej tyre janë **që të kritikojnë** ty (në shpërndarjen e zekatit – pra, jo të lëmoshës) ...”, (Et-Tevbe, 58), sepse në këtë ajet fjala sadaka nuk e ka domethënien “dhënie vullnetare – lëmoshë”, por e ka domethënien e dhënies së domosdoshme (zekatit) – sadaka, sikurse është rasti në Kur’an në të njëjtën sure:

... إِنَّمَا الصَّدَقَاتُ - “Vërtet zekati ...”, pra jo lëmosha, sepse në sheriatin islam ka dallim të madh në mes të zekatit dhe lëmoshës (sadakës):

“Dhe ka disa prej tyre të cilët **të kritikojnë** ndarjen e **zekatit** ...”.

(Et-Tevbe, 58)

يَسْأَلُونَكَ عَنِ الْأَنْفَالِ ...

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Të pyesin **për plaçkën** ...”.

(El-Enfalë, 1)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Të pyesin ty (Muhamed) **për plaçkën** (e fituar në luftë), ...”.

(El-Enfalë, 1)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Të pyesin Ty (o Muhamed) **për plaçkën e luftës**, ...”.

(El-Enfalë, 1)

Fjala أَنْفَالٍ “ENFAL” do të thotë “tepricë nga diçka - vullnetarisht”, si p.sh. namazi نَافِلَةٌ “vullnetar” (nafile). Pra, çdo gjë që është e tepërt është ENFAL.

Lufta në islam nuk është luftë plaçkitëse, për të plaçkitur nga fronti, por lufta bëhet vetëm për vetëmbrojtje.

Ajeti në fjalë nuk ka të bëjë me plaçkën e luftës, por me tepricën e mbetur pas frontit, e cila ka qenë e ndaluar për pejgamberët e mëparshëm, ndërsa i është lejuar Muhamedit a.s.:

“Të pyesin ty (Muhamed) çka të veprohet me **pasurinë (tepricën) e mbetur pas frontit, ...**”.

(El-Enfalë, 1)

... لَيْشُبُوكَ ...

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“... që të të lidhin ...”.

(El-Enfalë, 30)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“... të ngujojnë, ...”.

(El-Enfalë, 30)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“... për të të **burgosur**, ...”.

(El-Enfalë, 30)

Anglisht:

“... to keep you in bounds, ...”.

“... të të mbajnë ty **në pranga**, ...”.

(El-Enfalë, 30)

Sipas transmetimit të Ibn Abasit pjesa e ajetit në fjalë ka domethënie: “që ty o Muhamed të të izolojnë (të të burgosin në shtëpi)”, sepse qëllimi i mushrikëve ka qenë ose ta izolojnë Muhamedin a.s. në shtëpi, ose ta mbysin, ose ta dëbojnë, siç e tregon vazhdimi i ajetit:

“ose të të vrasin ...” - **أَوْ يَقْتُلُوكَ**

“ose të të dëbojnë ...” - **أَوْ يَخْرُجُوكَ**

Pra, pjesa e parë e ajetit, nuk ka të bëjë me lidhjen, ngujimin, apo burgimin e Muhamedit a.s., sepse e demanton pjesa e dytë dhe e tretë e ajetit:

... لِيُثَبِّتُوكَ أَوْ يَقْتُلُوكَ أَوْ يُخْرِجُوكَ ...

“... që (ty o Muhamed) të të izolojnë (në shtëpi) ose të të vrasin ose të të dëbojnë (nga vendlindja e jote) ...”.

(El-Enfalë, 30)

قَالُوا إِنَّمَا أَنْتَ مِنَ الْمُسَحَّرِينَ

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Ata i thanë: Ti je vetëm një **i magjepsur**”.

(Esh-Shuaraë, 153)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Ata i thanë: Ti je vetëm **i magjepsur**”.

(Esh-Shuaraë, 153)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Ata thanë: >> Ti je vetëm njeri – **nga të magjepsurit**”.

(Esh-Shuaraë, 153)

Sipas Ibni Abasit transmetohet se populli i Salihut i ka thënë Salihut: “Ti je vetëm **krijesë e thjeshtë**”, sepse këtë e vërteton vazhdimi i ajetit tjetër:

(Esh-Shuaraë, 154) **... مَا أَنْتَ إِلَّا بَشَرٌ مِثْلُنَا**

Të tre përkthyesit:

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Ti je njeri si edhe ne”.

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Ti nuk je tjetër vetëm se njeri sikurse edhe ne”.

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Ti je vetëm njeri – ashtu si ne”.

Pra, populli i Salihut i ka thënë Salihu se *ti je njeri si ne, ti je njeri i thjeshtë, ne nuk të besojmë si pejgamber.*

Kur t’i ngjesim të dy ajetet fitojmë:

... أَنْتَ مِنَ الْمُسَحَّرِينَ . مَا أَنْتَ إِلَّا بَشَرٌ مِثْلُنَا ...

“Ti je vetëm **njeri i thjeshtë**, nuk je asgjë tjetër vetëm se njeri, sikurse ne”.

(Esh-Shuaraë, 153,154)

... فَبَصَرُكَ الْيَوْمَ حَدِيدٌ

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“... e sot e ke shikimin **të shtangur**”.

(Kaf, 22)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“... dhe tash ti sheh shumë **mprehtë**”.

(Kaf, 22)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“... dhe shikimi yt sot është **i prehtë**”.

(Kaf, 22)

Fjalën حَدِيد “Hadid” përkthyesi i parë e ka përkthyer “i shtangur”, ndërsa të njëjtën fjalë përkthyesi i dytë dhe i tretë e kanë përkthyer “i mprehtë”.

Shikoni pra të njëjtën fjalë si e kanë përkthyer përkthyesit në gjuhën shqipe!

Këtë ajet Zoti i Lartmadhëruar e ka shpjeguar në ajetin e suretul Kijame:

فَإِذَا بَرِقَ الْبَصَرُ

Që të njëjtën ngjarje në këtë ajet e përkthejnë:

“Por; kur t’i shtanget shikimi”.

(El-Kijame, 7)

“E kur të merren sytë (të pamurit)”.

(El-Kijame, 7)

“Kur syri (shikimi) shqetësohet nga friga”.

(El-Kijame, 7)




TERMINOLOGJIA E FIKHUT

Kur'ani ka zbritur në gjuhën arabe, por gjatë zbritjes së Kur'anit janë paraqitur fjalë terminologjike dhe fjalë me domethënie të posaçme për një çështje

– terma të veçantë. Kështu që edhe Muhamedi a.s. shumicën e fjalëve ua ka sqaruar sahabëve.

Shembull kemi fjalën الزكاة zekat – në etimologjinë arabe do të thotë “*pastrim*”, por në terminologji është shumë e caktuar 2.5 %, e cila jepet prej pasurisë, pasi të kalojë një vit i plotë dhe që ka arritur nisabin (85 gr. ari). Prandaj, kjo fjalë nuk përkthehet ndryshe pos “zekat”. Po ashtu kemi shembullin e fjalës الصلاة “salah”, e cila ka domethënien e “lutjes”. Por, në terminologji ajo merr domethënien e “lutjes obligative”, jo vetëm me gojë, por edhe me praktikimin e rukus, sexhdes dhe pjesëve të tjera të namazit. Prandaj, përkthyesi këtë duhet ta ketë parasysh.



إِنَّمَا الصَّدَقَاتُ ... وَابْنِ السَّبِيلِ ...

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Zeqati u takon ... **udhëtarëve - musafirë**, ...”.

(Et-Tevbe, 60)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Allahu caktoi obligim që lëmoshat (zeqati etj) ... **që ka mbetur në rrugë**, ...”.

(Et-Tevbe, 60)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Lëmosha u takon vetëm ... dhe **udhëtarit të rastit**, ...”.

(Et-Tevbe, 60)

Anglisht:

“Alms are ... and for the wayferer, ...”.

“Zekati u takon ... dhe **udhëtarëve**, ...”.

(Et-Tevbe, 60)

Fjala ابن “Ibn” do të thotë “**djalë**”.

Fjala سبيل “Sebijl” do të thotë “**rrugë**”.

Që të dy fjalët formojnë një domethënie të plotë, që udhëtarit i janë harxhuar të hollat, i janë ndërprerë marrëdhëniet me familjen dhe vendlindjen, nuk ka të holla të kthehet në shtëpi, atij rruga i është bërë prind, ai është i biri, i cili ka nevojë për prindin, e prind i vetëm për të është rruga.

Prandaj, të tillëve u takon zekati, ndërsa bëhet pyetja se, a u takon zekati *udhëtarëve musafirë*?

Përgjigjja – natyrisht jo.

Pyetja se, a i takon zekati *udhëtarit të rastit*?

Përgjigjja – natyrisht jo.

Pyetja se, a i takon **atij që ka mbetur në rrugë**?

Përgjigjja – po, nëse i janë ndërprerë marrëdhëniet me familjen dhe vendlindjen e dëshiron të kthehet në shtëpi.

Përkthyesi i tretë fjalën “Sadeka” e ka përkthyer lëmoshë, çka është gabim, ngase **lëmosha** është dhënie sipas dëshirës e papërcaktuar, ndërsa **zekati** është dhënie obliguese e përcaktuar 2.5% të pasurisë.

... فُلْ مَا أَنْفَقْتُمْ مِنْ خَيْرٍ فَلِلْوَالِدَيْنِ وَالْأَقْرَبِينَ وَالْيَتَامَى وَالْمَسَاكِينِ وَابْنِ السَّبِيلِ

...

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“... edhe për bonjakët e varfanjakët edhe **udhëtarët** ...”.

(El-Bekare, 215)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Atë që jepni prej pasurisë jepni për prindërit, jepni për të afërmit, për bonjakët, për të varfrit **për gurbetçinjtë** ...”.

(El-Bekare, 215)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Çfarëdo lëmoshe që e jepni ajo le t’i takojë prindërve, farefisit, bonjakëve, të varfërve **dhe udhëtarëve** (që kanë ngelur në rrugë pa mjete) ..”.

(El-Bekare, 215)

Shikoni, përkthyesi i dytë ka përdorur fjalën “për gurbetçinjtë”. Edhe tek ne përdoret fjala “gurbet” që rrënjën apo prejardhjen e ka prej gjuhës

arabe që do të thotë “i huaj”. Por, bëhet pyetja: A u takon zekati gurbetçinjve?! Gjithsesi përgjigja do të ishte – Jo.

Sepse gurbetçinjtë, të cilët punojnë, kanë pasuri, ata e japin zekatin e nuk e pranojnë zekatin, ngase ata nuk e meritojnë, ndërsa në bazë të përkthimit të dytë në gjuhën shqipe kuptohet se atij (gurbetçarit) i takon zekati.

... وَإِنْ كَانُوا إِخْوَةً رِجَالًا وَنِسَاءً فَلِلذَّكَرِ مِثْلُ حَظِّ الْأُنثَىٰ ...

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“... Po nëse ata janë **vëllezër – burra dhe gra** atëherë mashkullit i takon aq sa dy femrave së bashku ...”.

(En-Nisa, 176)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“... Në qoftë se janë **vëllezër dhe të përzierë burra dhe gra ...**”.

(En-Nisa, 176)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“... Në qofshin **trashëgimtarët vëllezër e motra ...**”.

(En-Nisa, 176)

Anglisht:

“... (bitwin them) If there are brathers and sisters ...”.

“... Nëse në **mesin e tyre ka vëllezër e motra ...**”.

(En-Nisa, 176)

Dy përkthimet e para kanë bërë gabim gjuhësor, pse vëllezërit nuk janë burra dhe gra, por vetëm burra.

Ndërsa, dy përkthimet e dyta fjalën **إِخْوَةٌ** “ihvetun” e kanë zëvendësuar me “trashëgimtarë”, dhe “në mesin e tyre”. Si do që të jetë, ajeti nuk ka të bëjë vetëm me vëllezër, sepse gratë nuk janë vëllezër, përveç kësaj këtu rangu vëllazëror-motëror nuk është vetëm i një rangu, por i dy rangjeve p.sh. vëllai-djalin dhe motrën e vëllait, e këtu motra e vëllait është në rangun e vëllait sipas dispozitës, mirëpo ajo merr një hise më pak sepse është femër – grua:

“... Nëse ata janë **të rangjeve vëllazërorë-motërorë** burra dhe gra, atëherë mashkullit i takon hise sa dy femrave ...”.

(En-Nisa, 176)

... وَلِلَّهِ عَلَى النَّاسِ حِجُّ الْبَيْتِ مَنِ اسْتَطَاعَ إِلَيْهِ سَبِيلًا ...

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“... **Të vizituarit** e tempullit, për hirë të Allahut, për atë që ka mundësi ta marrë këtë udhë është obligim ...”.

(Ali Imran, 97)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“... Për hirë të Allahut, **vizita** e shtëpisë (Qabës) është obligim ...”.

(Ali Imran, 97)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“... Perëndia i ka obliguar njerëzit, ata që kanë mundësi t’i përballojnë rrugës, **ta vizitojnë** (Haxhillëk) këtë Faltore ...”.

(Ali Imran, 97)

Fjala **حَجَّ** “Haxh” në gjuhën arabe ka domethënie: qëllim i caktuar, kur mësyn për të kryer diçka, e jo **vizitë**!

Që të tre përkthyesit fjalën **حَجَّ** “Haxh” e kanë përkthyer “vizitë” – çka nuk e ka atë domethënie as në gjuhën arabe, ndërsa në terminologjinë e fikhut

“Haxhi” është “me mësy për qëllim të caktuar për të shkuar në shtëpinë e shenjtë (Qabe) për t’i kryer obligimet dhe për të qëndruar në Arafat (Arafati nuk është shtëpi e shenjtë), në kohë të caktuar, dhe me mundësi”.

Për këtë arsye përkthyesi në gjuhën angleze këtë pjesë të ajetit e përkthen:

“... **Pilgrimage** thereto is a duty ...”.

“... Haxhi është një obligim ...”.

Por, edhe nëse e marrim fjalën “Pilgrimage” në gjuhën angleze nuk e plotëson definicionin e plotë të Haxhit në gjuhën arabe.

... فَأَخْوَانُكُمْ فِي الدِّينِ وَمَوَالِيكُمْ ...

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“... ata janë vëllezërit tuaj nga feja dhe **pasardhësit tuaj** ...”.

(El-Ahzabë, 5)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“... ata janë vëllezërit tuaj dhe **të afërmit tuaj në fe** ...”.

(El-Ahzabë, 5)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“... ata janë vëllezërit tuaj për nga besimi dhe **mbrojtësit tuaj** ...”.

(El-Ahzabë, 5)

Anglisht:

“... your Brathers in feith **Or your friend’s** ...”.

“... vëllezërit e juaj në fe ose **shokët e juaj** ...”.

(El-Ahzabë, 5)

Fjala مَوَالِيكُمْ “Mevalijikum” është përkthyer: “pasardhësit e juaj”, “të afërmit tuaj”, “mbrojtësit tuaj”, “shokët e juaj”, çka në terminologjinë e fikhut “Mevla” është, ai i cili është kujdestar dhe nën kujdesin e tjetërkujt.

Nëse kuptojmë fjalën موالیکم “mevalijkum” – pasardhës, atëherë pasardhësi trashëgon, sepse pasardhësi është vetëm biri, nipi etj., ndërsa ajetet e kësaj sureje kanë zbritur për të mos trashëguar asgjë, përveç nëse i vdekuri nuk ka trashëgimtar, atëherë për të mos humbur pasuria trashëgon, në të kundërtën jo, po ashtu u lejohen martesat, pse ata nuk janë të një loze.

Përkthimi “të afërmit tuaj në fe” nuk mund të ketë domethënien e vërtetë, sepse i afërmi e merr mbiemrin e kujdestarit, ndërsa موالیکم “mevalijkum” nuk e marrin këtë mbiemër. Pra, ata nuk janë as pasardhës, as të afërm, as mbrojtës, as shokë, por ata janë nën kujdes, të cilët meritojnë kujdes për ta, sikur të jenë vëllezër në fe – janë vëllezërit e juaj për nga feja dhe nën kujdesin tuaj.

... إِنَّ ذَلِكَ مِنْ عَزْمِ الْأُمُورِ

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“... Kjo është me të vërtetë **detyrë themelore**”.

(Llukman, 17)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“... këto janë nga çështjet **më të preferuara**”.

(Llukman, 17)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“... kjo është nga **punët e mëdha, të vendosura**”.

(Llukman, 17)

Përkthimi i dytë fjalën عزم “azm” e përkthen “*më të preferuar*”, ndërsa عزم “azm” është obligative apo urdhërore. Pra, derisa të vendoset për diçka ajo është e lirë e lejuar - as e ndaluar, as e urdhëruar, por kur të vendoset, atëherë merret vendimi për urdhëresë apo ndalesë, ndërsa e kundërta e “azimes” është “ruhsa” – lehtësimi, kur të lejohet diçka pasi që ka qenë vendosur si ndalesë.

Filli i ajetit vjen në formën urdhërore:

“Fale namazin” - أقم الصلاة ,

atëherë namazi nuk është prej çështjeve më të preferuara, por nga çështjet obligative – vendimtare:

“... vërtet, këto janë nga **çështjet vendimtare**”.

(Llukman, 17)



GABIME SHKENCORE

Dijetari i njohur Gazali thotë: “Natyra e cila nuk flet është Kur’ani, Kur’ani i cili nuk flet është natyra”. Kur’ani Fisnik nuk ka zbritur për t’u lexuar vetëm në kohë e Muhamedit a.s., nuk ka zbritur për t’u lexuar vetëm prej kohës së Muhamedit a.s. e deri më sot, por ka zbritur për t’u lexuar prej kohës së Muhamedit a.s., sot, e deri në Ditën e Kijametit.

Jeta është dinamike dhe ecën përpara, njohuria e njeriut është dinamike dhe ecën përpara, poashtu edhe natyra e Kur’anit Fisnik është dinamike

dhe ecën përpara. Nëse në të kaluar nuk është kuptuar
diçka nga Kur'ani Fisnik, nuk është faji te
Kur'ani Fisnik, por faji është te mendja e njeriut,
e cila nuk e ka zbuluar atë thesar më parë në
Kur'anin Fisnik. Si shembull më konkret të marrim
atë se, tek arabët ka pasur naftë nën këmbët e tyre
edhe para një shekulli, mirëpo nuk është faji që
toka nuk e ka hedhur naftën mbi tokë para një shekulli,
por faji është që ata e kanë pasur nën këmbët e tyre
edhe para një shekulli, mirëpo nuk kanë pasur njohuri
dhe nuk kanë ditur për ta zbuluar naftën deri në
këtë shekull.



... إِنَّا لَمُوسِعُونَ

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“... me të vërtetë **mundemi edhe më tepër**”.

(Edh-Dharijatë, 47)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“... Ne e **zgjerojmë atë**”.

(Edh-Dharijatë, 47)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“... Në të vërtetë jemi **të pushtetshëm edhe më tepër**”.

(Edh-Dharijatë, 47)

Anglisht:

“... We indeed Have vast power”.

“... Ne vërtet kemi **fuqi edhe më të madhe**”.

(Edh-Dharijatë, 47)

Është e vërtetë se Zoti e ka krijuar gjithësinë, ka fuqi edhe më të madhe se të krijojë gjithësinë, është e vërtetë se ka pushtet edhe më tepër. Por, fshehtësia e Kur'anit është aty se gjithmonë në fjalë të njëjtë sot, nesër e në të ardhmen do të gjejmë diçka çka në të kaluarën nuk e kemi ditur.

Shkenca e ka vërtetuar se kjo gjithësi bymehet, zgjerohet, shumohet edhe me yje, por fjala موسعون “Musiunë” ka domethënie të dyfishtë, që do të thotë se Zoti e ka krijuar gjithësinë dhe ka aftësi për të krijuar edhe më tepër, por e njëjta fjalë موسعون “Musiunë” ka domethënie se Zoti ka krijuar gjithësinë dhe Ai e zgjeron atë. Pra, alternativa e dytë jep të kuptosh se *Zoti e zgjeron gjithësinë*, e jo si alternativa e parë se, *Zoti ka mundësi më tepër*, e nuk kuptohet a e zgjeron gjithësinë, apo jo.



GABIME GJUHËSORË NË GJUHËN SHQIPE

Kjo natyrë e gabimeve është shkak i moskonsultimit,
për fjalë të veçanta e terma me albanologët
apo gjuhëtarët.

Lirisht mund të them se përkthim të Kur'anit
individual nuk duhet të ketë, por përkthim të Kur'anit
të bashkëpunimit të një kolegjiumi, në të cilin do të

merrnin pjesë të gjithë të specializuarit e profileve të ndryshme, por edhe në kolegji jo të ketë nga një të specializuar të një profili, por të ketë më shumë se një të atij profili, që kur të haset në një problematikë gjatë përkthimit, ata të specializuarit ta marrin barrën dhe përgjegjësinë për atë fjalë apo fjali të ajetit dhe ta konstruktojnë në mënyrën më të mirë, më të përshtatshme dhe më të volitshme.



انْطَلِقُوا إِلَى ظِلِّ ذِي ثَلَاثِ شُعَبٍ

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Shkoni pas asaj **hijes ndarë në tri hije**”.

(El-Murselatë, 30)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Shkoni te ajo **hije (mjegull) që ka tri degëzime**”.

(El-Murselatë, 30)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Shkoni kah **tymi i ndarë në tri fjollë**”.

(El-Murselatë, 30)

Hija e rëndë në Xhehenem do të jetë e trefishtë, që do të thotë tejet e errët, e mjegulluar, e shëmtuar. Ndërsa, nëse e përkthejmë hije e ndarë në tri hije, ose hije me tri degëzime, ose e ndarë në tri fjolla, kjo do të thotë se është shpërndarë hija dhe është bërë më e kthjellët, sepse, faktikisht hija e ndarë në hije edhe e degëzuar është më e kthjelltë se hija e trefishtë. Ndoshta përkthyesit fjalën شُعَب “shuab” e kanë përkthyer fjalë për fjalë (bukvalisht), por në këtë rast nuk përkthehet në vetvete, por ثَلَاثِ شُعَب “thelathe shuab” trefish e hijezuar.

فِيهِمَا مِنْ كُلِّ فَاكِهَةٍ زَوْجَانِ

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Aty nga secila pemë do të ketë **çifte**”.

(Err-Rrahman, 52)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Në ata dy, prej të gjitha pemëve ka nga **dy lloje**”.

(Err-Rrahman, 52)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Në ta – prej çdo lloj peme ka nga **dy lloje**”.

(Err-Rrahman, 52)

Po të shikojmë në gjuhën shqipe te të tre përkthyesit, shohim se në Xhenet secila pemë do të ketë pemë çifte, ose secila pemë do të ketë nga dy lloje.

ذَوَاتَا أَفْنَانٍ

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Të dy plot me **lisa me degë**”.

(Err-Rrahman, 48)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“(Xhenete) plot **degë me gjethe e pemë**”.

(Err-Rrahman, 48)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“(dy Xhenete) me **drunjë të degëzuar**”.

(Err-Rrahman, 48)

Çdo njeri e di, vetëm kur të përmenden lisat, se lisat kanë degë, po ashtu sikurse pemët kanë gjethe, apo drunjtë janë të degëzuar. A thua përkthimi i Kur'anit vetëm kështu mjafton ?

A thua Kur'ani në gjuhën arabe ka këtë domethënie? Për të sqaruar këtë, dua të them se, ka lisa me pak degë dhe me shumë degë; ka pemë me pak gjethe e fruta dhe ka pemë me shumë gjethe e fruta. Por, ajeti në fjalë nuk ka të bëjë as me të parën as me të dytën. Ajeti tregon një hiperbolë të pemëve të Xhenetit, e ajo është se pemët, lisat, drunjtë kanë degë, gjethe e fruta për së tepërmi, sa që është e pamundur të përshkruhet se sa të dendura janë degët, sa të shumta janë gjethet, sa të mira dhe të shumta janë frutat. Ndërsa, të tre përkthimet e

kanë zbehur për së tepërmi ajetin, sa që edhe e kanë zhvleftësuar me retorikë tepër të dobët në gjuhën shqipe.

فِيهَا فَاكِهَةٌ وَالنَّخْلُ ذَاتُ الْأَكْمَامِ

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“E në të ka pemë, hurma dhe **fryte në lule**”.

(Err-Rrahman, 11)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Në të ka pemë të llojllojta ka edhe **hurma me shporta të mbështjellta**”.

(Err-Rrahman, 11)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Në të ka pemë të llojllojshme dhe **hurme me fryte (në gëzhøjë)**”.

(Err-Rrahman, 11)

Së pari duhet të thksohet se çifti i fjalëve frut dhe fryt janë dy fjalë me kuptim krejt të ndryshëm. Fjala fryt është emër abstrakt dhe tregon rezultatin, p.sh. këto janë frytet e punës së bërë; ndërkaq fjala frut-a është fjalë konkrete dhe tregon ato që japin pemët – frutat e pemëve. Këto në përkthim të Kur’anit nuk duhet të ngatërrohen.

Çdo kush e di se “frutat në lule” janë të papjekura, do të thotë kanë filluar të piqen.

فَحَاسِبْنَاهَا حِسَاباً شَدِيداً

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“... Ne do të kërkojmë prej tyre, rreptësishtë, që të japin llogari ...”.

(Et-Talakë, 8)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“... Ne i kemi **shpërblyer** me një llogari të ashpër ...”.

(Et-Talakë, 8)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“... Ne do të kërkojmë prej tyre llogari precize ...”.

(Et-Talakë, 8)

Përkthyesi i dytë fjalën حساب “**Hisab**” e ka përkthyer me fjalën **shpërblim**, e që është tepër larg nga domethënia e vërtetë. Është aq larg, sa që edhe me ironi në këtë rast nuk mund të përdoret.

**MOSPËRDORIMI I
THONJËZAVE PËR IRONI**



... إِنَّكَ لَأَنْتَ الْحَلِيمُ الرَّشِيدُ

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

... Ti njëmend qenke i butë dhe i udhëzuar!

(Hudë, 87)

Kjo pjesë e ajetit është dashur të futet në thonjëza, sepse populli i Shuajbit po ta kishin pohuar një gjë të tillë ata e kishin pasur me të drejtë se Shuajbi me të vërtetë ka qenë i butë dhe i udhëzuar; mirëpo çështja nuk është ashtu, sepse ata janë tallur me Shuajbin dhe me ironi i kanë thënë: “Ti njëmend qenke i butë dhe i udhëzuar”, ndërsa ata kanë deklaruar dhe kanë thënë se nuk është Shuajbi i butë dhe nuk është i udhëzuar, pra përdorimi i thonjëzave në ironinë apo talljen e popullit të Shuajbit, e jo pohimin e popullit të tij.

Për këtë arsye Sherif Ahmeti e fut në kllapa talljen e tyre dhe e përkthen kështu:

“... Vërtet, ti qenke i butë e i mençur”. (Kjo ishte tallje e tyre)

Po kështu në kllapa e ka përdorë edhe Hasan Nahi:

“... Me të vërtetë, sa i butë dhe i drejtë që je ti! (thanë ata në formë ironike)”.

فَبَشِّرْهُمْ بِعَذَابٍ أَلِيمٍ

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Prandaj **përgëzoji** për vuajtje të dhembshme”.

(El-Inshikakë, 24)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“**Lajmëroi**, pra me një dënim të dhembshëm”.

(El-Inshikakë, 24)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Prandaj, **sihariqoi** ata me dënim të dhembshëm”.

(El-Inshikakë, 24)

Lajmërimi është për gjëra të mira dhe të këqija.

Përgëzimi është fjalë që lajmëron vetëm për gjëra të mira, mirëpo çdo orator përdor ironi. Po ashtu edhe Kur’ani në këtë rast me ironi thotë - “**Përgëzoi** **ata me një dënim të dhembshëm**”. Pra, fjala *përgëzim* duhet të futet në thonjëza, përndryshe kjo fjali është fjali e zbehur dhe e paqartë, sa që çdo lexues në gjuhën shqipe ndien mangësi dhe zbrazëti në zemër, ose në të kundërtën, fjala “*përgëzim*” të zëvendësohet me fjalën “*lajmërim*”, siç ka vepruar përkthyesi i dytë.

- Dhe “përgëzoi” ata me dënim të dhembshëm.

1. Fjalë me ngjyrim emocional pozitiv (gëzim, kënaqësi, mburrje, urim, përgëzim dhe negativ: përbuzje, tallje, mospërfillje etj).

“Përgëzoj” është pozitiv, prandaj ose të futet në kllapa ose të zëvendësohet me fjalë emocionale negative (antonim: “përçmues”).



**GABIM I MOSPËRSHTATJES SË
FJALËS NË GJUHËN SHQIPE**



فَكَيْفَ كَانَ عَذَابِي وَنُذْرٍ

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Dhe çfarë ishte dënimi dhe **vuajta ime se!**”

(Kamer, 16, 18, 21, 30)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“E çfarë ishte ndëshkimi im dhe **kërcënimi im**”.

(Kamer, 16, 18, 21, 30)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Dhe, çfarë ka qenë dënimi Im dhe **paralajmërimet e Mia**”.

(Kamer, 16, 18, 21, 30)

Në gjuhën angleze është përkthyer kështu:

“But how (terrible) was My Chastisement and My Warning”.

“Por sa (i tmerrshëm) ka qenë dënimi Im dhe **vërejtjet e Mia**”.

(Kamer, 16, 18, 21, 30)

Përkthyesi i parë fjalën نُذْرٍ “nudhur” e ka përkthyer “vuajtje”, çka në të vërtetë nuk mund të ketë këtë domethënie. “Vuajtja” në bazë të këtij përkthimi ka të bëjë me vuajtjen e Zotit. Jo, gjithsesi jo!! Kjo nuk është e vërtetë. Ajeti në fjalë ka të bëjë për ata që i ka dënuar Zoti, dhe ua ka tërhequr vërejtjen gjeneratave të tjera se i dënon me të njëjtin dënim, nëse nuk besojnë dhe nuk i dëgjojnë urdhrat e Zotit.

قَوَارِيرَ مِنْ فِضَّةٍ قَدَّرُوهَا تَقْدِيرًا

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“**Kristale nga argjendi**, me madhësi sipas dëshirës”.

(El-Insan, 16)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“**Të tejdukshme nga argjendi** që ata (shërbëtorë) përcaktuan të jenë sa duhet (të mëdha e të vogla)”.

(El-Insan, 16)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“**Të tejdukshme nga argjendi**, madhësinë e të cilave (do ta zgjedhin) sipas dëshirës”.

(El-Insan, 16)

Në gjuhën angleze është përkthyer kështu:

“Cristal-clear, made of silver”.

“**Kristale** të pastra të prodhuara **prej argjendit**”.

(El-Insan, 16)

Kristali është kristal, argjendi është argjend, këto dy gjëra janë të njohura tek njerëzit. Prandaj përkthyesit kanë hasur në vështirësi. Të gjithë e dinë se argjendi nuk është i tejdukshëm, ndërsa kristali është i tejdukshëm. Por si të bëhet kompromisi në përkthim? Kjo çështje duhet të shpjegohet me metodologjinë e Kur'anit, jo vetëm me përkthim të shpejtë si përkthyesi i parë, e as si përkthyesit e tjerë.

Duhet shpjeguar se gotat në Xhenet do të jenë prej kristalit, të cilat janë aq shumë të pastra, të kthjellëta sa që shndërisin sikur argjendi. E jo të “përkthehet kristale nga argjendi”, e as të “tejdrukshme nga argjendi”, e as “kristale të prodhuara prej argjendit”.

أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ يَزْعُمُونَ أَنَّهُمْ آمَنُوا بِمَا أُنْزِلَ إِلَيْكَ ...

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“A nuk i sheh ata, të cilët **vërtetojnë** se besojnë ...”.

(En-Nisa, 60)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“A i vure re ata që **mendojnë** se besuan atë që të zbreti ty ...”.

(En-Nisa, 60)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“A nuk i ke parë Ti (o Muhamed) ata që **pohojnë** se kanë besuar në atë që është shpallur Ty ...”.

(En-Nisa, 60)

Fjala زعم “zeame” në gjuhën arabe nuk e ka asnjërën prej këtyre domethënieve: as vërtetim, as mendim, as pohim, por më e preferuar, e cila i përshtatet jo vetëm tekstit, por edhe qëllimit të ajetit kur’anor është – të thuash diçka, jo vetëm që nuk është e sigurt, por edhe që ke qëllim tjetër prej asaj që thua, pra **të pretendosh**:

“A nuk i ke parë ata që **pretendojnë** ...”.

Në gjuhën angleze është përkthyer “who declare” – të cilët deklarojnë.

قَوْلٌ مَعْرُوفٌ وَمَغْفِرَةٌ خَيْرٌ مِنْ صَدَقَةٍ يَتْبَعُهَا أذى ...

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Fjala e mirë dhe **falja** janë më të mira se një lëmoshë të cilën e përcjell shqetësimi ...”.

(El-Bekare, 263)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Një fjalë e mirë dhe **një lehtësim** (që i bëhet lypësit) është më e dobishme se një lëmoshë që përcillet me të keqe ...”.

(El-Bekare, 263)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“**Fjala e mirë dhe falja e gabimit** ...”.

(El-Bekare, 263)

Anglisht:

“Kind words and covering of faults ...”.

“Fjala e mirë dhe **falja e gabimeve** ...”.

Për përkthyesin e parë, më mirë do të ishte t’ia bashkëngjitte fjalës “falja” edhe fjalën “gabimi”, pra “falja e gabimit”, sepse në gjuhën shqipe mund të kuptohet si “falja”, që ka për qëllim falja e namazit.

إِنَّا سَنُلْقِي عَلَيْكَ قَوْلًا ثَقِيلًا

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Ne do të dërgojmë, njëmend, fjalë **të rënda**”.

(El-Muzzemmil, 5)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Ne do të shpallim ty fjalë **të rëndë** (të madhe)”.

(El-Muzzemmil, 5)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Ne me të vërtetë do të dërgojmë ty fjalë **të rënda**”.

(El-Muzzemmil, 5)

Që të tre përkthyesit fjalën ثَقِيل “thekijlë” e kanë përkthyer “të rëndë”, në mënyrë jo të përshtatshme. Mirëpo duhet shikuar që kjo fjalë a përshtatet në gjuhën shqipe apo jo. Pse, fjala “e rëndë” gjithmonë ka kuptim të keq në gjuhën shqipe, si p.sh. kur themi: Një mend e ka rënduar! – Po si e ka rënduar? – Me fjalë të rënda (e ka rënduar me fjalë të rënda).

Përkthyesit duhet bërë kompromis që fjala ثَقِيل “thekijlë” të përkthehet fjalë të “rëndësishme”, të çmuara, të larta, që kanë peshë, dhe që janë të vështira për Muhamedin a.s. për t’ua përcjellë pabesimtarëve, të cilët me kokëfortësinë e tyre vështirë i pranojnë fjalët e rëndësishme, të çmuara, të larta, që kanë vlerë, dhe kanë peshë për nga përmbajtja e tyre.

**GABIME TE FOLJET
TRANSITIVE**



... لِنَحْكُمَ بَيْنَ النَّاسِ بِمَا أَرَاكَ ...

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“... që të gjykosh mes njerëzve me atë **që të mësoi Allahu ...**”.

(En-Nisa, 105)

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“... që t’u ndajsh drejtësi njerëzve ashtu **siç ta shpallë Allahu-llahu ...**”.

(En-Nisa, 105)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“... për të gjykuar në mes njerëzve ashtu **si ta ka shpallur ty Perëndia ...**”.

(En-Nisa, 105)

Në shkencën e sheriatit islamik ky ajet argumenton “ixhtihadin” e Muhamedit a.s. përpos asaj çka i është shpallur, çka do të thotë mendimin e lirë të Muhamedit a.s. për një çështje, duke u bazuar në aftësitë e tij. E nëse i Dërguari i Tij e qëllon, atëherë ai mendim llogaritet argument, e nëse gabon, atëherë zbret shpallja për përmirësimin e atij gabimi.

Pra folja أَرَاكَ “ERAKE” është folje transitive që kalon edhe në atë çka i është shpallur të Dërguarit a.s. edhe në vetë të Dërguarin a.s. pa përfshirë shpalljen.

Anglisht:

“... by that which Allah has shown thee ...”.

“... **me atë** që Allahu të ka mësuar ty ...”.

ka qenë dashur: “... about that ...”.

Pra ky gabim është i natyrës së lehtë, por duhet pasur parasysh se Kur’ani është argument kryesor i sheriatit, në të cilin pastaj mbështeten argumentet e tjera. E nëse në Kur’an nuk ka mbështetje “Ixhtihadi i Muhamedit a.s.”, atëherë ku të bazohemi në ixhtihadin e tij?!

Pra ajeti përkthehet:

“... që të gjykosh në mesin e njerëzve **për atë** që Allahu të ka mësuar për të gjykuar ...”.

(En-Nisa, 105)



GABIM I FILLIMIT TË AJETIT



اسْتَبَاراً فِي الْأَرْضِ وَمَكْرَ السَّيِّئِ وَلَا يَحِيقُ الْمَكْرُ السَّيِّئُ إِلَّا بِأَهْلِهِ ...

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Duke bërë arrogancë në tokë dhe kurtha të këqija, por kurthat do t’i godasin mu ata të cilët shërbejnë me ta ...”.

(*Fatir*, 43)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“(Largim) Për shkak të mendjemadhësisë dhe dredhisë së keqe, por dredhia e keqe nuk godit tjetër vetëm ata që e kurdisën ...”.

(*Fatir*, 43)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“(për) mendjemadhësinë në tokë dhe dinakëritë e shëmtuara që godasin vetëm pronarin e tij ...”.

(*Fatir*, 43)

Në shikim të parë nuk ka çështje kontestuese, por pas një sqarimi të plotë kuptohet se ka humbur estetika e ajetit, ka humbur syri i ajetit, ajo çka është kryesore dhe primare, ajo çka e kompletton ajetin:

“(Janë larguar pse ata kanë dëshiruar) Me qenë udhëheqës (sundimtarë) mendjemëdhenj në tokë dhe për të bërë dredhi të këqija. Nuk goditet me dredhinë e keqe, vetëm kush e ka bërë atë”.



GABIM I RADHITJES SË FJALËVE

Duhet ditur çdo përkthyes se radhitja e fjalëve në (ajet) fjali është mrekulli kur'anore dhe caktim apo renditje e Zotit të Lartmadhëruar, e jo zgjidhje e Muhamedit a.s., siç është rasti me hadithin. Kështu që kur i ka zbritur Kur'ani Muhamedit a.s. i ka zbritur ndonjëherë një sure, ndonjëherë një ajet, ndonjëherë një pjesë e ajetit, e kur i ka zbritur Muhamedit a.s. ndonjë pjesë e ajetit ka urdhëruar për ta vendosur në vendin e duhur, aty ku është urdhëruar për ta vendosur.

Mirëpo, gjatë përkthimit paraqitet domosdoshmëria e ndryshimit të renditjes së fjalëve në (ajet) fjali. E edhe gjatë komentimit të Kur'anit në gjuhën arabe komentuesit, për të

shpjeguar domethëniet e ajeteve, e lejojnë që të
gjendet alternativë për të interpretuar fjalën, për
t'i bërë më të qarta fjalët dhe thellësinë e ajeteve të
Kur'anit Fisnik.



وَادْخُلُوا الْبَابَ سُجَّدًا وَقُولُوا حِطَّةً
وَقُولُوا حِطَّةً وَادْخُلُوا الْبَابَ سُجَّدًا

Hasan Nahi ajetin 58 të suretul-Bekare e ka përkthyer kështu:

“... duke hyrë në qytet përuluni dhe thoni: “Falna!”

Ndërsa e njëjta ngjarje në Kur'anin Fisnik shpjegohet në ajetin 161 të Suretul-Earafë ku është e përkthyer:

وَقُولُوا حِطَّةً وَادْخُلُوا الْبَابَ سُجَّدًا

“... dhe thuani: “Falna mëkatet! Dhe hyni të përulur në derë; ...”

Përkthimi i kësaj ngjarjeje, e cila në gjuhën arabe, në Kur'anin fisnik, në një ajet në renditje është hyrja në qytet pastaj “kërkimi i faljes”, ndërsa në ajetin tjetër është “kërkimi i faljes” pastaj “hyrja në qytet. Nëse përkthyesi për shkak të estetikës në gjuhën e tij e bën ndryshimin e renditjes në ndonjërin prej këtyre dy ajeteve, ai vetëm ka interpretuar dhe nuk ka bërë ndonjë gabim të palejuar, por më mirë është për t’iu përmbajtur renditjes në secilin ajet. Ndërsa në ajetet e tjera nuk është kështu, ai patjetër duhet t’i përmbahet radhitjes së fjalëve, sepse mosradhitja e fjalëve mund të mos e tregojë qëllim kryesor të ajetit, siç është në shumë raste, të cilat do t’i shpjegojmë më vonë.

(Jasinë, 20) ... وَجَاءَ مِنْ أَقْصَى الْمَدِينَةِ رَجُلٌ ...
 (El-Kasas, 20) ... وَجَاءَ رَجُلٌ مِنْ أَقْصَى الْمَدِينَةِ ...

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Dhe erdh **një njeri** me vrap nga skaji **i qytetit** ...”. (Jasinë, 20)

“Dhe nga skaji **i qytetit** erdhi vrap **një njeri** ...”. (El-Kasas, 20)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Dhe prej skajit më të largët **të qytetit** erdhi **një njeri** ...”. (Jasinë, 20)

“Dhe erdhi **një njeri** që ngutej nga ana më e largët **e qytetit** ...”.

(El-Kasas, 20)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“E erdh **një njeri** nga periferia e **qytetit** ...”. (Jasinë, 20)

“Dhe **një njeri** erdh nga skaji **i qytetit** ...”. (El-Kasas, 20)

Qytet - njeri

Njeri - qytet

As në gramatikë, as në radhitjen e fjalëve në fjali nuk e prish domethënien nëse themi “nga qyteti një njeri” apo anasjelltas “një njeri nga qyteti”. Mirëpo, ajetet kur’anore nuk lejohet në gjuhën arabe të ndryshojnë radhitjen e fjalëve “rexhulun min eksal medineti – një njeri nga fundi i qytetit” dhe “min eksal medineti rexhulun – nga fundi i qytetit një njeri”, pse në ajetin e suret Jasinë rrahet problematika e qytetit, qyteti është dashur të besojnë, prandaj është vendosur qyteti e pastaj njeriu në fjali. Ndërsa, ajeti në suretul-Kasas ka pasur të bëjë me njeriun që befasisht i vjen Musaut për t’i paralajmëruar, sepse Musa ka qenë dashur të ikë para se ta hetojë qyteti. Pra

vendosja në ajët tregon njeriun prej të cilit e merr Musau lajmin, para se ta hetojë qyteti.

وَالسَّارِقُ وَالسَّارِقَةُ فَاقْطَعُوا أَيْدِيَهُمَا ...

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Vjedhësit e vjedhëses preniu duart ...”

(El-Maide, 38)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Vjedhësit dhe vjedhëses preniu duart ...”.

(El-Maide, 38)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Vjedhësit dhe vjedhëses këputjani duart e tyre ...”.

(El-Maide, 38)

الرَّانِيَةُ وَالرَّانِي فَاجْلِدُوا كُلَّ وَاحِدٍ مِّنْهُمَا مِائَةَ جَلْدَةٍ ...

Përkthyesit kanë renditur fjalët:

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Laviren dhe lavirin t’i rrahni secilin prej tyre me nga njëqind të rëna ...”.

(En-Nur, 2)

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Laviren dhe lavirin, çdonjërin, rrihne me njëqind të rëna ...”.

(En-Nur, 2)

... وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ لَذَهَبَ بِسَمْعِهِمْ وَأَبْصَارِهِمْ ...

Këtë ajet Isa Dawood e ka përkthyer kështu:

“If Allah pleased, He could take away their sight and hearing”

“Po të donte Allahu, Ai do t’ua merrte atyre shikimin dhe dëgjimin”.

Në Kur’an Zoti i Lartmadhëruar e ka përmendur dëgjimin e pastaj shikimin, ndërsa në përkthim del e kundërta.

THE KORAN A NEW TRANSLATION

BY: N.J. DAWOOD

... وَلَا تَقْتُلُوا أَوْلَادَكُمْ مِنْ إِمْلَاقٍ نَحْنُ نَرْزُقُكُمْ وَإِيَّاهُمْ ...

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Mos i mbytni fëmijët tuaj për shkak të skamjes

– Ne ju ushqejmë **edhe juve** edhe **ata**”.

(El-Enamë, 151)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Mos i mbytni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë

Ne ju ushqejmë **juve** dhe **ata**”.

(El-Enamë, 151)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Mos vritni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë

Ne ju ushqejmë **ju** dhe **ata**”.

(El-Enamë, 151)

Këtë ajet I.M. Rodwell e ka përkthyer:

“For **them** and for **you** willwe provide”

“Për **ata** dhe për **ju** Ne ju sigurojmë furnizim”.

Pra, ka gabuar në renditjen e përemrave.

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Ju mos i mbytni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë, se Ne jua sigurojmë furnizimin atyre dhe juve”.

Rasti i parë është kur kriza ekonomike dhe varfëria është aktuale, për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar thotë se ne ju ushqejmë juve, por edhe pasardhësit tuaj.

Ndërsa, rasti i dytë në suretu El-Isra, ajeti 31 tregon kur nuk ka qenë kriza ekonomike apo varfëria prezente dhe i kanë mbytur fëmijët duke menduar se nataliteti apo fëmijët femëra do të ndikojnë në të ardhmen për të kaluar prej gjendjes së mirë ekonomike në varfëri, për këtë arsye në këtë ajet thotë:

“Mos i mbytni fëmijët tuaj nga frika se do të varfëroheni se ne ata do t’i furnizojmë (në të ardhmen) ashtu siç ju furnizojmë juve tani”.

“For **them** and for **you** will we provide”

“Për **ata** dhe për **ju** Ne ju sigurojmë furnizim”.



GABIMET TEKNIKE



GABIME TEKNIKE NUK LEJOHEN

Në përkthimin e Kur'anit të Feti Mehdiut, botues i së cilës është Kryesia e Bashkësisë Islame në vitin 1985, në suren LXXV – Kijameti, faqe 770 shkruan kështu:

- 23. **“E disa fytyra atë ditë do të jenë të ngrysur.**
- 24. **Zotin e vet do ta shikojnë.**
- 25. **Duke menduar se do t'i godisë fatkeqësi”.**

Këtu është bërë gabimi teknik (kompjuterik), gabim i cili asnjëherë nuk lejohet. Po si mund të lejohet të botohet një përkthim i Kur'anit, përkthim i cili të bën të kuptosh se atë ditë fytyrat e ngrysur Zotin e vet do ta shikojnë, ndërsa është e vërtetë se në ajetet e tjera tregohet se pabesimtarët nuk do ta shohin Zotin. Po pastaj vazhdon ajeti tjetër, i cili nëse ndërliidhet me ajetin paraprak, del se Zotin e vet do ta shikojnë **25. “Duke menduar se do t'i godisë fatkeqësi”**. Pra, edhe pse është bërë një gabim teknik, pastaj ka ndodhur edhe gabimi i dytë, të cilët janë në kundërshtim me atë që e thotë Kur'ani. Kështu që renditja e ajeteve në këtë rast është çrregulluar në tërësi dhe ka dalë anomali.

Tash do t'i rendisim ajetet dy nga dy për të kuptuar atë që e thotë Kur'ani, ashtu si e ka përkthyer Feti Mehdiu:

- 22. **Atë ditë disa fytyra do të shkëlqejnë.**
- 23. **Zotin e vet do ta shikojnë.**
- 24. **“E disa fytyra atë ditë do të jenë të ngrysur.**
- 25. **Duke menduar se do t'i godisë fatkeqësi”.**

Ja pra renditja e ajeteve i rregullon domethëniet e ajeteve.

Në të njëjtin përkthim është edhe një fletë ku tregohen përmirësimet e gabimeve, por në fund tregohet vetëm vërejtja e faqes 64, ku pas ajetit 214 duhet të pasojë ajeti 215.

Të kalojmë prapë në përkthimin e Kur'anit të Feti Mehdiut, ribotim e titulluar KUR'ANI DHE HIJA E TIJ SHQIP, ribotues i së cilës është "Logos-A", Shkup IHH, Stamboll 1999.

Prapë i njëjti gabim, prapë gabimi teknik i palejuar.


Në faqen 577 është si vijon:

23. "E disa fytyra atë ditë do të jenë të ngrysur.

24. Zotin e vet do ta shikojnë.

25. Duke menduar se do t'i godisë fatkeqësi".

Në faqen 577 (teksti në gjuhën arabe, numri i ajeteve nuk përputhet me këto ajete). Siç shihet edhe me rastin e ribotimit, gabimi i parë teknik nuk është vërejtur fare edhe është përsëritur. E kisha lutur përkthyesin me sinqeritet të thellë që ky gabim teknik në ribotimet e tjera patjetër të përmirësohet se përndryshe edhe nëse e titullojmë me "Kur'ani dhe hija e tij Shqip", nuk do të ishte kjo mënyrë as hije. Besoj se përkthyesi do ta marrë me seriozitet arsyetimin në ribotimet e tij të ardhshme.



FQ. 577 SURETU KIJAME – FETI MEHDIU

20 Por ani! Ju e dashuroni këtë jetë të kalueshme,
21 Dhe e leni pas shpine atë tjetrën.
22 Atë ditë disa fytyra do të shkëlqejnë
23 E disa fytyra atë ditë do të jenë të ngrysur.
24 Zotin e vet do ta shikojnë,
25 Duke menduar se do t'i godis fatkeqësi.

Faqe 770 Sureja LXXV

EL-VAKF VEL IBDAË TË NDALURIT (e rreshtit) DHE TË FILLUARIT (e rreshtit)

Allahu i Lartmadhëruar ka garantuar ruajtjen e Kura'anit Fisnik nga çdo lajthitje, ndryshim të fjalës, ndryshim të formës, ndryshim të tekstit, ndryshim të kuptimit. Për këtë arsye në kohën e Othmanit r.a. është shkruar mus-hafî (teksti kur'anor i mus-hafit) që edhe sot quhet faqosja apo dizajni apo me fjalë të tjera të shkruarit e mus-hafit me shkrimin e Othmanit r.a., që do të thotë faqet e njëjta, rreshtat e njëjtë fillimi i sureve i njëjtë, përfundimi i sureve i njëjtë, fillimi i rreshtit i njëjtë, përfundimi i rreshtit i njëjtë dhe çdo gjë nëpërmjet rreshtave e njëjtë. Pa dyshim se kjo e ka arsyen dhe qëllimin,

por njëri prej qëllimeve kryesore që janë kujdesur dijetarët-shkruesit e Kur'anit ka qenë (**vakfi** vel **ibda'i**) fillimi i rreshtit dhe përfundimi i rreshtit, fillimi i fjalës dhe përfundimi i fjalës. Mirëpo, edhe lexuesit e Kur'anit (Kurratë) rëndësinë më të madhe ia kanë kushtuar shkencës së përfundimit të leximit në mes të ajetit (vakfit) dhe rifillimin e ajetit prej mesit të ajetit (ibdaë).

Disa dijetarë këtë shkencë e kanë graduuar në shkallën obligative (Vaxhib).

Kur është pyetur Aliu r.a. për ajetin kur'anor:

وَرَتَّلِ الْقُرْآنَ تَرْتِيلًا

“Dhe lexo (recito) Kur'anin (me vëmendje të posaçme) me recitim preciz”

(El-Muzemil, 4)

është përgjigjur: *TERTILË do të thotë shqiptimi i plotë i çdo shkronje dhe të njohurit e ndaljes (gjatë këndimit të Kur'anit).*

Ibni Omeri r.a. ka thënë: Kur kemi jetuar në kohën tonë, çdo njëri i cili besonte para se të zbriste ndonjë pjesë e Kur'anit, kur i zbriste ndonjë sure Muhamedit a.s., prej tij e kuptonim çka është e lejuar, çka është e ndaluar, çka është urdhër dhe çka është vërejtje, dhe në cilën pjesë të ajetit duhej të ndaleshim.

(Ahrexhehu Taberaniju fil Evsat dhe Hakimi, Bejhekiu thotë: Senedi është Sahihë)

Ahmedi në Musnedin e tij, po ashtu edhe Muslimi në Sahihun e tij transmetojnë hadithin e Adi bin Hatemit se dy njerëz kanë shkuar te Muhamedi a.s. dhe njëri prej tyre ka mbajtur një fjalim ku ka thënë ajetin: **“Kush respekton Allahun dhe të Dërguarin e Tij ai veç është i udhëzuar edhe kush s'i respekton (kundërshton)”**, në këtë pjesë të fjalisë është ndalur dhe nuk e ka vazhduar pjesën tjetër **“dhe kush s'i respekton (kundërshton) ai veç ka humbur”**. Muhamedi a.s. ia ka tërhequr vërejtjen duke i thënë:

“Ngrihu, po sa ligjërues i keq jeni! Dhe përmirësoje:

“Kush dëgjon Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ai veç është i udhëzuar, e kush s'i respekton ai veç ka humbur”.

Ne do t'i tregojmë disa raste ku ka të bëjë me **të ndalurit** (ndërprerjen e përkthimit) **e ajetit keq** (El-vakf kabijh), ndërsa ku për shkak të kalimit prej rreshtit në rresht ku është **ndërprerja e plotë** (Vakf tam), apo **ndërprerja e mjaftueshme** (El-vakf kafi) si dhe **ndërprerja e mirë** (El-vakf hasen) e ajetit. Kuptohet në përkthim nuk kemi çka të flasim dhe po sqarojmë se rregullat e dijetarëve që kanë të bëjnë me leximin e Kur'anit janë po të njëjta edhe me shkrimin e Kur'anit. Pra nuk mund të arsyetohemi me atë se edhe pse është ndërprerë fjala apo fjalia në të shkruar lexuesi nuk e ndërpret në të

lexuar, pse pa marrë parasysh se lexuesi a i lexon pa ndërprerje, nuk lejohet që të qëndrojnë në të shkruar ajetet **e ndërprera keq** (e Vakf kabijh).

Vakf (ndalja në të lexuar) quhet ndërprerja e fjalës përkohësisht, për të marrë frymë (pauzuar) me qëllim të vazhdimit të leximit.

Vakfi (ndalja e të lexuarit) bëhet në fund të ajetit dhe në mes të ajetit, ndërsa *nuk lejohet në mes të fjalës*.

Nëse shikojmë këtë, atëherë ashtu siç nuk lejohet ndalja (vakfi) në të lexuar, nuk lejohet ndarja e fjalës edhe në të shkruar, sidomos sa i takon fjalëve Allah, Muahmed, i Dërguar, Kur'an. Ndërsa, ne do të shohim se edhe në këtë drejtim kanë gabuar përkthyesit, respektivisht botuesit e përkthimeve.

Ne do t'i tregojmë ku është bërë vakfi (ndalja), ndërprerja apo përgjysmimi i fjalëve dhe fjalive e cila është e ndaluar në të lexuar, sepse ndërprerja e ajetit që është e lejuar në të lexuar, lejohet ndërprerja apo përgjysmimi i ajetit edhe në të shkruar, respektivisht në përkthim.

FETI MEHDIU: KUR'AN-i,

Botues Kryesia e Bashkësisë Islame, Prishtinë 1985

Në këtë botim shohim se janë të ndërprera, me fjalë të tjera janë të përgjysmuara fjalët: Allahu, Muahmed, Kur'an, i Dërguar, emrat e pejgamberëve të tjerë, e shumë fjalë të tjera. Ne kemi theksuar pa marrë parasysh lexuesi e lexon të pandërprerë fjalën, edhe pse e lexon të pandërprerë këto fjalë nuk lejohen të shkruhen të ndërprera apo të përgjysmuara për shkak të kalimit prej një rreshti në rreshtin tjetër, apo prej një faqeje në faqen tjetër.

Në faqen 51, suretu El-Bekare, në ajetin e 137-të është përgjysmuar fjala e Allahut në të shkruar.

Në këtë botim emri "Allah" është përgjysmuar dhjetra herë.

Në faqen 83, suretu Ali Imran, ajeti 15 është përgjysmuar fjala e Zotit në të shkruar.

Edhe në suretu El-Fatih, ajeti i 34-të, faqe 570 është përgjysmuar fjala e Zotit.

Në faqen 141, suretu En-Nisa, ajeti i 152-të është përgjysmuar fjala "të dërguarve" në të shkruar.

Në faqe 363, suretu El-Israë, ajeti 4 është përgjysmuar fjala "libër" në të shkruar.


Faqe 594, sureja En-Nexhm, ajeti 36 është përgjysmuar emri i pejgamberit Musa a.s.

Poashtu edhe emrat e pejgamberëve të tjerë janë përgjysmuar. Në faqen 793, suretu El-Inshikak, ajeti i 34-të është nda fjala mosbesim, për shkak të kalimit prej një rreshti në rreshtin tjetër.

Poashtu ka ndodhur në faqen 473, suretu El-Furkan, ajeti i 37-të.

Ashtu siç është e ndaluar përgjysmimi i fjalëve është i ndaluar edhe përgjysmimi i fjalive, ku pjesëza mohuese mbetet në një rresht, ndërsa pjesa pohuese në rreshtin tjetër, ose në faqen tjetër.

Në faqen 430 sureja e 21të – El-Enbija, ajeti i 87-të është ndarë fjalia për shkak të kalimit prej rreshtit në rresht tjetër fjalia “**Nuk ka zot përveç Teje**”. Kjo nuk guxon të ndahet as në të shqiptuar, as në të lexuar e as në të shkruar.



Sureja XXI , fq. 430

Faqe 65, sureja e 3-të - Ali Imran, ajeti i 132-të është përgjysmuar fjala **mosbesimtari**.

Faqe 180, sureja e 8-t / Afal, ajeti i 37-të është përgjysmuar fjala **xhehenem**.

Faqe 208, sureja e 10-të / Junus, ajeti i-të 9 është përgjysmuar fjala **xhennet**.

SHERIF AHMETI, botues Islamik Relief, shtypshkronja “El-Ahram në Kaljub”, Kajro, 1994.

Në këtë botim janë bërë përgjysmime të fjalëve, përgjysmime të fjalive prej një rreshti në rreshtin tjetër dhe përgjysmime prej një liste në listën tjetër, dhe prej një faqeje në faqen tjetër.

Faqe 33, suretu El-Bekare, ajeti i 99-të është përgjysmuar fjala **Muhamed**.

Faqe 67, suretu El-Bekare, ajeti i 261-të, duke kaluar prej faqes 67 në faqen 68 është përgjysmuar emri i **Allahut**.

Faqe 596, suretu Jasinë, ajeti i 58-të është përgjysmuar emri i **Zotit**.

Faqe 586, suretu Fatir, ajeti i 23-të është përgjysmuar fjala **“i dërguar”**.

Faqe 78, suretu Ali Imran, ajeti i 18-të është shkruar fjalia

“Nuk ka zot, përveç Tij Fuqplotit e të Urtit”.

Presja nuk qëndron te përkthimet e tjera, nëse është bërë gabim teknik, kjo nuk lejohet, pse është shkruar fjalia mohuese për ekzistimin e Zotit dhe atë e kanë mohuar engjujt dhe dijetarët.

Faqe 334-335, suretu Ibrahim, ajeti i 47-të është përgjysmuar fjala e **Allahut**.

Faqe 39, suretu El-Bekare, ajeti i 34-të kalim prej një liste në listën tjetër ku fjalja përgjysmohet “Prandaj ju nuk jeni përgjegjës për atë që vepruan ata”.

Kjo nuk lejohet të përgjysmohet as në të shqiptuar as në të lexuar, as në të shkruar qoftë edhe në përkthim të Kur’anit.

Nuk lejohet as kalimi prej një faqeje në faqen tjetër, siç është bërë kalimi prej faqes 44 në faqen 45, ku del anomali në pjesë të ajetit 163 të suretu El-Bekare



Faqe 92, suretu Ali Imran, ajeti i 99-të kalimi prej një liste në listën tjetër është përgjysmuar fjalja “Veprimi juaj nuk mund t’i shmanget mbikëqyrjes së Allahut”.

H. Sherif Ahmeti “Kur’an-i Përkthim me komentim në gjuhën shqipe”, viti 1413 Hixhrij

Në këtë ribotim nuk shohim përgjysmim të fjalëve, por përgjysmim të fjalive, gjë që është e ndaluar edhe në të shkruar të përgjysmohen këto fjali:

Faqe 65 suretu El-Bekare, ajeti i 229-të, është përgjysmuar fjalja prej kalimit të një liste në listën tjetër:

“sepse kush i tejkalon dispozitat e Allahut, pikërisht të tillët janë zullumqarët”.

Faqe 83, suretu Ali Imran, ajeti i 180-të është përgjysmuar fjalja prej kalimit në një rresht në rreshtin tjetër:

“Allahu vërtetoi se nuk ka Zot tjetër përveç Tij, ...”.

18. Allahu vërtetoi se nuk ka zot tjetër përveç Tij, e dëshmuar edhe engjëjt e dijetarët, dhe se Ai është zbatues i drejtësisë. Nuk ka zot, përveç Tij Fuqplotit e të Urtit.

Faqe 92, suret Ali Imran, ajeti 85 është përgjysmuar fjalia prej kalimit të një liste në listën tjetër:

“E, e kush kërkon fe tjetër përveç fesë islame, atij kurrresi nuk i pranohet”.

Faqe 122, suret En-Nisa, ajeti i 76-të është përgjysmuar fjalia: “luftoni pra miqtë e djallit”.

Faqe 155, suret El-Maide, ajeti i 89-të është përgjysmuar fjalia prej kalimit të një liste në listën tjetër ku del se “Allahu nuk ju merr në përgjegjësi” pastaj në listën tjetër “për betimet e juaja të paqëllimta”.

Faqe 252, suret Junus, ajeti i 54-të është përgjysmuar fjalia “dhe nuk u bëhet e padrejtë” për shkak të kalimit prej një flete në fletën tjetër.

Faqe 468, suret Err-Rrum, ajeti i 52-të është përgjysmuar fjalia për shkak të kalimit prej një liste në listën tjetër:

“mund t’i bësh të dëgjojnë të vdekurit”.

Prof. Hasan I. Nahi “Kur’ani i Madhëruar”, Prishtinë, 1988

Në këtë botim janë përgjysmuar edhe fjalët edhe fjalitë, të cilat fjalë dhe fjali janë të ndaluara të ndahen si në shqiptim, në të lexuar ashtu edhe në të shkruar.

Faqe 11, sureja 2 – El-Bekare, ajeti i 68-të është përgjysmuar fjala e Zotit në dy rreshta:

“ata thanë: Lutju Zotit Tënd”.

Faqe 123, suretu El-Maide, ajeti i 83-të është përgjysmuar fjala “Pejgamberit”.

Faqe 320, sureja 20 – Taha, ajeti i 99-të është përgjysmuar fjala “Muhamed”.

Faqe 580, sureja e 75-të – El-Kijameh është përgjysmuar fjala “Kur’anin”.

Faqe 321, sureja e 20-të – Taha, ajeti i 114-të është përgjysmuar fjalia për shkak të kalimit prej një rreshti në rreshtin tjetër:

“Dhe mos nxito në të lexuarit të Kur’anit”.

114. I Lartë është Perëndia — Sundues — i Vërtetë! Dhe, mos nxito në të lexuarit e Kur’anit (o Muhammed!) para se të përfun-

Sureja 20 (Taha), fq.321

Faqe 106, sureja e 4-të – En-Nisa, ajeti 171 është përgjysmuar fjalia:
“O ithtar të librit mos e kaloni kufirin në besimin tuaj”.

171. O ithtarët e Librit! — mos e kaloni kufirin në besimin tuaj dhe për Perëndinë thoni vetëm të vërtetën! Mesihu — Isai, i biri i Merjemit, është vetëm Profet

Sureja 6 (Nisa), fq. 106

**“Shpjegimi i kuptimeve të Kur’anit të lartë në gjuhën shqipe”,
përkthyer nga një grup përkthyesish pranë Darusselam Shtëpia
Botuese dhe Shpërndarëse**

Faqe 126, sureja 4 – En-Nisa (Gratë), pjesa e ajetit 199, e cila është vazhdimësi nga faqe 125 thuhet:

“Shesin Vargjet e Allahut për një çmim të vogël”,
ndërsa pjesa mohuese e fjalës ka mbetur në faqen 125.

199. Dhe vërtet ka edhe nga popujt e Librave të Parë (Çifutë e Kristianë) prej atyre të cilët besojnë në Allahun dhe në atë që u është shpallur juve dhe në atë që u është shpallur atyre më parë, duke iu nënsh-truar plotësisht Allahut dhe të cilët nuk i

Sure 35. El-Fatir, fq. 632

Sure 4. An-Nisa' (Gratë) Pjesa 4 **126** الجزء ٤

shesin Vargjet e Allahut për një çmim të vogël. Për këta shpërblimi është me Zotin e tyre. Vërtet, Allahu është më i Shpejti në llogari.

Sure 35. El-Fatir, fq. 632

Kjo është ndërprerje e keqe ose e ndaluar (Vakf Kabihe) në të lexuar, në të shqiptuar, por edhe në të shkruar, qoftë edhe në përkthim.

Faqe 56, ajeti i 197-të, sureja 2 – El-Bekareh është përgjysmuar fjala hax-hin.

Faqe 575, sureja 29 – El-Ankebut është përgjysmuar fjala Mele-kët, kështu që prej faqes 574 ka dalë gjysma e fjalës në faqen 575.

Faqe 631, sureja 35 – El-Fatir, ajeti 36 është përgjysmuar fjala e **All-llahut**, prej faqes 631 ka dalë gjysma e fjalës në faqen 632.

35. "I Cili nga Mirësia e Përkujtimi i Tij na ka strehuar ne në një shtëpi që do të rrojë pambarim; atje as mundim nuk do të na prekë, as lodhje nuk do të ndjejmë."

36. Por ata që mohuan (Njësinë e Alla-

Sure 35. El-Fatir, fq. 631

hut, Islamin), për ta do të jetë Zjarri i Xhehenemit. Ai nuk do të ketë forcë të plotë mbytëse mbi ta saqë të vdesin, as nuk do të lehtësohet mbi ta ndëshkimi i tij. Kësisoj Ne shpërblejmë çdo mosbesimtar!


Sure 35. El-Fatir, fq. 632

Faqe 799, sureja 60 – El-Mumtehineh është përgjysmuar fjala e **Muhamedit** a.s. duke kaluar prej një rreshti në rresht tjetër.



NUK JANË GABIME
POR MË MIRË ALTERNATIVA

TË PËRKTHIMIT MË TË PËRSHTATSHËM



مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“**Sunduesin** e ditës së gjykimit”.

(El-Fatiha, 3)

Sherif Ahmeti e përkthen kështu:

“**Sunduesit** në ditën e gjykimit”.

(El-Fatiha, 3)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“**Sunduesit** të ditës së gjykimit”.

(El-Fatiha, 3)

Edhe pse sipas rregullave të gramatikës së gjuhës shqipe nuk ka asnjë gabim, dhe rregullat e gjuhës shqipe e lejojnë një formulim të tillë, por nëse e shikojmë përkthimin e dytë, shohim se fjala “Maliki jevmid-dinë” është përkthyer “**Sunduesit** në ditën e gjykimit”, që do të thotë se kuptohet me kuptim të dyfishtë - edhe në njëjës, edhe në shumës. Kurse dihet posaçërisht në këtë ajet Zoti i Madhëruar ka përdorë مَالِكِ “Malik” në njëjës – **Sundimtar** i vetëm absolut, ndërsa përkthimi “Sunduesit” e ka edhe domethënien e shumësit po ashtu edhe domethënien e njëjësit. Ka mund të përkthehet

“**Sundimtarit** në ditën e gjykimit”, përkthim ky që nuk do të lejonte kuptimin e alternativës së shumësit.

وَأَتُوا الْيَتَامَىٰ أَمْوَالَهُمْ ...

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Kurse bonjakëve dorëzonu pasurinë e tyre, ...”.

(En-Nisa, 2)

Sherif Ahmeti e përkthen kështu:

“Bonjakëve (jetimëve) jepnu (**kur të rriten**) pasurinë e tyre”.

(En-Nisa, 2)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Epni pasurinë bonjakëve (**kur të bëhen të aftë të vetvetes**), ...”.

(En-Nisa, 2)

Në shariatën islam jetim quhet fëmija, të cilit i ka vdekur babai para se të arrijë moshën e pjekurisë-bulugut, por nëse i vdes nëna fëmijës, ai nuk quhet jetim. Ndërsa në leksikologjinë e gjuhës shqipe jetim quhet edhe fëmija të cilit i ka vdekur nëna. Kështu nevojitet që në përkthim, ose të gjendet alternativa e përshtatshme ose të sqarohet.

Nga përkthyesi i parë kuptohet se bonjakëve u dorëzohet pasuria e tyre çka në të vërtetë nuk është ashtu! Përkundrazi, bonjakëve nuk u dorëzohet pasuria e tyre. Bëhet pyetja pse? Fëmijës të cilit i vdes babai para bulugut

(pjekurisë), nuk i dorëzohet pasuria fare, sepse para bulugut nuk ka të drejtë pronësie, ndërsa kur të rritet dhe arrin moshën e pjekurisë, prej atij çasti më nuk quhet jetim, por njeri i aftë dhe i pavarur, e kur të pavarësohet, atëherë i dorëzohet pasuria e tij. Prandaj, edhe kur të përkthehet duhet të përkthehet ashtu si komentohet Kur’ani në gjuhën arabe, duke u bazuar në sintaksën e gjuhës arabe:

“**Ish jetimëve** jepuni pasurinë e tyre”.

Për këtë arsye përkthyesi i dytë dhe i tretë i kanë futur në kllapa “kur të rriten” dhe “kur të bëhen të aftë të vetvetes”.

قُمِ النَّيْلَ إِلَّا قَلِيلًا

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“**Ngritu natën**, përveç një pjese të vogël”.

(*El-Muzzemmil, 2*)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“**Ngrihu për falje natën**, përveç një pjese të vogël të saj”.

(*El-Muzzemmil, 2*)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“**Zgjohu (lutju)** Perëndisë natën, pos të paktën”.

(*El-Muzzemmil, 2*)

Fjala قُمِ “kum” në këtë ajet ka të bëjë me pozitën më të vështirë dhe më të rëndë gjatë namazit natën, e ajo pozitë është qëndrimi në këmbë. Pra stilistika e Kur’anit tregon një specifikë të posaçme dhe të rëndësishme gjatë faljes së namazit në përgjithësi, e në veçanti faljen e namazit natën, e ajo specifikë është pozita e qëndrimit në këmbë në namaz. Për këtë arsye përkthyesi i dytë shërbehet me dy fjalë “Ngrihu për falje natën”; përkthyesi i tretë i përdorë kllapat “Zgjohu (lutju) Perëndisë”. Ky përkthyes fjalën primare e ka futur në kllapa, e atë sekondare jashtë kllapave, ndërsa më mirë do të ishte e kundërta.

الَّذِينَ هُمْ عَنْ صَلَاتِهِمْ سَاهُونَ

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Por të cilët janë indiferent **në** namazin e tyre”.

(El-Maunë, 5)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“të cilët **ndaj** namazit të tyre janë të pakujdesshëm”.

(El-Maunë, 5)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Mjerë për ata të cilët kur falen janë të pakujdesshëm (të harrueshëm)”.

(El-Maunë, 5)

I.M. Rodwell e ka përkthyer kështu:

“But **in** their prayer are careless”.

“Por **në** namazin e tyre janë të pakujdesshëm”.

(El-Maunë, 5)

Pjesëza عَنْ “an” që ka domethënien “ndaj”, është e vendosur për ata që përtojnë, nuk kujdesen dhe i lëshojnë kohët e namazit pa kurrfarë arsye. Prandaj, përkthyesi duhet ta ketë parasysh se Kur’ani nuk e ka përdorur pjesëzën فِي “fi” që ka domethënien “në” (në gjuhën angleze “in”), e kjo

është bërë për arsye që të bëhet e qartë për çdo lexues se fjala është për ata që nuk janë falë, e jo për ata që falen.

**DISA PËRKTHYES TË KUR'ANIT
NË GJUHËN ANGLEZE**



PËRKTHIMI I I.M. RODWELL

Ky përkthim është botuar në vitin 1861. Është ribotuar disa herë dhe quhet “THE KORAN TRANSLATION FROM THE ARABIC By: The Rev. J. M. Rodwell. Ky përkthyes bazë në përkthim nuk e ka pasur përkthimin prej gjuhës latine, por drejtpërdrejt prej tekstit arabisht.

إِذَا لَأَذُقْنَاكَ ضِعْفَ الْحَيَاةِ وَضِعْفَ الْمَمَاتِ ...

“In that case we would surely have made
“Në atë rast ne do t’ia bëjmë atë
the taste of **woe** in life and **woe** in death”
një sprovim që të jetojë jetë **të dobët**, por edhe vdekje **të dobët**”.

(El-Isra, 75)

Fjala “DAËFE” do të thotë **i dobët, më i lehtë**.

Fjala “DIËFE” do të thotë **i dyfishtë**.

Përkthyesi I.M. RODWELL nuk e ka kuptuar fjalë “**Diëfe**” e cila e ka domethënien e “**dyfishtë**”, por e ka kuptuar krejt të kundërtën “**Daëf – i**

dobët”, për këtë arsye edhe ka gabuar kur e ka përkthyer jo “**dy jetra dhe dy vdekje**”, por “**dobësi në jetë dhe dobësi në vdekje**”

... وَلَا تَقْتُلُوا أَوْلَادَكُمْ مِنْ إِمْلَاقٍ نَحْنُ نَرْزُقُكُمْ وَإِيَّاهُمْ ...

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Mos i mbytni fëmijët tuaj për shkak të skamjes
– Ne ju ushqejmë **edhe juve** edhe **ata**”.

(El-Enamë, 151)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Mos i mbytni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë
Ne ju ushqejmë **juve** dhe **ata**”.

(El-Enamë, 151)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Mos vritni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë
Ne ju ushqejmë **ju** dhe **ata**”.

(El-Enamë, 151)

Këtë ajet I.M. Rodwell e ka përkthyer:

“For **them** and for **you** will we provide”

“Për **ata** dhe për **ju** Ne ju sigurojmë furnizim”.

Pra, ka gabuar në renditjen e përemrave.

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Ju mos i mbytni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë, se Ne ju sigurojmë furnizimin atyre dhe juve”.

Rasti i parë është kur kriza ekonomike dhe varfëria është aktuale, për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar thotë se ne ju ushqejmë juve, por edhe pasardhësit tuaj.

Ndërsa, rasti i dytë në suretu El-Isra, ajeti 31 tregon kur nuk ka qenë kriza ekonomike apo varfëria prezente dhe i kanë mbytur fëmijët duke menduar se nataliteti apo fëmijët femëra do të ndikojnë në të ardhmen për të kaluar prej gjendjes së mirë ekonomike në varfëri, për këtë arsye në këtë ajet thotë:

“Mos i mbytni fëmijët tuaj nga frika se do të varfëroheni se ne ata do t’i furnizojmë (në të ardhmen) ashtu siç ju furnizojmë juve tani”.

“For **them** and for **you** will we provide”

“Për **ata** dhe për **ju** Ne ju sigurojmë furnizim”.

وَإِذْ قُلْنَا لِلْمَلَائِكَةِ اسْجُدُوا لِآدَمَ فَسَجَدُوا إِلَّا إِبْلِيسَ ...

“And when we said to the angels, << Bow down and **worship** Adam >> then worshiped they all save Eblis ...”

“Dhe kur Ne i thamë engjujve << Përluni dhe adhurone Ademin >>, të gjithë e adhuruan përpos Iblisit”.

(El-Bekare, 34)

Fjala “sexhde” është përkthyer “**worshiped**”, që do të thotë **adhurim, lutje (ibadet)**, që përkthyesi në gjuhën angleze e kupton se Zoti iu ka thënë melaqueve që ta adhurojnë Ademin, dhe për t’iu lutur Ademit, e kjo është larg, shumë larg qëllimit të ajetit Kur’anor.

وَدُّوا لَوْ تُدْهِنُ فَيُدْهِنُونَ

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“Ata dëshirojnë që ti të **gënjeshe** e të **gënjejnë** edhe ata”.

(El-Kalem, 9)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“Ata kanë dëshirë që ti të bësh **lajka**, e që edhe ata të bëjnë **lajka**”.

(El-Kalem, 9)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“Ata dëshirojnë që ti të bësh **lëshime**, e të bëjnë (**lëshime**) edhe ata”.

(El-Kalem, 9)

I.M. Rodwell e ka përkthyer kështu:

“They desire thee to deal smoothly with them:
then would they be smooth as **oil** with thee”.

“Ata dëshirojnë që ti të bësh **lëshime** me ta
e pastaj ata të bëjnë **lëshime** dhe të rrëshqasin me ty si në **vaj**”.

(El-Kalem, 9)

Sa i përket përkthyesve në gjuhën shqipe, fjalën **دهن** “dehene” e kanë përkthyer: “gënjejnë”, “lajka” dhe “lëshime”. Ndërsa, sa i përket përkthyesit në gjuhën angleze, ai ka bërë përkthim të drejtpërdrejtë, duke menduar se në këtë rast fjala **يدهنون** “jud-hinunë” e ka domethënien e **vajit** (oil), çka nuk ka asgjë të përbashkët kjo fjalë, në këtë rast, me vajin.

PËRKTHIMI I JUSUF ALI-ut

Jusuf Ali është mysliman i Indisë. Përkthimi i tij u botua me 4 prill të vitit 1934 dhe quhet “THE HOLY QURAN” Text, Translation and Comentary By Abdullah Jusuf Ali.

وَإِذْ قُلْنَا لِلْمَلَائِكَةِ اسْجُدُوا لِآدَمَ ...

“And behold, we to the angels: **Bow down** to Adam and they **bowed down** ...”

(El-Bekare, 34)

Fjala **اركعوا** “**ruku**” (përkulje) dhe fjala **اسجدوا** “**sexhde**” (përlulje) në gjuhën arabe kanë domethënie të ndryshme, ndërsa përkthyesi në gjuhën angleze që të dy fjalët i ka përkthyer me “**bow down**”- përlulje. Pra, fjalës **ruku** nuk ia ka dhënë domethënien e vërtetë të cilën e ka. Sepse kur e ka përkthyer ajetin 77 në suretul Haxh:

... يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا “O you who believe - “O *ju besimtarë*

اركعوا **Bow down - përkuluni**

اسجدوا **Prostrate your selves ...**” - Dhe bëni **sexhde**”.

PËRKTHIMI I N.I. DAWOOD

Përkthimi i tij quhet “The Koran A new Translation By: N. J. Dawood. Është botuar në Britani në vitin 1956.

... ثُمَّ أَتَمُّوا الصِّيَامَ إِلَى اللَّيْلِ وَلَا تُبَاشِرُوهُنَّ وَأَنْتُمْ عَاكِفُونَ فِي الْمَسَاجِدِ ...

“Then resum the fast till nightfall, and do not approach them,
“Pastaj vazhdoni agjërimin deri në mbrëmje dhe mos bëni marrëdhënie me to,
but stay at your prayers in the mosques”
por vazhdoni dhe qëndroni në lutjet e juaja (namaz) në xhami”.

(El-Bekare, 187)

Ky përkthyes në gjuhën angleze nuk e ka kuptuar qëllimin e ajetit, pse nuk e ka ditur domethënien e “**iëtikafit**” në Islam. Për këtë arsye ka thënë vazhdoni dhe qëndroni në lutjet e juaja (namaz) në xhami.

... وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ لَذَهَبَ بِسَمْعِهِمْ وَأَبْصَارِهِمْ ...

“If Allah pleased, He could take away their sight and hearing”

“Po të donte Allahu, Ai do t’ua merrte atyre shikimin dhe dëgjimin”.

Në Kur'an Zoti i Lartmadhëruar e ka përmendur dëgjimin e pastaj shikimin, ndërsa në përkthim del e kundërta.

THE KORAN A NEW TRANSLATION
BY: N.J. DAWOOD

Ky përkthim është botuar në Britani në vitin 1956.

وَإِذَا سَأَلَكَ عِبَادِي عَنِّي فَإِنِّي قَرِيبٌ ...

“When My servant question you about me **tell them** I am near ...”

“Kur robërit e Mi të pyesin ty për mua, **thua ju atyre** Unë jam afër ...”.

(El-Bekare, 186)

Përkthyesi në gjuhën angleze - Jusuf Ali, në tekst të gjuhës angleze e ka përdorë fjalën “tell them” (thua ju atyre), e cila nuk ekziston në gjuhën arabe. Mirëpo, mospërdorimi i saj në gjuhën arabe e ka arsyen, qëllimin dhe vlerën, të cilës ia ka dhënë Zoti i Lartmadhëruar “Duasë”, dhe ka dëshiruar të tregojë *afërsinë në mes të Lutësit dhe Zotit edhe në tekst*:

“Të pyesin për Mua, Unë jam afër”.

Ky ajet në shumë komentime të Kur'anit është sqaruar drejt dhe është shpjeguar arsyeja e mosvendosjes së lidhëzës, apo arsyeja e mosvendosjes së pjesës së fjalisë “thua ju atyre”. E kjo nevojitet të jetë edhe gjatë përkthimeve, pra, të mos vendoset një pjesë e fjalës, e cila nuk është në gjuhën arabe në tekst dhe e ka arsyen dhe shkakun e mosvendosjes së asaj pjese të fjalisë.

PËRKTHIMI I ARTHUR J. ARBERY:

Profesor Arbery ka qenë profesor në Britani, përkthimi i tij është botuar për herë të parë në vitin 1955 dhe quhet “THE KORAN INTERPRETED By: Arthur J. Arbery”

... ثُمَّ اسْتَوَىٰ إِلَى السَّمَاءِ ...

“... Then He **lifted Himself** to heaven ...”

“... Atëherë ai **e ngriti veten e Tij në qiell** ...”

(El-Bekare, 29)

Përkthyesi në gjuhën Angleze Arthur I. Arbery fjalën استوى “isteva” e ka përkthyer “e ngriti veten e Tij në qiell”. Ndërsa fjala استوى “isteva” nuk e ka këtë domethënie, por e ka domethënien: i ka krijuar, i ka përfshirë, dhe është gjithëpërfshirës i qiellit.

Në gjuhën angleze ajeti 101 përkthehet:

“To recite our **signs** to you”

“Për t’i lexuar **shenjat-faktet** tona te ju”.

Ndërsa në suretu En-Nahl, ajeti 101 e përkthen kështu:

وَإِذَا بَدَّلْنَا آيَةً مَّكَانَ آيَةٍ

“And when we exchange a *verse* in the place

“Dhe kur Ne ndërrojmë vendet e **verseteve**

of anather verse”

me **versete** të tjera”.

... اهْبِطُوا مِصْرًا ...

“Get you down to **Egypt** ...”

“Zbritni në **Egjipt** ...”.

(El-Bekare, 61)

Përkthyesi në gjuhën angleze – Arthur J. Arberi fjalën مصر “Misr” e ka përkthyer “to Egypt”, ndërsa fjala مصر “Misr” e ka edhe domethënien e “qytetit”.

Është e njohur edhe në histori, por edhe gjatë vështrimit në ajetet e Kur’anit se beni Israilët i ka shpëtuar Musa a.s. në Egjipt, pastaj e kanë kaluar detin dhe i janë afruar qytetit “Jerusalem”, e Zoti i Lartmadhëruar u ka thënë: “Zbritni në **qytet** (Jerusalem)”, e jo zbritni në Egjipt.

Pra, ajeti në aspekt të përgjithshëm e ka domethënien “*zbritni në qytet*”, e jo në Egjipt.

... وَعَلَى الَّذِينَ يُطِيقُونَهُ فِدْيَةٌ طَعَامُ مِسْكِينٍ ...

“... and for those **who are able to fast**, a redemption

“... dhe për **ata të cilët kanë mundësi të agjërojnë** e kompensojnë

by feeding a poor man ...”
duke e ushqyer një njeri të varfër ...”.

(El-Bekare, 184)

Arthur I. Arberi gjatë përkthimit në gjuhën angleze, këtij ajeti ia ka dhënë në tërësi domethënien e kundërt. Derisa ajeti ka të bëjë për ata të cilët për shkak **të vjetërsisë** (pleqërisë), apo për shkak **të vështirësisë** nuk agjërojnë, atëherë ata e kompensojnë duke e ushqyer një të varfër. Ndërsa përkthyesi nuk e ka kuptuar këtë, por e ka përkthyer “ata të cilët kanë mundësi të agjërojnë” (Who are able to fast) e kompensojnë duke e ushqyer një njeri të varfër. Fjala “Taka” nuk përkthehet “kanë mundësi”, por “nuk kanë mundësi”, me fjalë të tjera janë të paafte për të agjëruar.

PËRKTHIMI I MUHAMED MARMADUKE PICTH THALL-it:

Ky përkthyes anglez ka jetuar një kohë në Indi, aty e ka pranuar islamin dhe e ka përkthyer Kur’anin, i cili është quajtur “THE MEANING OF THE GLORIOUS KORAN” By Mohamed Marmaduke Pichthall.

Botimi i parë ka qenë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pastaj është ribotuar 13 herë.

Në botimin e parë të tij ka deklaruar se botimi i tij është botimi i parë i përkthimit të Kur’anit në gjuhën angleze nga anglezi, i cili e ka pranuar islamin.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَقُولُوا رَاعِنَا وَقُولُوا انظُرْنَا وَاسْمَعُوا ...

“O you who believe, say not, unto the prophet

“O ju të cilët keni besuar mos i thuani të dërguarit

“listen to us” but say “look upon us” and be you Listeners ...”

“na dëgjo neve”, por thuani “shiko mbi ne” dhe bëhuni të dëgjueshëm ...”

(El-Bekare, 104)

Feti Mehdiu e ka përkthyer kështu:

“O besimtarë, mos thuani fjalën “raina” por thuani “undhurna” dhe dëgjoni ...”

(El-Bekare, 104)

Sherif Ahmeti e ka përkthyer kështu:

“O ju që keni besuar mos thuani: “Raina” por thuani “Undhurna” dhe respektoni ...!”

(El-Bekare, 104)

Hasan Nahi e ka përkthyer kështu:

“O besimtarë mos thuani “Raina”, por thuani “Yndhurna” – shikona neve dhe dëgjoni ...”

(El-Bekare, 104)

Dy fjalët رَاٰنَا “Raina” dhe اُنْظُرْنَا “Undhurna” të cilat gjinden në këtë ajet të Kur’anit, dijetarët islamë i kanë interpretuar, i kanë komentuar dhe i kanë shpjeguar, mirëpo prapëseprapë fjalët “Raina” dhe “Undhurna” janë fjalë të papërkthyeshme, dhe këtu, me të drejtë, të tre përkthyesit kanë vepruar kështu, ndërsa përkthyesi në gjuhën angleze është munduar për t’i përkthyer këto dy fjalë, por nuk ia ka arritur qëllimit të kërkuar.

Në përkthimin e ajetit të 18-të të suretu El-Bekare, shohim:

صُمُّ بُكْمٌ عُمًى فَهُمْ لَا يَرْجِعُونَ

Në këtë ajet përkthyesit në gjuhën shqipe e kanë kuptuar qëllimin e “Faut sebebije” – e lidhëzës së shkakut. Mirëpo, përkthyesi në gjuhën angleze e ka përkthyer me “**dhe**”:

“Deaf, dumb und blind, **and** they return not”

“Të shurdhër, memecë dhe të verbër, **dhe** ata nuk kthehen”.

Pra, përkthimi i “ فاء - Faut” me **dhe (and)** nuk e tregon qëllimin e ajetit, sepse ajeti tregon se ata nuk kanë mundësi të kthehen në rrugë të vërtetë vetëm **për shkak se** “ف” janë të shurdhër, memecë dhe të verbër.

LITERATURA E KONSULLTUAR

- “El-Xhamiul ahkamul Kur’an”

Autor: el-Imam Ebu Abdullah Muhamed bin Ahmed el-Ensariju el-Kurtubij.

- “Tefsir el Kur’anil adhimë”

autor: El Hafidh Ibni Kethirë

botoi: “Darul daëveti”.

- “Fet-hul Kadijr - el Xhamiu bejne feniji rrivajeti ve dirajeti min ilmi tefsirë”

autor: Muhamed Ali bin uhamed esh-Shevkani,

botoi: “Darul vefaë”.

- “Advaul bejan fi idahil Kur’an bil Kur’an”

Autor: Esh-Shejh Muhamedul Eminë bin Muhamed el Muhtar el Xhekenij
eshShenkitij

Botoi: “Darul kutub el ilmije”, Bejrut.

- “Safvetil Bejan limeanil Kur’an”

Autor: Esh-shejh Husejn Muhamed Mahluf

Botoi: “Vezaretul evkaf li shuunil islamie”, Kuvajt.

- “Ahkamul Kur’an”

Autor: Ebi Bekr Muhamed bin Abdullah el mearuf bi Ibni arbi

Botoi: “Darl kutub ilmije”, Bejrut.

- “Tefsirë ajatul ahkam”

Autor: Muhamed Ali Sabuni

Botoi: “Darus Sabuni”.

- “El Keshaf an hakaikil tenzili ve ujunil ekavilë fi vaxhuhi teëvilë”

Autor: Ebi el Kasim Mahmud bin Umer ez Zamahsheriji el Havazimij

Botoi: “Darul ahja et-turathul Arabij.

- Tefsirul Taberij “Xhamiul bejan an teëvilil ajetul Kur’an”

Autor: Esh-shejh Muhamed Ali es-Sabuni dhe Dr. Salih Ahmed Rida

- “Envarut-tenzilë ve esrarut teëvilë maëruf: Tefsirë Bejdavi”

Autorë: Nasirudinë Ebil Hajr Abdullah bin Umer bin Muhamed esh-Shirazi
esh-Shafii el Bejdavi

Botoi: “Daru ihjaut turath el arabij”, Bejrut.

- “Ejseru tefasirë likelamil alijil kebirë”

Autor: Ebu Bekr bin el Xhezairij

Botoi: “Darus-selam”.

- “Tefsirul Kebirë”

Autor: El Fahru Rrazi

Botoi: “Daru Ijau turath el arabij”, Bejrut.

- “Tefsirul Munirë fil ahideti vesh sheriati vel menhexh”

Autor: Ustadh ed-doktor Vehbetu Zuhejli

Botoi: “Darul fikri el muasar”.

- “Menalilul urfan fi ulumil Kur’an”

Autor: Muhamed Abdul Adhimë ez-Zerkaniji

Botoi: “Darul Kutub el ilmije”, Bejrut.

- “Tefsirul Xhelalejn”

Autor: Xhelaludinë el Mehalij ve Xhelaludinë es-Sujutij

Botoi: “Mussesetu risaleti”.

- “Tefsirus-sehabeti”

Autor: Dr. Muhamed Abdurr-Rrahimë

Botoi: “Mektebetut turathij islami”.

- “Hataë fit-tefsirë”

Autor: Vahjud-dinë Hanë

Botoi: Rr-Rrisalatul islami devlij”.

- “Tefsirul Kur’an ve regaibul furkanë”

Autor: El-Alametu Nidhamud-dijnë el Hasen bin Muhamed bin el Husejn el Kumij en Nisaburi

Botoi: “Darul kutub el ilmijeti”.

- “Huruful Meani ve alakatuha bil hukmi sherij”

Autor: Dr. Dijab Abdul Xhevad Ata

Botoi: “Darul Menar”.

- “Huruful Atfi fi isntinbat el ahkam min mesadir sherijeti”

Autor: Dijab Delijm Muhamed Omer

Botoi: “Darul hedj”.

- “Keshful meanij fi muteshabihil methanij”

Autor: Muhamed Muhamed Davud

Botoi: Darul Menar.

- “Usulul Fikh elmusema: EL USUL FIL USUL”

Autor: El Imam Ahmed bin Alij err-Rrazi el Xhasas

Botoi: “Vezaretul evkaf ve shuunul islamije”.

- “Tilbeti talebeti fil istilahatil fikhijeti”

Autor: El Imam Nexhmu dijn Ebi Hafsa Omer bin Muahamed en-Nesefij

Botoi: “Daru Nefais”.

- “Hamsete ashere karnen meal-Kur’anil Kerimë”

Autor: Abdul Halik Sejid Ebu rabijete

Botoi: “Daru Sheab”.

- “Derasetu Havle terxhumetil Kur’anil kerimë”

Autor: Dr. Ahmed Ibrahimë Mihna

Botoi: “Esheab”.

- “Israrut – tikkur fil Kur’an, el musema: El-burhan fi tevxihi muteshabihil Kur’an lima fih minel huxheti vel bejan”

Autor: Abdul Kadir Ahmed Ata

Botoi: “Darul Fadileti”.

- “Kitabul Kur’anil kerimë birr-rresmil imlai ev el huruful latinijeti (iktirahani merfudani)

Autor: Dr. Abdul Hajj el Fermavi

Botoi: “Daru tevziyë ven-neshtril-islamijeti”.

- “El-Kamusul Kavijm lil Kur’anil kerimë”

Autor: Ustadh Ibrahim Ahmed Abdul Fetah

Botoi: “Mexhmuul buhuthul islamijeti”.

- “El Muteradifal fil Kur’anil Mexhidë”

Autor: Muhamed Mahmud Gali

Botoi: “Darun-neshri lil xhamiat”, Misr.

- “El Kur’anul kerimë min mendhuril istishrakiji”

Autor: Dr. Muhamed Muhamed Ebu Lejle

Botoi: “Darun-neshri lil xhamiat”.

- “Meal Kur’anil kerimë”

Autor: Ahmed bin Muhamed Tahunë.

- “Ahkam kiraetil Kur’anil kerimë”

Autor: Hadimul Kur’anil kerimë Mahmud el Husari.

- “Esrarut teëvilë”

Autor: Mahmud Muhamed Rebië

Botoi: “Nijetul misrijetil ameti lil kitab”.

- “Manil Kur’ani bejnerr-rivajeti ved-dirajeti”

Autor: Ahmed Hasan el Bakuri

Botoi: “Merkezul Ahram lit-terxhemeti ven-neshri”.

- “Etheru lugati fil ihtilafil muxhtehidinë”

Autor: Abdul Vehab Abdus Selam Tavile

Botoi: “Darus-salam”.

LIBRAT E AUTORIT (Dr. Musli Vërbanit)

1. “Besimi në Zotin”
2. “Melaqet e Zotit”
3. “Besimi në Librat e Zotit”
4. “Pejgamberët e Zotit”
5. “Besimi në Ditën e Kijametit”
6. “Besimi në Kaderin e Zotit”
7. “Tregime nga jeta e Muhamedit a.s.”
8. “Fikhu i Namazit”
9. “Fikhu i Zekatit”
10. “Fikhu i Agjërimit”
11. “Fikhu i Haxhit”
12. Emërtoni fëmijët tuaj me emra të bukur
13. “Dëshmorët e 9 Prillit në Rakoc dhe Lagje të Re”
14. “Shkruaj, lexo dhe mëso shkronjat e Kur'anit
15. “Nata e dhëndërisë”
16. “Fadil Çaka – Komandant Sharri”
17. “Dita e vdekjes dhe e varrimit”

18. “(Pa)mundësia e përkthimit të Kur’anit”.

PËRKTHIMET NGA GJUHA ARABE

1. “Këshilltari fisnik për djem dhe vajza” (nga autori Muhamed Sajim)
2. “Islami dhe Politika” (nga autori Jusuf Kardavi)
3. “Mrekullitë numerike në Kur'anin Fisnik” (nga autori Abdurrezak Nufel)
4. “Për Kushtetutën Islame” (nga autori Dr. Muhamed Sejid Ahmed El Musejer)
5. “Kryesore në terminologjinë e Hadithit” (nga autori Abduhu Abas El-Velidi)
6. “Vlera e kohës” (nga autori Amër Halid)
7. “Vëllazëria muslimane” (nga autori Amër Halid)
8. “Vëllazëria në islam dhe zemra e shëndoshë” (nga autori Amër Halid)

PËRMBAJTJA:

PËRKTHIMI I KUR’ANIT	3
EMRAT E KUR’ANIT	9
CILËSITË E KUR’ANIT	11
SURET E KUR’ANIT	12
AJETET E KUR’ANIT	13
PËRKTHIMI I FJALËS AJET	13
TEMATIKAT E KUR’ANIT	16
FILLIMI I SUREVE	19
SHKRONJAT E ALFABETIT ARAB	21
FILLIMI I SUREVE ME SHKRONJA TË ALFABETIT ARAB	23
GABIME NË PËRKTHIMIN E PJSËZAVE	27
PJSËZA “م” - “MA”	29
PËRKTHIMI I LIDHËZAVE “و” DHE “ف”	35
GABIMET PËR SHKAK TË DOMETHËNIES	
SË DYFISHTË TË FJALËS	39
GABIME GJATË PËRKTHIMIT TË NJËJËSIT DHE SHUMËSIT53	
PËRKUFIZIMI I FJALËS	57
EMRAT, PËREMRA ME SHKRONJË TË MADHE	61
EMRAT E ALLAHUT DHE PËREMRA DHE ATRIBUTET E TIJ	
ME SHKRONJË TË MADHE	63
GABIM I PËRKTHIMIT TË DREJTPËRDREJTË	67

ANULIMI RETORIKO-STILISTIK DHE PËRDORIMI I KLLAPAVE APO	
MOSPËRDORIMI I TYRE	81
GABIM I MOSPËRFILLJES SË VETAVE	97
GABIM NË MOSKUPTIMIN E FJALËS	101
TERMINOLOGJIA E FIKHUT	113
GABIME SHKENCORE	121
GABIME GJUHËSORË NË GJUHËN SHQIPE	125
MOSPËRDORIMI I THONJËZAVE PËR IRONI	133
GABIM I MOSPËRSHTATJES SË FJALËS NË GJUHËN SHQIPE	137
GABIME TE FOLJET TRANSITIVE	145
GABIM I FILLIMIT TË AJETIT	149
GABIM I RADHITJES SË FJALËVE	153
GABIMET TEKNIKE	159
GABIME TEKNIKE NUK LEJOHEN	161
EL-VAKF VEL IBDAË TË NDALURIT (e rreshtit)	
DHE TË FILLUARIT (e rreshtit)	163
NUK JANË GABIME POR MË MIRË ALTERNATIVA TË	
PËRKTHIMIT MË TË PËRSHTATSHËM	171
DISA PËRKTHYES TË KUR'ANIT NË GJUHËN ANGLEZE	177
PËRKTHIMI I I.M. RODWELL	179
PËRKTHIMI I JUSUF ALI-ut	182
PËRKTHIMI I N.I. DAWOOD	183
PËRKTHIMI I ARTHUR J. ARBERY	185
PËRKTHIMI I MUHAMED MARMADUKE PICHT THALL-it	187
LITERATURA E KONSULLTUAR	189
LIBRAT E AUTORIT (Dr. Musli Vërbanit) DHE	
PËRKTHIMET NGA GJUHA ARABE	193
PËRMBAJTJA	194